



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Fizikë”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Dafina XHAKO

Prof. Dr. Lindita MUKLI

Shtator/2025

Tabela Përmbledhëse Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Fizikë” ofruar nga Universiteti i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Fizikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Fizikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.1225, datë.03.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 170, datë 13.06.2023.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7(shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2021-2022:13 PAE/3 PAK v.a 2022-2023:15 PAE/1 PAK v.a 2023-2024:15 PAE/1 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2021-2022: 10 studentë v.a 2022-2023: 9 studentë v.a 2023-2024: 0 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Fizikë” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në kuadër të Universitetit të Tiranës dhe është pjesë përbërëse e reformave të ndërmarra në përputhje me marrëveshjen e Bolonjës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1225, datë 03.09.2008. Ky program ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri të thelluara në parimet dhe metodat shkencore të fizikës, si dhe të zhvillojë aftësi të avancuara teorike dhe praktike në këtë fushë.

Programi realizohet në një periudhë dyvjeçare akademike dhe përfshin 120 kredite ECTS. Ai mbështetet në një trashëgimi të pasur akademike dhe përvojë të gjatë pedagogjike, që daton që nga themelimi i Universitetit të Tiranës në vitin 1957, me krijimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe të Katedrës së Fizikës. Një pikë referimi e rëndësishme në zhvillimin e këtij programi është edhe hapja në vitin 1966 e degës 5-vjeçare të Fizikës, e cila u ndërtua mbi bazën e përzgjedhjes akademike dhe përkushtimit ndaj cilësisë në arsim.

Duke u mbështetur në këtë traditë të konsoliduar akademike, metodologjia e programit Master i Shkencave në Fizikë është ndërtuar për të ofruar një formim të gjithanshëm dhe të specializuar në fushën e fizikës, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë kërkimor.

Departamenti i Fizikës, aktualisht, ofron një gamë të gjerë programesh studimi, përfshirë dy programe të ciklit të parë: Bachelor në Fizikë dhe Bachelor në “Fizikë” dhe “Shkenca Kompjuterike”, si dhe dy programe të ciklit të dytë: Master i Shkencave në “Fizikë” dhe Master i Shkencave “Mësues Fizike për Arsimin e Mesëm të Lartë”.

Programi Master i Shkencave në “Fizikë” synon të formojë specialistë të aftë për të kontribuar në zhvillimin e shkencës dhe edukimit, duke sjellë një impakt domethënës në institucionet ku ata angazhohen dhe në shoqërinë shqiptare në tërësi. Përmes bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, programi fuqizon më tej rolin e Universitetit të Tiranës si një qendër ekselence akademike dhe shkencore.

Në përputhje me interesat kombëtare, ky program kontribuon në ruajtjen dhe avancimin e vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Tiranës. Ai promovon zhvillimin e njohurive shkencore të thelluara nëpërmjet një ndërthurjeje të balancuar midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke i vënë këto në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kombëtar.

Programi ofron formim të specializuar në disa fusha kyçe të fizikës, përfshirë: *Fizikën Teorike dhe Llogaritëse, Fizikën e Trupit të Ngurtë dhe të Materialeve, Biofizikën dhe Fizikën Mjekësore*, si dhe *Fizikën e Mjedisit*.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë *“Master i Shkencave në Fizike”*. Bazuar në Urdhër nr. Nr.124, datë 10.10.2023 të ASCAL, *“Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Universiteti i Tiranës, grupi i vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga Prof.As. Dafina Xhako dhe Prof. As. Lindita Mukli.*

Gjatë procedurës, GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Prill 2025 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti i Tiranës për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UT/FSHN, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacion ky i transferuar në sistemin AMS të ASCAL.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, VKM Nr.824, datë 24.12.2021 *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”* si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 13 dhe 14 Maj 2025, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të FSHN/UT. Takime ndër të cilat mund të përmendim atë me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Përgjegjësin e Departamentit të Fizikës, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Zyrës së Koordimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura. Në përfundim të analizës së materialeve të sipër cituara, GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi duke paraqitur edhe disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 25.08.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 162 / 22 Prot, datë 25.08.2025. Universiteti i Tiranës, njofton në ASCAL më datë 03.09.2025, ku shprehin dakortësinë


me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Fizikë"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i Studimit Master i Shkencave në "Fizikë", i ofruar nga Departamenti i Fizikës në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, synon përgatitjen e specialistëve të aftë dhe të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare. Përmes integritetit të kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe angazhimit publik, ky program promovon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndërgjegjshme ndaj zhvillimit shkencor dhe shërbimit ndaj komunitetit, duke mbështetur dhe respektuar në mënyrë të vazhdueshme interesat kombëtare. Programi synon të formojë profesionistë me kompetenca të larta në nënfusha të ndryshme të fizikës, të cilët, nëpërmjet aftësive të tyre analitike dhe ekspertizës së specializuar, kontribuojnë në mënyrë domethënëse në institucionet akademike, kërkimore, arsimore dhe të industrisë, si dhe në shoqëri në përgjithësi. Përmes rrjetit të gjerë të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, programi rrit vlerën akademike të Universitetit të Tiranës dhe forcon rolin e tij në prodhimin e njohurive dhe avancimin e dijes shkencore. Në përputhje me objektivat dhe misionin e Universitetit të Tiranës, programi mbështet dhe fuqizon vlerat akademike, kulturore dhe kombëtare, të cilat janë të përfshira në Statutin e institucionit. Ai promovon një formim të thelluar dhe të qëndrueshëm shkencor nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit, duke i vënë këto kapacitete në funksion të zhvillimit kombëtar dhe të nevojave të tregut të punës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 4 dhe 5 fq 3 - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, hyrje, pika 2.1.1 faqe 11 dhe pika 4 faqe 17 - Rregullore e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fizikë, neni 3 faqe 4



	- <i>Plani strategjik i zhvillimit të departamentit të Fizikës, FSHN UT, 2017-2027</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizikë” është në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat strategjike të Universitetit të Tiranës dhe, në mënyrë të veçantë, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, për të përgatitur individë me integritet të lartë profesional dhe etik. Programi synon të zhvillojë profesionistë të cilët kontribuojnë në përparimin e kërkimit shkencor dhe përçojnë vlerat thelbësore akademike dhe kombëtare në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre. Ky program ka si qëllim formimin e specialistëve të kualifikuar në fushën e fizikës, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe shkencore të studentëve. Nëpërmjet një qasjeje të integruar ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor cilësor, programi përgatit shkencëtarë të rinj të aftë për të kontribuar në komunitetin akademik dhe në zhvillimin teknologjik dhe shkencor të vendit. Gjithashtu, programi synon të pajisë studentët me dije të avancuara teorike dhe të aplikuar në fizikë, si dhe me kompetenca të nevojshme profesionale që u mundësojnë të ndjekin me sukses studimet në ciklin e tretë (doktoraturë), duke u bërë pjesë aktive e qarqeve akademike dhe kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 4 dhe 5, fq 3</i> - <i>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, pika 1, fq 6</i> - <i>Rregullore e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fizikë, neni 3, faqe 4</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizikë” zhvillohet në kuadër të zbatimit të strategjisë së Universitetit të Tiranës dhe në përputhje të plotë me profilin akademik të institucionit. Në mënyrë të veçantë, programi është i harmonizuar me objektivat akademike dhe kërkimore të Departamentit të Fizikës, duke kontribuar në konsolidimin dhe zgjerimin e kapaciteteve shkencore dhe mësimore në këtë njësi. Programi synon të thellojë njohuritë e studentëve në fushat themelore dhe të avancuara të fizikës teorike dhe të asaj të aplikuar, si dhe të promovojë zhvillimin e njohurive të reja në këto disiplina, të cilat përfaqësojnë komponentë thelbësorë të shkencës moderne dhe inovacionit teknologjik.

	Evidenca: - <i>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 pika 3.1.3 fq 14 dhe pika 3.2.17 faqe 16</i> - <i>Rregullore e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizike" neni 3 faqe 4</i> - <i>Rregullore e Departamentit të Fizikës, neni 4, faqe 2</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Fizikë" është konceptuar në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit dhe nevojat e tregut të punës, duke reflektuar orientimet strategjike për zhvillimin ekonomik kombëtar. Ky program zbatohet në linjë me vizionin dhe misionin e Universitetit të Tiranës dhe synon formimin e specialistëve të kualifikuar, të cilët janë të aftë të kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të efektshme në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të shoqërisë shqiptare. Programi i studimit Master i Shkencave në "Fizikë" është konceptuar në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe në përmbushje të misionit akademik dhe shkencor të Universitetit të Tiranës. Programi është strukturuar për të përgatitur profesionistë të aftë të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, nëpërmjet aplikimit të njohurive të avancuara në fizikë në sektore kyç të ekonomisë kombëtare. Diplomantët e këtij programi janë të përgatitur për të dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në fusha si: • Energjia dhe teknologjitë e qëndrueshme, përmes analizës dhe optimizimit të proceseve energjetike dhe zhvillimit të teknologjive të reja; • Industritë e përpunimit dhe prodhimit, duke aplikuar koncepte të fizikës së materialeve, fizikës së trupit të ngurtë dhe mekanikës përmirësuese; • Sektori shëndetësor, nëpërmjet formimit në biofizikë dhe fizikë mjekësore, për përdorimin e teknikave të avancuara të imazherisë dhe radioterapisë; • Mbrojtja e mjedisit, nëpërmjet monitorimit dhe modelimit të ndotësve, proceseve atmosferike dhe ndikimeve klimatike, si pjesë e fizikës mjedisore; • Arsimi dhe kërkimi shkencor, në funksion të zhvillimit të kapaciteteve akademike dhe inovacionit teknologjik. Përmes këtij formimi të gjithanshëm, programi synon të nxjerrë individë të aftë për të udhëhequr dhe mbështetur transformime ekonomike dhe shoqërore, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe objektivat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

	Evidenca: - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, faqe 17 - Rregullore e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fizike, neni 3, faqe 4 - Rregullore e Departamentit të Fizikës, neni 4, faqe 2 - Suplement i diplomës MSH Fizikë			
Konkluzione	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë" ofruar nga njësi kryesore Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, prej Departamentit të Fizikës, është në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), si një nga njësitë kryesore akademike të Universitetit të Tiranës, përbëhet nga struktura mësimore-shkencore dhe njësi ndihmëse akademike e administrative, të cilat funksionojnë në përputhje me parimet e autonomisë institucionale, të përcaktuara në Statutin e UT. Me një histori të gjatë akademike dhe një traditë të konsoliduar në arsim dhe kërkim shkencor, FSHN është një qendër e rëndësishme e formimit universitar në Shqipëri. Të gjithë departamentet përbërëse të FSHN-së, përfshirë edhe Departamentin e Fizikës, plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, konkretisht Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Secili departament ka mbi shtatë anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët më shumë se tre mbajnë grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti i Fizikës është një ndër nëntë departamentet e FSHN-së dhe luan një rol thelbësor në përgatitjen akademike dhe kërkimore të brezave të rinj të studiuesve dhe profesionistëve në fushën e fizikës. Veprimtaria e tij përfshin mësimdhënien në disiplinat

themelore dhe të specializuara të fizikës, si dhe zhvillimin e një aktiviteti kërkimor të vazhdueshëm dhe cilësor. Në vitin akademik 2023–2024, stafi akademik i Departamentit të Fizikës përbëhet nga 21 anëtarë, përkatësisht: 3 profesorë, 5 profesorë të asociuar, 12 doktorë shkencash dhe 1 pedagog me gradë Master. Struktura akademike është e organizuar në katër grupe mësimore, secila me mesatarisht pesë anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë (PAE). Ngarkesa akademike në programin Master i Shkencave në “Fizikë” mbulohet në mbi 95% nga ky staf, përtej pragut minimal ligjor prej 70%. Vetëm një pedagog me kohë të pjesshme (PAK), i cili është pjesë e QSUT, angazhohet në drejtimin e laboratorëve të lëndës “Fizikë Mjekësore”. Kjo strukturë siguron balancë optimale midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, pasi numri i orëve mbi normë mbetet i ulët. Bazuar në përvojën e konsoliduar akademike dhe burimet njerëzore të kualifikuara, Departamenti i Fizikës demonstroi kapacitetin institucional për të ofruar me cilësi të lartë programin Master i Shkencave në “Fizikë”, i cili u themelua në kuadër të zbatimit të reformave të procesit të Bolonjës, sipas VKM nr. 1225, datë 03.09.2008. Programi është ofruar në mënyrë të vazhdueshme që nga ajo kohë, përveç vitit akademik 2023–2024, kur nuk u arrit kuota minimale e pranimeve. Ai është rihapur për vitin akademik 2024–2025. Programi ka për qëllim pajisjen e studentëve me njohuri të avancuara në metodat dhe parimet themelore të fizikës, si dhe formimin e aftësive të specializuara në fushat përkatëse. Ai është një program dyvjeçar (120 kredite ECTS), i cili, pas përfundimit me sukses, shpërblen studentin me diplomë universitare të ciklit të dytë. Krahas përkushtimit për mësimdhënie cilësore, Departamenti i Fizikës është aktivisht i angazhuar në kërkimin shkencor, botime dhe pjesëmarrje në konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Kjo veprimtari synon të forcojë zhvillimin profesional të stafit dhe të përmbushë objektivat strategjike të departamentit në fushën e shkencës dhe arsimit të lartë. Angazhimi sistematik i anëtarëve të stafit në publikime shkencore dhe avancimin akademik është tregues i qartë i orientimit kërkimor-shkencor dhe cilësisë së tij institucionale.

Evidenca:

- *Aneks Tabela 10 “Plani mësimor i programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fizikë”*

	- Aneks Tabelat 6.1,6.2,6.3 "Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Bachelor në Fizikë - Aneks Tabelat 1 "Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) - Aneks Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Fizikë në një vit akademik - Aneks Tabela 19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit. - Ligji 80/2015 i arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, Neni 25 - Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu III, neni 14 - Rregullore e UT, neni 13, pika 8. - Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT - Model diplome - Suplement diplome e MSH. - Kodet e programeve të studimit të FSHN. - Urdhra hapjeje të programeve të studimit - Syllabus i Fizikës Mjekësore (Dosja e programit të studimit)
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN). Organizimi i këtij programi është kryer duke respektuar udhëzimet kombëtare dhe direktivat evropiane për klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit, në funksion të harmonizimit me standardet e Arsimit të Lartë në nivel ndërkombëtar. FSHN ofron formim të lartë universitar në fushat e shkencave natyrore, shkencave kompjuterike dhe fushave të aplikuara me karakter inxhinierik. Në këtë kuadër, programi Master i Shkencave në "Fizikë" është i orientuar drejt zhvillimit të njohurive të thelluara teorike dhe të aplikuara në fizikë, duke synuar përgatitjen e specialistëve të aftë për të përmbushur kërkesat e tregut të punës si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Ky orientim është konkretizuar në strukturën dhe përmbajtjen e planit mësimor të programit. Programi i përket ciklit të dytë të studimeve, në përputhje me Ligjin nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Ai organizohet në një total prej 120 kreditesh ECTS, të ndara në mënyrë të barabartë në 60 ECTS për çdo vit akademik. Kohëzgjatja normale e përfundimit të programit është

	dy vite akademike, siç përcaktohet në nenin 75, pika 3 të ligjit në fjalë. Evidenca: - <i>Plani mësimor i programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fizikë.</i> - <i>Ligji 80/2015, Neni 75, pika 3</i> - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu I, neni 8, pika 16</i> - <i>Kodet e programeve të studimit të FSHN.</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Departamenti i Fizikës, në kuadër të programit të studimeve Master i Shkencave në “Fizikë”, ofron një strukturë të larmishme lëndësh të ndara në dy kategori kryesore: <i>lëndë të formimit bazë</i> dhe <i>lëndë të specialitetit</i>. Këto grupime janë konceptuar në përputhje me praktikën më të mira akademike të ndjekura në programet e ciklit të dytë në universitetet evropiane dhe më gjerë, duke garantuar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë. Lëndët e formimit bazë kanë për qëllim ndërtimin e një themeli të fortë teorik, i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm akademik të studentëve në fushën e fizikës. Ato ofrojnë përgatitjen e nevojshme për të kuptuar konceptet dhe metodat shkencore që shërbejnë si bazë për lëndët e avancuara. Nga ana tjetër, lëndët e specialitetit janë të orientuara drejt përvetësimit të njohurive të thelluara në fusha të caktuara të fizikës, si dhe drejt zhvillimit të aftësive për të kuptuar dhe kontribuar në kërkimin shkencor bashkëkohor. Përmes këtyre lëndëve, studentët ekspozohen ndaj problematikave dhe metodologjive të kërkimit të avancuar, duke u përgatitur për një karrierë akademike ose profesionale me fokus kërkimin dhe inovacionin shkencor. Evidenca: - <i>Aneks Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</i> - <i>Aneks Tabela 10 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fizikë</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,	NA

cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në kuadër të zbatimit të politikave për fuqizimin e komponentit praktik dhe kërkimor në programet e ciklit të dytë të studimeve, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka formalizuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe njësi profesionale kombëtare, me qëllim krijimin e mundësive të strukturuar për angazhimin e studentëve në trajnime dhe aktivitete praktike të avancuara. Këto bashkëpunime synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave profesionale dhe shkencore të studentëve të programit “Master i Shkencave në Fizikë”, duke i pajisur ata me njohuri të përditësuara dhe aftësi praktike të nevojshme për përgatitjen dhe realizimin cilësor të temave të diplomës. Në këtë kontekst, Fakulteti ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të profilit të lartë kërkimor dhe profesional, si Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), ku studentët kanë mundësi të përfshihen në veprimtari laboratorike, eksperimentale dhe klinike në funksion të përgatitjes së tyre profesionale. Në vijim të këtyre përpjekjeve, janë nënshkruar marrëveshje institucionale edhe me aktorë të tjerë të rëndësishëm në fushat përkatëse, si: Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, kompania Antea Cement, Fakulteti i Studimeve Profesionale Durrës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Ndërtimit dhe Fakulteti i Shkencave Pyjore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Këto marrëveshje përfshijnë ofrimin e praktikave profesionale, internship-eve, bashkëpunimin në projekte të përbashkëta kërkimore, mentorimin e temave të diplomës dhe zhvillimin e trajnimeve të specializuara. Përmes këtyre mekanizmave institucionalë të bashkëpunimit, studentët përfitojnë një platformë të gjerë zhvillimi profesional, që kontribuon në thellimin e njohurive të fituara në auditor, përf forcimin e kompetencave praktike, rritjen e mundësive për integrim në tregun e punës dhe përfshirjen aktive në komunitetin akademik dhe shkencor kombëtar.
	Evidenca: - <i>Aneks Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i> - <i>Aneks Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese</i>

	- Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT - Marreveshje ne favor te programit te studimit (5 marreveshje) - Marreveshje me drejtorine e metrologjise. - Raport vjetor 2021-2022, FSHN, UT - Raport vjetor 2022-2023, FSHN, UT			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka krijuar mekanizma efektivë për hartimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e programeve të studimit, përfshirë edhe programin Master në “Fizikë”. Institucioni ka siguruar një bashkëpunim të frytshëm të brendshëm. Në funksion të mbështetjes së realizimit të programit të studimit dhe pasurimit të përvojës akademike dhe praktike të studentëve, UT/FSHN ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Mbarëvajtja dhe funksionimi cilësor i programit të studimit Master i Shkencave në “Fizikë” mbështetet në bashkëpunimin efektiv dhe të strukturuar të personelit akademik të përfshirë në zbatimin e tij. Në kushtet kur mbi 95% e lëndëve të planit mësimor mbulohen nga personel akademik me kohë të plotë (PAE) të Departamentit të Fizikës, bashkëpunimi ndërmjet këtyre anëtarëve është thelbësor për sigurimin e një procesi mësimor të qëndrueshëm dhe të koordinuar. Përtej bashkëpunimit të brendshëm në nivel departamenti, Departamenti i Fizikës zhvillon gjithashtu marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me departamente të tjera të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, personeli i të cilëve kontribuon në mbulimin e disa lëndëve të programeve të ciklit të parë, si Bachelor në “Fizikë” dhe Bachelor në “Fizikë dhe Shkenca Kompjuterike”. Gjithashtu, në procesin mësimor dhe kërkimin shkencor, është i angazhuar edhe personel akademik i Institutit

	të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, një njësi përbërëse e Universitetit të Tiranës me profil të specializuar kërkimor dhe aplikativ në fushën e fizikës. Ky bashkëpunim fuqizon dimensionin kërkimor të programit dhe ofron ekspertizë shtesë në fushat përkatëse. Për më tepër, në modulën praktik të lëndës Fizikë Mjekësore, është i përfshirë një udhëheqës laboratorësh me përvojë, pjesë e stafit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), çka garanton lidhjen e mësimdhënies me praktikën klinike dhe aplikimet bashkëkohore të fizikës në mjekësi. Të gjitha marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit zhvillohen në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, duke siguruar një kuadër të rregulluar dhe institucional për realizimin me cilësi të programit të studimit. Evidenca: - Aneks Tabela 2 Departamenti i Fizikës përgjegjës për programin Bachelor në Fizikë - Aneks Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) - Aneks Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës - Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5/a dhe neni 16, pika ç - Rregullore e brendshme e Departamentit të Fizikës, neni 10 faqe 4
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti i Tiranës (UT) ka qenë ndër institucionet e para të arsimit të lartë në Shqipëri që ka promovuar dhe institucionalizuar dukurinë e mobilitetit akademik. Kjo shprehet në angazhimin aktiv të stafit akademik dhe studentëve në programe mobiliteti, në zgjerimin e rrjeteve të bashkëpunimit ndërkombëtar për kërkimin shkencor, si dhe në pjesëmarrjen në iniciativa shumëpalëshe dhe dypalëshe të bashkëpunimit. Në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare me Bashkimin Evropian, në veçanti nëpërmjet programit ERASMUS, si dhe nga marrëveshjet bilaterale të nënshkruara direkt nga Universiteti i Tiranës, janë krijuar mundësi të shumta për mobilitetin akademik dhe kërkimor. Lista e plotë e këtyre marrëveshjeve mund të konsultohet në faqet zyrtare të institucionit:

	• Marrëveshjet bilaterale: link • Marrëveshjet Erasmus+ KA107: link Për më tepër, në janar të vitit 2022, Universiteti i Tiranës është vlerësuar nga Komisioni Evropian me logon “HR Excellence in Research”, një certifikim prestigjioz që nënvizon angazhimin institucional ndaj standardeve të larta në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e karrierës akademike (link). Departamenti i Fizikës në Fakultetin e Shkencave Natyrore ka qenë veçanërisht aktiv në projekte dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Ndër partnerët kryesorë janë Universiteti Politeknik i Barit dhe Universiteti i Janinës. Një arritje e rëndësishme është përfshirja e Universitetit të Tiranës dhe atij Politeknik të Tiranës, që prej datës 05.03.2024, si institucione bashkëpunuese në eksperimentin CMS në CERN (Këshilli Evropian për Kërkimin Bërthamor). Katër pedagogë nga Departamenti i Fizikës janë përfshirë në aktivitete kërkimore në fushat e simulimeve, analizës së të dhënave dhe detektorëve me gaz. Mbështetur nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI) përmes projekteve PIKSH, në Departament është instaluar një klaster për analizë të dhënash, i cili do të përdoret për kërkime shkencore dhe si mjet mësimor për studentët e Masterit Shkencor dhe programit të doktoraturës në Fizikë. Nga viti 2018 deri në vitin 2023, UT ka pasur një marrëveshje bashkëpunimi me International Center for Relativistic Astrophysics Network (ICRANet), e cila ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin profesional të studentëve të MSH në Fizikë dhe të stafit akademik. Në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin Politeknik të Barit, çdo vit prej gjashtë vitesh organizohet Shkolla e Shkencës së të Dhënave me Zbatim në Fizikë, e fundit prej të cilave është mbajtur në janar 2025. Kjo nismë është e dedikuar për studentët e cikleve Bachelor dhe MSH në Fizikë, dhe ofron njohuri të avancuara në fushën e fizikës së energjive të larta dhe jo vetëm. Departamenti mirëpret rregullisht lektorë të huaj të ftuar, të cilët, në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale, ofrojnë leksione bashkëkohore me impakt të drejtpërdrejtë për studentët dhe stafin akademik. Departamenti i Fizikës, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe Akademinë e Shkencave, ka organizuar konferenca shkencore, workshope dhe shkolla verore me pjesëmarrjen e studiuesve nga institucione prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë: CERN,
--	---

	Institut National de Physique Nucléaire (Itali), Universiteti i Barit, Universiteti i Parisit, Graz, Gjenova, Janina, si dhe studiues shqiptarë që veprojnë jashtë vendit. Pjesëmarrja në këto aktivitete dhe mbështetja për stafin akademik në përfaqësime ndërkombëtare kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe zhvillimin profesional të trupës akademike të UT. Evidenca: - <i>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, pika 2 fq 10</i> - <i>Marrëveshja CMS me CERN</i> - <i>Marrëveshje të UT</i> - <i>Evidenca 1.10.2 Marrëveshje te UT</i> - <i>Marrëveshje te UT</i> - <i>Aneks Tabela 19 Aktivitete individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit,</i> - <i>Aneks Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i> - <i>Aneks Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese.</i> - <i>Marreveshja CMS me CERN</i> - <i>Marreveshje me ICRANet.</i> - <i>Raport mësimor shkencor i Departamentit të Fizikës 2022-2023</i> - <i>Raport vjetor për veprimtaritë në Departamentin e Fizikës 2021-2022</i> - <i>Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT</i> - <i>Raport vjetor 2021-2022, FSHN, UT</i> - <i>Raport vjetor 2022-2023, FSHN, UT</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit	Programi i studimit <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i> në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, parashikon përmbylljen e ciklit të studimeve me mbrojtjen e punimit të diplomës. Në këtë kuadër, studentëve u ofrohen mundësi të shumta për zhvillimin e komponentit praktik të punimit në institucione të ndryshme kërkimore, akademike dhe profesionale. Disa nga institucionet ku studentët kanë realizuar punën praktike përfshijnë Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT). Në funksion të zgjerimit të mundësive për formim praktik dhe profesional, Fakulteti ka nënshkruar marrëveshje

për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe aktorësh të rëndësishëm nga sektori publik dhe privat, si: • Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; • Antea Cement sh.a; • Fakulteti i Studimeve Profesionale, Durrës; • Instituti i Arkeologjisë; • Instituti i Ndërtimit; • Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Këto marrëveshje përfshijnë organizimin e praktikave profesionale, intershipeve, projekteve të përbashkëta kërkimore, mbështetjen në udhëheqjen e diplomave, si dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve, studentët përfitojnë eksperiencë konkrete pune në mjedise profesionale dhe kërkimore, duke pasuruar aftësitë praktike, zgjeruar njohuritë e fituara gjatë studimeve dhe rritur perspektivat për integrimin e tyre në tregun e punës. Evidenca: - <i>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, pika 2.1.7 fq 11.</i> - <i>Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT</i> - <i>Raport vjetor 2021-2022, FSHN, UT</i> - <i>Aneks Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese</i> - <i>Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT</i> - <i>Marreveshje në favor të programit të studimit (5 marreveshje)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti i Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës përfshin në analizën e tij vjetore raportet analitike mbi përfitimet e realizuara nga marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstitucional, të cilat fokusohen në: • vlerësimin e mobiliteteve të stafit akademik dhe pedagogëve; • diseminimin e eksperiencës së fituar tek pjesa tjetër e stafit akademik; • promovimin dhe nxitjen e mëtejshme të mobilitetit për stafin dhe studentët. Këto raporte përbëjnë një instrument të rëndësishëm për vlerësimin e impaktit real të bashkëpunimeve ndërkombëtare



	dhe për orientimin strategjik të politikave të departamentit në drejtim të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë akademike. Në këtë kuadër, edhe Njësia e Shërbimeve dhe Bashkëpunimeve me Komunitetin (NJSBC), si një strukturë e sapokrijuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ka parashikuar në planin e saj të punës hartimin e raporteve analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Megjithatë, kjo njësi ndodhet ende në fazë përgatitore dhe nuk ka përmbyllur një produkt final në këtë drejtim. Evidenca: <i>Raport mësimor shkencor i Departamentit të Fizikës 2022-2023</i> <i>Raport vjetor për veprimtaritë në Departamentin e Fizikës 2021-2022</i> <i>Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT</i> <i>Raport vjetor 2021-2022, FSHN, UT</i> <i>Raport vjetor 2022-2023, FSHN, UT</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Fizikës dhe njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Natyrës në UT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë realizimin e objektivave të programit të studimit. Departamenti i Fizikës falë bashkëpunimeve me entet vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës ofron programe të akredituara të studimeve, të strukturuar në module mësimore dhe të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i ciklit të dytë të studimeve <i>Master i Shkencave në Fizikë</i> është projektuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, duke përfshirë një total prej 120 kreditesh ECTS, të shpërndara në dy vite akademike. Çdo vit akademik përmban 60 kredite, të cilat ndahen ndër lëndë dhe veprimtari të ndryshme akademike, duke respektuar parimet e ngarkesës studentore dhe kompetencave që synohen të zhvillohen në secilën prej tyre. Struktura e programit siguron balancë mes përmbajtjes teorike, përgatitjes praktike dhe kërkimit shkencor, në funksion të formimit të plotë akademik dhe profesional të studentëve. Evidenca: - Rregullore e UT, pjesa III, neni 31, fq 21 - Aneks Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) - Aneks Tabela 10 Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë - VKM nr 41, datë 24.01.2018 neni 2, 2.1, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të	GVJ konstaton se programi i studimit <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i>, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, është ndërtuar mbi një strukturë të mirëorganizuar të lëndëve, të kategorizuara në: • lëndë të kulturës së përgjithshme, • lëndë të përgatitjes për disiplinën shkencore, • lëndë të nëndisiplinave dhe profileve, • grup-lëndë me zgjedhje, • si dhe lëndë plotësuese.

fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky kategorizim u mundëson studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe të avancuara, të domosdoshme si për formimin profesional, ashtu edhe për përgatitjen për cikle të mëtejshme të studimeve. Përmes kombinimit të lëndëve bazë dhe atyre të specializuara, programi siguron një balancë ndërmjet përgatitjes teorike dhe përfshirjes në kërkimin shkencor, në përputhje me fushat prioritare të Departamentit të Fizikës dhe traditën e tij akademike. Lëndët e përfshira në këtë program pasqyrojnë zhvillimet më të fundit në kërkimin shkencor, duke i pajisur studentët me kompetenca që i përgatisin për integrim në tregun e punës, përfshirje në projekte kërkimore dhe për vazhdimin e studimeve doktorale në fusha të ndryshme të fizikës moderne. Gjatë këtij programi, studentët: • përvetësojnë njohuri të avancuara mbi sistemet komplekse dhe metodat për modelimin dhe simulimin e tyre, me aplikime konkrete në fusha si Biofizika e Zbatuar; • zhvillojnë aftësi në simulimin e proceseve fizike përmes përdorimit të teknologjive dhe metodave bashkëkohore të programimit; • njihen me konceptet e shkencave klimatike, shkencave mjedisore dhe metodologjitë për detektimin e rrezatimeve; • fitojnë aftësi praktike në analizën e të dhënave, të aplikueshme në disiplina si Fizika e Mjedisit dhe fusha të ndërlidhura; • përgatiten për studime të avancuara teorike, duke përfituar njohuri të thelluara në fusha si Fizika e Grimeve, Astrofizika dhe Simulimet e Dinamikës së Fluideve. Përmes përfshirjes aktive në mjedisin kërkimor të Departamentit, si dhe në bashkëpunim me institucione të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit, studentët zhvillojnë shprehje kërkimore dhe kapacitete profesionale që i përgatisin për sfida të avancuara akademike dhe profesionale. Evidenca: <i>Evidenca 2.2 Model Syllabus në programin Master Shkencor Aneks Tabela 9 Plan i mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për	GVJ konstaton se në kurrikulën dhe në planin mesimor të programit të studimit <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i>, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë

realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	21.01.2011, "Për elementët bazë të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe VKM nr. 879, datë 29.12.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 41", është strukturuar në bazë të pesë kategorive të lëndëve (A–E), të cilat pasqyrojnë tipologjitë dhe funksionet didaktike të lëndëve brenda kurrikulës. Përkatësisht, ndarja e krediteve është si vijon: • Kategoria A (Formimi i përgjithshëm): 11 kredite të përfituara nga 2 lëndë, që përbëjnë 9% të totalit të krediteve të programit. • Kategoria B (Formimi i thelluar në fushën e studimit): 57 kredite të përfituara nga 11 lëndë, që përbëjnë 48% të totalit të krediteve. • Kategoria C (Zgjerimi i formimit në fushën e studimit): 13 kredite të fituara nga 3 lëndë, përfaqësuese e 11% të krediteve të programit. • Kategoria D (Lende plotësuese): 9 kredite të fituara nga 2 lëndë, ose 8% e totalit të krediteve. • Kategoria E (Detyrimi përmbyllës – Teza e diplomës): 30 kredite, që përbëjnë 25% të totalit dhe që realizohen përmes një projekti kërkimor-praktik individual, në përfundim të programit. Sipas sistemit ECTS, një kredit përfaqëson 25 orë pune të plotë të studentit, përfshirë: • aktivitete të drejtuara në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekte, etj.), • si dhe orë për punë të pavarur dhe përgatitje individuale jashtë orarit të kontaktit. Ngarkesa standarde vjetore për studentët është 60 kredite ECTS, të cilat korrespondojnë me një vit të plotë akademik studimi me kohë të plotë. Evidenca: - VKM nr 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, shtojca 1, tabela 1 - Aneks Tabela 9 Plan i mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) - Rregullore e UT, neni 31 fq 21, neni 34 fq 22. - VKM Nr 879, date 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, date 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave,
---	---

	<i>për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL, shtojca 1, tabela 1</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Master i Shkencave në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	NA
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin	NA

ligjor të ministrisë
përgjegjëse për arsimin.



Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.

GVJ konstaton se programi *Master i Shkencave në "Fizikë"*, i ofruar nga Universiteti i Tiranës, evidentohet për përputhje të lartë me programet homologe të institucioneve prestigjioze ndërkombëtare, duke arritur një shkallë përputhjeje mbi 70% me kurrikulat e universiteteve të njohura europiane, përfshirë École Polytechnique Fédérale de Lausanne (EPFL). Kjo përputhshmëri reflektohet si në strukturën e lëndëve teorike ashtu edhe në përmbajtjen e tyre praktike dhe të aplikuar. Në aspektin teorik, programi ofron një bërthamë të fortë konceptuale, përmes lëndëve si:

- Mekanika Kuantike,
- Fizika Statistike,
- Teoria e Përgjithshme e Relativitetit, dhe disiplina të tjera thelbësore, të cilat janë të krahasueshme me ato që zhvillohen në programe të ngjashme të institucioneve lider në hapësirën akademike evropiane.

Nga ana tjetër, komponenti praktik i programit është ndërtuar për të forcuar aftësitë eksperimentale dhe teknike të studentëve, përmes lëndëve që mbulojnë:

- eksperimentimin në laborator,
- menaxhimin dhe analizën e të dhënave shkencore,
- simulimet kompjuterike,
- si dhe përdorimin e pajisjeve bashkëkohore në fusha të tilla si astrofizika, fizika e materialeve dhe fizika mjedisore.

Kjo qasje e balancuar ndërmjet formimit të thelluar teorik dhe angazhimit praktik në kërkim, i pajis studentët me një profil të plotë akademik dhe profesional, duke i përgatitur si për pjesëmarrje në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu edhe për përfshirje të suksesshme në tregun global të punës, si në sektorin akademik, ashtu edhe në atë industrial. Përputhja e programit me praktikat më të mira ndërkombëtare konfirmon cilësinë e tij dhe pozicionimin konkurrues të diplomantëve në një kontekst gjithnjë e më të globalizuar akademik dhe profesional.

Evidenca:

- *Vizita in institucion*

- <https://www.epfl.ch/schools/sb/sph/en/master/master-in-physics/>

Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit <i>Master i Shkencave në “Fizikë”</i>, i ofruar nga Universiteti i Tiranës, mban një kod identifikues të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Ky kodifikim institucional është dëshmi e respektimit të standardeve kombëtare të cilësisë në arsimin e lartë dhe garanton përputhshmërinë e programit me kërkesat akademike dhe profesionale, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Si rezultat, diploma e përfituar nga ky program gëzon njohje dhe vlerësim brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar mobilitet akademik dhe integrim të diplomantëve në tregun global të punës dhe në cikle të mëtejshme studimore. Evidenca: - <i>Model Syllabus në programin Master Shkencor</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master në “Fizikë” organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për	Departamenti i Fizikës, si njësi bazë mësimore-kërkimore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe

programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

në përmbushje të standardeve të përcaktuara për cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti i Fizikës funksionon si një strukturë akademike e integruar në FSHN, duke kontribuar në zhvillimin e veprimtarive të studimit dhe kërkimit në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit. Sipas këtij ligji, akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe i programeve të tyre të studimit përbën një detyrim ligjor dhe një mekanizëm themelor për sigurimin e cilësisë. Në këtë kuadër, si njësi kryesore (Fakulteti i Shkencave të Natyrës), ashtu edhe njësi bazë (Departamenti i Fizikës), kanë përmbushur detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë, duke garantuar respektimin e kriterëve të përcaktuara për përmbajtjen akademike, strukturën kurrikulare dhe cilësinë e burimeve mësimore dhe kërkimore.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ku bën pjesë programi i studimit MSC në “Fizikë” ka në përbërjen e tij për tri vite akademike staf si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave të Natyrës	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	35	13	37	10	41	7
Prof.Asc.Dr	40	9	41	7	40	8
Dr/Doc	69	22	78	16	74	17
Msc	29	65	21	49	21	47
Totali	173	109	177	82	176	79

</

	• 9 mbajnë titullin Profesor i Asociuar • 7 janë me gradë “Doktor” Ky numër i PAE-ve tejkalon ndjeshëm minimumin e kërkuar me ligj për themelimin dhe funksionimin e një departamenti akademik, i cili është shtatë (7) PAE. Evidenca: - VKM Nr 418, datë 10.05.2017 për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre, pika 2 shkronja xi dhe shkronja xii. - Aneks Tabelat 6.1,6.2,6.3 “Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Master i Shkencave në Fizikë. - Aneks Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës. - Aneks Tabelat 1 dhe 2 “Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Fizikës është i angazhuar në organizimin dhe mirëfunksionimin e veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Për garantimin e cilësisë dhe zhvillimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, drejtimin e përgjithshëm të veprimtarisë akademike e ushtron drejtuesi i njësisë bazë, i cili ka përgjegjësi për ecurinë institucionale të programit. Për të forcuar marrëdhëniet me studentët dhe për të siguruar një komunikim të rregullt dhe efikas, janë emëruar koordinatorë vjetorë, të cilët ushtrojnë rolin e kujdestarëve akademikë për secilin vit të ciklit të studimeve. Këta kujdestarë shërbejnë si ura lidhëse ndërmjet studentëve dhe strukturave të departamentit. Departamenti është i strukturuar në grupe mësimore-kërkimore, të drejtuara nga përgjegjës grupi, të cilët koordinojnë zhvillimin e lëndëve përkatëse të programeve të ofruara, përfshirë edhe programin Master i Shkencave në “Fizikë”. Aktivitetet laboratorike zhvillohen nën mbikëqyrjen e pedagogëve përgjegjës përkatës për secilën lëndë. Gjatë semestrit të fundit të studimeve, që i dedikohet përgatitjes së temës së diplomës, çdo student caktohet pranë një anëtar të stafit akademik të Departamentit, i cili merr rolin e udhëheqësit apo bashkëudhëheqësit të temës. Ky udhëheqës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e procesit të punës akademike të studentit dhe përgatit mendimin përfundimtar për t'u paraqitur




	përpara komisionit të diplomimit. Përveç udhëheqësit, një anëtar tjetër i Departamentit emërohet si recensues i temës, me detyrën të shqyrtojë punimin dhe të paraqesë mendimin e recensuesit, duke kontribuar në vlerësimin objektiv dhe cilësor të punës së studentit. Evidenca: - <i>Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023, pika 1.2.1 faqe 7</i> - <i>Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Fizikë", neni 7, faqe 3</i>			
Konkluzione	Në programin e studimit Master i Shkencave në "Fizikë" zhvillon mësim një staf pedagogësh i kualifikuar të cilët kanë eksperiencë akademike dhe profesionale me titujt shkencorë. Departamenti i plotëson kriteret ligjore duke angazhuar mbi 80% të stafit akademik si PAE në programin e studimit për akreditim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Fizikës, si njësi bazë përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë", disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të plotë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike. Ky dokumentacion përfshin: • CV-të e stafit akademik të Departamentit të Fizikës të angazhuar në realizimin e programit; • CV-të e personelit akademik të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, të cilët kontribuojnë në procesin mësimor; • Plani mësimor dhe Syllabuset e të gjitha lëndëve të përfshira në program. Struktura, përmbajtja dhe organizimi i ciklit të dytë të studimeve në programin Master i Shkencave në "Fizikë" janë hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me aktet nënligjore përkatëse, si dhe janë të harmonizuara me direktivat dhe praktikat më të mira të hapësirës europiane të arsimit të lartë. Të gjithë anëtarët e Departamentit të Fizikës janë të njohur dhe

	zotërojnë informacion të plotë lidhur me komponentët përbërës të këtij programi studimi, përfshirë: a) sistemin e krediteve ECTS; b) metodat e vlerësimit të njohurive dhe instrumentet përkatëse të kontrollit akademik; c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale që synohen të arrihen; d) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit; e) kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë programin; f) planin mësimor të programit; g) kuotat e pranimit dhe kriteret për përzgjedhjen e studentëve; h) informacion mbi strukturën e grupeve mësimore; i) programet lëndore (Syllabuset) për çdo lëndë; j) profilin akademik dhe profesional të programit; k) modelin e diplomës dhe suplementin përkatës të diplomës. Ky informacion është i dokumentuar dhe i aksesueshëm për qëllime monitorimi të brendshëm, transparence dhe sigurimi cilësie në të gjitha fazat e zbatimit të programit. Evidenca: - VKM nr 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, - Aneks Tabela 10 Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë. (Dosje e programit të studimit)
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Ndarja e ngarkesës mësimore në auditor në orë mësimore fizike për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime/laboratorë) është e përcaktuar në planin mësimor të programit, dhe është ndërtuar në përputhje me numrin përkatës të krediteve ECTS të caktuara për secilin modul. Ngarkesa totale e punës së një studenti gjatë një viti akademik përbën 60 kredite ECTS, ekuivalente me 1,500 orë pune mësimore në vit. Nga këto, jo më pak se 50% (750 orë) duhet të përbëhet nga punë e pavarur. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për të gjitha

	format e mësimdhënies të përfshira në pikën (i), është deri në 25 orë mësimore, ku një orë zgjat 50 minuta. Studenti fiton kreditet përkatëse të një lënde apo moduli vetëm nëse përmbush me sukses kërkesat akademike të parashikuara në syllabus, dhe arrin një vlerësim kalues. Forma e vlerësimit parashikohet në syllabus dhe mund të përfshijë: - kontroll të vazhdueshëm ose përfundimtar, - elemente të vlerësimit të diferencuar sipas lëndës (provime, detyra, prezantime, etj.), - dhe peshën përkatëse të secilit komponent të vlerësimit. Evidenca: - Aneks Tabela 9 – Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A–E) - Aneks Tabela 10 – Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë - Model Syllabus në programin Master i Shkencave në Fizikë - Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave në Fizikë”, Neni 11 dhe 12, Faqe 4 - Vizita ne institucion
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizikë”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, siguron transparencë të plotë dhe akses të garantuar në informacionin e nevojshëm për studentët e interesuar, përfshirë kriteret e përgjithshme dhe specifike që lidhen me: - pranimin dhe ripranimin në program; - transferimin e studimeve; - ekuivalentimin e krediteve dhe njohjen e rezultateve akademike të mëparshme. Pranimi i studentëve në këtë program realizohet në përputhje me: - Nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; - Pikën 1, të Nenit 74 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; - Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 30.06.2023, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë". Kriteret dhe procedurat e pranimit janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në Rregulloren e programit të studimit dhe zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë kandidatët.

	Ndërkohë, transferimi i studimeve dhe procesi i ekuivalentimit rregullohen nga Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ku përcaktohen procedurat për: • transferimin e studimeve brenda të njëjtit cikël studimi; • transferimin dhe njohjen e krediteve për studentët që kalojnë nga institucione të tjera drejt Universitetit të Tiranës; • transferimin dhe ekuivalentimin e programeve të studimit për studentët që vijojnë studimet në universitete të tjera. Këto dispozita sigurojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë të studentëve, si dhe garantimin e standardeve akademike në vijimësinë e studimeve të tyre. Evidenca: - Rregullore e UT-së, Kreu V, Neni 39,44; Kreu VI, Neni 56, 58, - Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Fizikë", neni 28 dhe 29, faqe 9 - Ligji Nr 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 74 pika 1. - Udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë" Faqja web e FSHN-së ku jepen kriteret e pranimit dhe kuotat
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi. Departamenti i Fizikës i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës karakterizohet nga përpikëri institucionale dhe standard i lartë cilësie në hartimin, përditësimin dhe administrimin e syllabus-eve për çdo lëndë dhe modul të përfshirë në programin e studimit <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i>. Syllabuset përgatiten nga titullarët e lëndëve, në përputhje me formatet e miratuara nga njësitë akademike dhe aktet nënligjore në fuqi, dhe përmbajnë informacion të detajuar mbi: • emrin e titullarit/pedagogut përgjegjës; • ngarkesën mësimore (numri i krediteve, orët në auditor të ndara në leksione, seminare dhe praktika); • tipologjinë e lëndës (e detyrueshme apo me zgjedhje); • vitin akademik dhe semestrin kur zhvillohet; • programin e studimit ku ofrohet lënda/moduli; • mënyrën e kontrollit të dijes (pjesëmarrja, format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar);

	- komponentët e vlerësimit me përqindjet përkatëse dhe intervalet e notimit; - kodin e lëndës dhe adresën elektronike të titullarit; - përshkrimin tematik të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve; - literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Në fillim të çdo viti akademik, çdo pedagog është i detyruar të dorëzojë syllabus-in përkatës pranë titullarit të njësisë bazë, i cili më pas e transmeton në njësinë kryesore (Fakulteti). Po ashtu, në fillim të çdo lënde/moduli, pedagogu prezanton dhe shpjegon përmbajtjen e syllabus-it për studentët, duke theksuar modalitetet e zhvillimit të mësimi dhe format e vlerësimit të parashikuara. Dosja zyrtare e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë" përmban të gjithë syllabus-et përkatës, të strukturuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, duke garantuar transparencë, standardizim dhe koherencë akademike. Evidenca: - Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Fizikë", neni 13 faqe 4 - Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", pika 2.8 - Model Syllabus në programin Master i Shkencave
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Departamenti i Fizikës i Fakultetit të Shkencave të Natyrës angazhohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike në përmirësimin cilësor të programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë", duke inkurajuar stafin akademik për të përditësuar përmbajtjen e lëndëve në përputhje me zhvillimet më të fundit në literaturën shkencore dhe botimet bashkëkohore në fushën e fizikës. Procesi i vlerësimit të performancës mësimdhënëse dhe përmbajtjes së kurrikulës mbështetet në analizën vjetore të realizuar nga Fakulteti, ku një ndër treguesit kryesorë është mendimi i studentëve i mbledhur përmes pyetësorëve të strukturuar të vlerësimit të kurseve. Vëmendje e veçantë i kushtohet feedback-ut të studentëve që diplomohen, të cilët ofrojnë informacion të vlefshëm mbi cilësinë e mësimdhënies dhe përmbajtjen e lëndëve në programin Master. Stafi akademik që angazhohet në këtë program rishikon rregullisht nevojën për

	përditësim të materialeve didaktike dhe përmbajtjes së syllabus-it për lëndët përkatëse. Çdo ndryshim i përmbajtjes, i reflektuar në syllabus-in e lëndës, nuk mund të tejkalojë 20% të përmbajtjes së mëparshme, sipas udhëzimeve për standardizimin akademik. Të gjitha ndryshimet në përmbajtjen e lëndëve dhe materialeve mësimore zbatohen vetëm pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në përputhje me dispozitat institucionale dhe rregulloret përkatëse. Evidenca: - <i>Plani strategjik i zhvillimit të departamentit të Fizikës, FSHN UT, 2017-2027, pika 2 dhe 3.a</i> - <i>Rregullore e Departamentit të Fizikës neni 18, faqe 9</i> - <i>Raport vjetor FSHN 2023-2024</i> - <i>Raport mësimor shkencor i Departamentit të Fizikës 2022-2023</i> - <i>Raport vjetor për veprimtaritë e Departamentit të Fizikës 2021-2022</i> - <i>Raport vjetor FSHN 2021-2022</i> - <i>Raport vjetor FSHN 2022-2023, UT</i> - <i>Model Syllabus në programin Master i Shkencave</i> - <i>Vendimi i senatit akademik, Nr. 29, datë 21.10.2020: Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të UT-së, për vitin akademik 2020-2021</i>			
Konkluzione	<i>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë" përmbajnë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Anëtarët e stafit të Departamentit të Fizikës përgjegjës për syllabuset kujdesen për përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë” është projektuar në mënyrë që të sigurojë një formim të gjithanshëm dhe të qëndrueshëm në aspektet teorike, konceptuale dhe eksperimentale të fushës së Fizikës. Struktura e programit dhe veprimtaritë formuese që e shoqërojnë synojnë të përgatisin studentët për t’u specializuar më tej në fusha të ngushta të studimit, duke iu krijuar mundësi për angazhim pranë institucioneve kërkimore brenda vendit, institucioneve të arsimit të lartë, apo për vijimin e studimeve në nivelin e tretë (doktoraturë). Procesi mësimor, i cili përfshin leksione në auditor, ushtrime praktike dhe laboratorë, si dhe komponentë të tjerë si kontrollet e vazhdueshme dhe detyrat e kursit, është konceptuar me dy objektiva kryesore: (1) rritjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe të transmetimit të njohurive nga stafi akademik dhe (2) nxitjen e mendimit kritik dhe krijues te studentët. Gjithashtu, Suplementi i Diplomës përfshin informacion mbi mundësitë potenciale të punësimit për të diplomuarit në këtë program, duke theksuar perspektivat e tyre profesionale pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve. Evidenca: - <i>Suplementi i diplomës (dosja e programit të studimit)</i> - <i>Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, pika 2.8</i> - <i>Model Syllabus në programin Master i Shkencave</i> - <i>Aneks Tabela 10 Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	GVJ konstaton se ndarja e ngarkesës mësimore në auditor për secilën disiplinë të programit të studimit <i>Master i Shkencave në “Fizikë”</i> përcaktohet në mënyrë të detajuar në planin mësimor, në përputhje me numrin e krediteve ECTS të akorduara përkatësisht. Përbërja e orëve mësimore, e ndarë në leksione, seminare dhe laboratorë, ndjek skema të ndryshme raporti në varësi të natyrës së lëndës, ku format më të zakonshme janë: 3:2:0, 2:2:0, 2:3:0, 2:1:1 dhe 0:0:3. Për disa disiplina, bazuar në specifikat përkatëse,

rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	parashikohen gjithashtu detyra kursi, projekte individuale apo aktivitete të tjera praktike që synojnë të nxisin punën e pavarur të studentëve dhe të thellojnë përfshirjen e tyre aktive në procesin e të nxënit. Kjo qasje kontribuon në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe në përvetësimin e kompetencave të avancuara në fusha të ndryshme të Fizikës. Evidenca: - <i>Suplementi i diplomës (dosja e programit të studimit)</i> - <i>Model Syllabus në programin Master i Shkencave</i> - <i>Aneks Tabela 10 Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit <i>Master i Shkencave në “Fizikë”</i> dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtrime (seminar). Organizimi i programit të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë” në Universitetin e Tiranës realizohet në përputhje me parimet e Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke ndjekur një strukturë modulare që siguron transparencë dhe krahasueshmëri ndërkombëtare të përmbajtjes dhe rezultateve të të nxënit. Në këtë kuadër, një kredit ECTS përkon me një ngarkesë mesatare prej 25 orësh pune nga studenti, përfshirë pjesëmarrjen në aktivitete akademike të drejtpërdrejta (leksione, seminare, laboratorë), si dhe studimin e pavarur. Lëndët që përbëjnë programin janë të strukturuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë një shpërndarje sa më të baraspeshuar të ngarkesës mësimore përgjatë secilit semestër. Numri i krediteve për një lëndë apo modul varion zakonisht nga 4 deri në 6 kredite, në varësi të përmbajtjes, rëndësisë dhe objektivave të saj formues. Raporti i orëve mësimore të planifikuara në auditor përcaktohet në përputhje me specifikat e secilës lëndë dhe kontributin e saj në arritjen e kompetencave të parashikuara në program. Për të garantuar përputhshmërinë me standardet akademike bashkëkohore dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të studentëve, ky program është konceptuar duke marrë si referencë modelet e programeve të ngjashme në universitetet europiane dhe ndërkombëtare, me përshtatje të bëra në funksion të kontekstit kombëtar dhe nevojave të tregut të punës. Departamenti i Fizikës mbetet i angazhuar në një

	proces të vazhdueshëm të rishikimit dhe përmirësimit të kurrikulës, duke u bazuar në analizën e përvojës së mëparshme, në zhvillimet bashkëkohore të shkencës së Fizikës dhe në praktikat më të mira të ndjekura nga institucione homologe të arsimit të lartë në nivel ndërkombëtar. Ky angazhim synon të sigurojë cilësinë, aktualitetin dhe konkurrueshmërinë e programit të studimit në arenën akademike dhe profesionale. Evidenca: - <i>Suplementi i diplomës (dosja e programit të studimit)</i> - <i>Aneks Tabela 10 Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë</i> - <i>Aneks Tabela 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve përformancat e mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në Fizikë</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë" në Universitetin e Tiranës është konceptuar në përputhje me standardet më të avancuara të arsimit të lartë, duke synuar ofrimin e një formimi akademik të balancuar ndërmjet përvetësimit të njohurive teorike dhe zhvillimit të aftësive praktike. Struktura modulare e programit, si dhe ngarkesa përkatëse në kredite ECTS për çdo njësi mësimore, janë të dizajnuara në mënyrë që të sigurojnë një integrim të plotë të koncepteve themelore të Fizikës me zbatimet e tyre konkrete në kontekste të ndryshme shkencore dhe teknologjike. Në ndërtimin e këtij programi dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij kurrikulare, janë marrë në konsideratë përvojat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, veçanërisht nga vendet me traditë të konsoliduar në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor. Kjo qasje ka rritur ndjeshëm përputhshmërinë e programit me sistemet arsimore të vendeve të zhvilluara dhe ka lehtësuar ndjeshëm mundësitë për transferim akademik, mobilitet studentor dhe integrim në rrjete kërkimore ndërkombëtare. Si rezultat, studentët e këtij programi kanë mundësi reale për të ndjekur studime të mëtejshme në institucione të tjera të arsimit të lartë në Evropë apo më gjerë, si dhe për të qenë konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës që kërkon kualifikime në nivelin "Master i Shkencave". Një element kyç në këtë drejtim është edhe përfshirja e Suplementit të Diplomës, i cili është hartuar në përputhje me udhëzimet e përbashkëta të Komisionit European, Këshillit të Europës dhe UNESCO/CEPES. Suplementi i Diplomës ofron informacion të

	detajuar, objektiv dhe të standardizuar mbi natyrën, nivelin, përmbajtjen, kontekstin dhe statusin e studimeve të përfunduara nga studenti, duke rritur ndjeshëm transparencën dhe lehtësuar njohjen akademike dhe profesionale të kualifikimeve në kontekst ndërkombëtar. Për më tepër, në kuadër të bashkëpunimeve ndëruniversitare dhe skemave të mobilitetit akademik, një pjesë e studentëve të këtij programi kanë përfituar mundësinë për të realizuar temën e diplomës në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, duke forcuar më tej përgatitjen e tyre profesionale dhe aftësinë për të operuar në mjedise të ndryshme akademike dhe kërkimore. Evidenca: - <i>Suplementi i diplomës (dosja e programit të studimit)</i> - <i>Marrëveshja për programin Erasmus për kryerjen e diplomës së Masterit për studenten Sara Hidri</i> - <i>Vizita ne Institucion</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion GJV konstaton se syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik për të futur literaturat e reja, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit. Fakulteti i Shkencave Natyrore (FSHN) dhe Departamenti i Fizikës, në kuadër të përmbushjes së misionit të tyre akademik dhe në funksion të garantimit të cilësisë së arsimit të lartë, zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme procese të brendshme vlerësimi dhe analize të ecurisë së programeve të studimit. Këto analiza realizohen në nivel fakulteti dhe departamenti dhe mbështeten në një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë jo vetëm kontributin profesional të stafit akademik, por edhe opinionet dhe vlerësimet e studentëve lidhur me përmbajtjen, organizimin dhe cilësinë e moduleve individuale. Në bazë të gjetjeve të këtyre analizave, ndërmerren masa konkrete për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit. Këto masa mund të përfshijnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve, si dhe riorganizimin e strukturës lëndore me qëllim përputhjen e përmbajtjes me kërkesat akademike bashkëkohore dhe me dinamikën e zhvillimeve shkencore. Procesi i hartimit dhe rishikimit të syllabuseve për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë" është zhvilluar në përputhje të plotë me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, konkretisht pika 2.8, e cila përshkruan elementët thelbësorë të përfshirë në një syllabus standard. Çdo syllabus përfshin në mënyrë të strukturuar: pasqyrën informative të

	lëndës, objektivat mësimore dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, përmbajtjen konceptuale dhe temat e detajuara, format dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, kërkesat për pjesëmarrje dhe ndjekje të rregullt, metodat e kontrollit të vazhdueshëm, si dhe përfundimet apo rekomandimet e pedagogut përkatës. Një komponent i rëndësishëm i syllabusit është literatura mësimore, e ndarë në literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse, të cilat përzgjidhen në përputhje me natyrën dhe tipologjinë e secilës lëndë. Në rastin e lëndëve teorike fundamentale, të cilat ndjekin modelet klasike të arsimit në universitetet ndërkombëtare, literatura përbëhet kryesisht nga tekste standarde të njohura dhe të pranuara gjerësisht në komunitetin akademik ndërkombëtar. Ndërkohë, për lëndët me karakter praktik ose aplikativ, literatura përfshin burime më moderne dhe të përditësuara, të cilat reflektojnë zhvillimet e fundit në fushën përkatëse. Kjo qasje siguron një përmbajtje të balancuar ndërmjet traditës akademike dhe përparimeve bashkëkohore, duke e bërë programin e studimit tërheqës dhe të përshtatshëm për përgatitjen e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe të kërkimit shkencor. Evidenca: - VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve tëstudimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë": Pika 2.8 dhe Shtojca Nr.2 - Model Syllabus në programin Master i Shkencave - Aneks Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Natyrore në Universitetin e Tiranës, është ndërtuar mbi një strukturë të qartë akademike që synon përgatitjen e specialistëve me formim të thelluar dhe të gjithanshëm në fushën e Fizikës. Fokusi themelor i këtij programi përqendrohet në disa drejtime kyçe, të cilat përfaqësojnë qëllimet strategjike të tij: • <i>Përvetësimi i njohurive themelore dhe zhvillimi i aftësive specifike:</i> Programi synon t'u ofrojë studentëve një kuadër të plotë njohurish mbi parimet dhe metodat bazë të Fizikës, duke u siguruar atyre një formim solid teorik dhe praktik, si dhe zhvillimin e shprehive të nevojshme për të aplikuar këto njohuri në situata konkrete shkencore dhe profesionale.

- *Aftësimi i studentëve në disiplina të ndryshme të Fizikës:* Njëpërmjet lëndëve të specializuara dhe moduleve të fokusuara, studentët pajisen me kompetenca të avancuara në fusha të ndryshme të Fizikës, çka u mundëson atyre një orientim të suksesshëm drejt tregut të punës apo drejt vazhdimit të studimeve në ciklin e tretë (doktoraturë), brenda ose jashtë vendit.
- *Zhvillimi i mendimit kritik dhe krijues:* Një nga objektivat kryesorë të programit është nxitja e mendimit të pavarur, kritik dhe analitik të studentëve, si një bazë e domosdoshme për angazhim në kërkimin shkencor dhe për zhvillimin profesional afatgjatë.
- *Aftësimi praktik dhe rritja e vetëbesimit në përdorimin e metodave eksperimentale:* Programi ofron një komponent të fuqizuar laboratorik, që u mundëson studentëve të fitojnë përvojë të drejtpërdrejtë me metodat eksperimentale, të cilat përbëjnë bazën e zhvillimit të mëtejshëm të Fizikës si shkencë. Kjo qasje u jep studentëve besim dhe autonomi në zbatimin e njohurive të marra në mjedise reale kërkimore apo industriale.
- *Formimi në përdorimin e metodave moderne të kërkimit shkencor:* Një vend të veçantë në program zënë metodologjitë bashkëkohore të kërkimit shkencor, përfshirë përdorimin e teknikave numerike, modelimeve kompjuterike dhe analizave statistikore të avancuara, të cilat janë thelbësore në kërkimin modern në Fizikë.

Përmbajtja e programit dhe struktura e moduleve janë në përputhje të plotë me rezultatet e pritura të të nxënit dhe garanton përvetësimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për një formim të thelluar akademik dhe profesional. Objektivat mësimorë dhe përmbajtja e secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë dhe transparente, duke siguruar që çdo komponent i programit kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e profilit përfundimtar të diplomantit.

Evidenca:

- *Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, kapitulli 1, faqe 6-9*
- *Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Fizikë", neni 10, faqe 4*
- *Suplementi i diplomës*

	- <i>Model Syllabus në programin Master i Shkencave</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit, duke kombinuar teorinë me praktikën, siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e Fizikës dhe disiplinave të saj. Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Natyrore në Universitetin e Tiranës, është konceptuar për të garantuar një formim të avancuar akademik dhe profesional që i mundëson studentëve një gamë të gjerë mundësish për zhvillim të mëtejshëm, si në aspektin akademik ashtu edhe në tregun e punës. Përmbajtja dhe struktura e programit janë të përshtatura në mënyrë që të krijojnë bazën e nevojshme për ndjekjen e studimeve në ciklin e tretë (doktoraturë), si në institucione të arsimit të lartë brenda vendit ashtu edhe në universitete prestigjioze jashtë tij. Njëkohësisht, përgatitja e përfutur nga ky program u mundëson të diplomuarve të jenë konkurrues për punësim në institucione kërkimore, në universitete publike dhe private, në agjenci dhe administratë shtetërore, si dhe në sektorin privat. Orientimi drejt një karriere akademike, kërkimore apo profesionale është i lidhur jo vetëm me kriteret objektive të përgatitjes akademike, por edhe me aspiratat individuale të studentëve, të cilët mund ta kanalizojnë investimin e tyre në dije drejt një karriere në sektorin publik, privat apo drejt angazhimit ndërkombëtar. Departamenti i Fizikës mbështet aktivisht studentët dhe të diplomuarit e tij në këtë rrugëtim përmes një bashkëpunimi të ngushtë pedagog–student, i cili përfshin jo vetëm mentorimin gjatë procesit mësimor, por edhe asistencën për mundësitë pasdiplomimit. Një ndër format më të zakonshme të kësaj mbështetjeje është ofrimi i letrave të rekomandimit nga stafi akademik për studentët që aplikojnë për punësim apo për vazhdim të studimeve në cikle më të avancuara, veçanërisht jashtë vendit. Bazuar në të dhënat dhe përvojën e viteve të fundit, një përqindje shumë e lartë e studentëve të diplomuar në këtë program kanë ndjekur me sukses studime doktorale në universitete të huaja, janë angazhuar në projekte kërkimore ndërkombëtare, janë punësuar në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri apo kanë ndërtuar karriera të suksesshme në administratën publike dhe në sektorin privat, duke konfirmuar vlerën praktike dhe akademike të këtij programi në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca:

	- Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizike", neni 6 faqe 3 - Raport vjetor FSHN 2023-2024 - Raport vjetor për veprimtaritë e Departamentit të Fizikës 2021-2022 - Raport vjetor FSHN 2021-2022 - Raport vjetor FSHN 2022-2023, UT			
Konkluzione	Përmbajtja dhe Organizimi në module/lëndë në Programin e studimit Master i Shkencave në "Fizikë", krijon mundësinë e formimit profesional të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitet përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ vlerëson se Departamenti i Fizikës vlerëson periodikisht zhvillimet e detajuara të tregut për të përmirësuar kurrikulën e programit të studimit të ofruar në përputhje me mundësitë e punësimit të ofruara në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës, organizon në mënyrë periodike Panairët e Karrierës, me qëllim krijimin e një platforme interaktive ndërmjet studentëve dhe përfaqësuesve të tregut të punës. Këto aktivitete synojnë të lehtësojnë tranzicionin e studentëve nga arsimi në punësim, duke i ndihmuar ata të njohin më mirë mundësitë profesionale që u ofrohen dhe të ndërtojnë një qasje të orientuar drejt karrierës. Në kuadër të këtyre panairëve, studentët kanë mundësinë të komunikojnë drejtpërdrejt me përfaqësues të institucioneve publike dhe kompanive private, të cilat prezantojnë pozicionet e tyre vakante, mundësitë për praktika profesionale (internship) dhe programe të zhvillimit të karrierës. Këto panairë shërbejnë

	gjithashtu si një mundësi për të eksploruar kërkesat dhe tendencat e tregut të punës, për të marrë këshilla nga profesionistë të fushës dhe për të krijuar lidhje që mund të rezultojnë në punësim të ardhshëm. Në këtë kontekst, Departamenti i Fizikës, si një njësi akademike dinamike dhe e përkushtuar ndaj zhvillimit profesional të studentëve, është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimeve me operatorë të ndryshëm të tregut. Këto bashkëpunime janë formalizuar përmes marrëveshjeve institucionale me një sërë subjektsh, që përfshijnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë: • industrinë prodhuese, ku nevojitet ekspertizë në fizikat teknike dhe aplikative; • kompanitë e teknologjisë së informacionit, që operojnë në fushat e analizës së të dhënave (data analysis), shkencës së të dhënave (data science) dhe zhvillimeve të bazuara në modele fizike apo algoritme numerike; • qendra kërkimore dhe laboratorë, që ofrojnë mundësi për praktika profesionale dhe përfshirje në projekte shkencore. Këto marrëveshje krijojnë një urë lidhëse ndërmjet formimit akademik të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës, duke u ofruar atyre një përvojë të vlefshme praktike dhe një avantazh konkurrues në përgatitjen për karrierën e tyre të ardhshme. Përmes këtij bashkëpunimi, Departamenti i Fizikës synon të forcojë lidhjen ndërmjet arsimit dhe industrisë, si dhe të promovojë integrimin e të diplomuarve në tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës. Evidenca: - Raport vjetor FSHN 2022-2023, UT - Panairi i punës "Work and Study", 2023 - Aneks Tabela 5 "Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale" komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit	GVJ vlerëson se nga Institucioni bëhen përpjekje për të mbështur studentët për tu përfshirë në strukturat vendimarrëse të tij. Ai nxit që në mbledhjet e Departamentit, Senatit Akademik përfaqësuesi i studentëve nga Këshilli Studentor dhe çdo student apo i diplomuar të marrë pjesë në diskutimet dhe konsultimet për përmirësimin e programit të studimit. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë", Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe në veçanti




të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Departamenti të Fizikës, zbaton një proces të strukturuar të mbledhjes së të dhënave nga studentët, me qëllim vlerësimin cilësor të përvojës akademike dhe identifikimin e hapësirave për përmirësim. Ky proces përfshin plotësimin nga ana e studentëve të pyetësorëve të standardizuar, të cilët mbulojnë një gamë të gjerë aspektesh që lidhen me: • përvojën e tyre gjatë ciklit të studimeve; • vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies; • përmbajtjen dhe strukturën e moduleve; • rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e fituara; • përgatitjen e tyre për integrim në tregun e punës; • vlerësimin e përvojës gjatë hartimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës; • aspektet organizative dhe mbështetjen institucionale gjatë studimeve. Pyetësorët ofrojnë të dhëna të vlefshme për performancën e përgjithshme të programit, si dhe ndihmojnë në identifikimin e komponentëve që kërkojnë ndërhyrje apo zhvillim të mëtejshëm. Këto të dhëna analizohen në mënyrë sistematike nga njësitë përkatëse akademike dhe administrative, duke u bërë bazë për vendimmarrje të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit. Paralelisht me këtë proces, Departamenti i Fizikës mban marrëdhënie të qëndrueshme dhe të rregullta me Këshillin e Studentëve, duke siguruar një kanal efektiv komunikimi dhe dialogu të vazhdueshëm ndërmjet studentëve dhe stafit akademik. Ky bashkëpunim institucional garanton një përfshirje aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse që lidhen me zhvillimin e programeve mësimore, si dhe rrit ndjeshëm ndjeshmërinë ndaj nevojave dhe pritshmërive të tyre. Përmes këtij mekanizmi të dyfishtë të feedback-ut të strukturuar dhe dialogut të hapur, Departamenti siguron jo vetëm një vlerësim të vazhdueshëm të cilësisë së programit, por edhe një përafrim të vazhdueshëm të përmbajtjes akademike me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe me zhvillimet bashkëkohore në fushën e Fizikës. Ky proces përbën një komponent thelbësor në strategjinë e sigurimit të cilësisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të programit të studimit.
	Evidenca: - Vizita në institucion
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson,	GVJ vlerëson se nga Institucioni mbahen kontakte të vazhdueshme me aktorë të tregut të punës për të përmirësuar kurrikulën e

përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	programit të studimit nëpërmjet ngritjes së Grupeve të Ekspertëve në kuader të rishikimit të kurrikulës së programit të studimit master i shkencave. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Fizikës, në përmbushje të detyrimeve të tyre institucionale dhe në kuadër të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, kryejnë në mënyrë periodike analizën e brendshme të programeve të studimit në nivel fakulteti dhe departamenti. Ky proces zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera përgjegjëse brenda Universitetit të Tiranës dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe me rekomandimet profesionale të institucioneve përkatëse të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Analiza vjetore e programeve bazohet në mbledhjen dhe përpunimin e vlerësimeve dhe opinioneve të stafit akademik dhe studentëve, duke marrë në konsideratë përmbajtjen, efektivitetin, metodologjinë e mësimdhënies, si dhe përputhjen e lëndëve me zhvillimet shkencore dhe kërkesat e tregut të punës. Në bazë të këtyre të dhënave dhe duke respektuar dispozitat e akteve normative – konkretisht Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, pika 2.8 – ndërmerren masa për përditësimin dhe riorganizimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë rishikimin e syllabus-eve dhe ristrukturimin e lëndëve. Çdo syllabus është hartuar në përputhje me standardet e kërkuara dhe përfshin komponentët kryesorë që sigurojnë transparencë dhe qartësi në procesin mësimor: • përshkrimin informativ të lëndës, • rezultatet e pritshme të të nxënit, • konceptet themelore dhe temat e detajuara, • format dhe kriteret e vlerësimit të dijeve, • kërkesat për pjesëmarrje aktive, • vlerësimin e vazhdueshëm gjatë semestrit, • literaturën bazë dhe atë ndihmëse, • si dhe vërejtjet përfundimtare nga pedagogu. Përzgjedhja e literaturës është e orientuar sipas natyrës së lëndës: për lëndët teorike përdoren kryesisht tekste klasike ndërkombëtare që ofrojnë një bazë të qëndrueshme dhe të njohur gjerësisht në komunitetin shkencor, ndërsa për lëndët me karakter praktik përdoret literaturë bashkëkohore, e cila përditësohet rregullisht për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushë. Ky proces i vazhdueshëm i reflektimit dhe përmirësimit të kurrikulës siguron përputhjen e përmbajtjes mësimore me kërkesat bashkëkohore të arsimit dhe kërkimit, si dhe me standardet kombëtare dhe
--	---

	ndërkombëtare të cilësisë. Për më tepër, rekomandimet që rrjedhin nga këto analiza ndikojnë drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve të kërkimit shkencor brenda Departamentit të Fizikës. Ato udhëzojnë për përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies, për zhvillimin e moduleve të reja ndërdisiplinore dhe për avancimin e fushave prioritare të kërkimit. Kjo i mundëson stafit akademik të zgjerojë potencialin shkencor dhe pedagogjik, ndërsa studentëve u ofron një përgatitje më të thelluar, më të përditësuar dhe më të përputhshme me zhvillimet globale në shkencë dhe teknologji. Evidenca: - VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë": Pika 2.8 dhe Shtojca Nr.2 - Model Syllabus në programin Master i Shkencave - Aneks Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive			
Konkluzione	Departamenti i Fizikës dhe anëtarët e stafit të tij nxisin përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike. Në riorganizimin e tij kontribut kanë dhënë të gjithë grupet e interesit duke shprehur qartas mendimin e tyre. Programi i studimit Master në Fizikë është rishikuar duke bërë edhe përmirësime.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit të ciklit të dytë <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i> , i ofruar nga Departamenti i Fizikës në Fakultetin e Shkencave Natyrore, ndërtohet mbi një përvojë akademike mbi dhjetëvjeçare në këtë fushë dhe është konceptuar në përputhje me kërkesat bashkëkohore të formimit shkencor dhe profesional të studentëve. Ky program synon të ofrojë një trajnim të thelluar teorik dhe praktik, duke i pajisur studentët me njohuri të avancuara dhe kompetenca të specializuara që i përgatisin për karrierë në kërkimin shkencor, industri, arsim dhe institucione të tjera të specializuara. Përbërësit kryesorë të programit përfshijnë një bërthamë të fortë lëndësh

	themelore të avancuara, të tilla si: Mekanika Kuantike e Avancuar, Fizika Statistike e Avancuar, Teoria e Përgjithshme e Relativitetit, dhe Dinamika Jolineare. Këto lëndë janë të domosdoshme për formimin e një profili të qëndrueshëm të fizikantit modern dhe krijojnë bazën për kuptimin e koncepteve të avancuara në fizikën teorike dhe të aplikuar. Paralelisht me lëndët themelore, programi përfshin një gamë të gjerë lëndësh të specializuara dhe aplikative, ndër të cilat përmendim: Fizika Mjekësore dhe Biofizika, Fizika e Materialeve, Fizika e Trupit të Ngurtë, Fizika Llogaritëse, Spektrometria, Fizika e Grimeve Elementare dhe Fizika e Mjedisit. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre lëndëve adresojnë fusha me interes të veçantë kombëtar dhe ndërkombëtar në kontekstin e kërkimit shkencor dhe teknologjik, duke u shoqëruar me punë laboratorike praktike që mbështesin zhvillimin e aftësive eksperimentale dhe analitike të studentëve. Falë përmbajtjes së balancuar ndërmjet komponentit teorik dhe atij aplikativ, si dhe përqendrimit në tematika që pasqyrojnë prioritetet aktuale të zhvillimit shkencor dhe teknologjik, ky program studimi përgatit studentët për integrim të suksesshëm në tregun e punës dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës në fusha të ndryshme të fizikës dhe shkencave të ndërlidhura. Evidenca - Model Syllabus në programin Master Shkencor - Plan i mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) - Plan i mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	GVJ kostaton se brenda Departamentit të Fizikës dhe nga bashkëpunimi midis njësive kryesore të UT ekziston një bashkëpunim i mirë në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Departamenti nxit dhe ka një rol aktiv në drejtim të bashkërendimit dhe administrimit të veprimtarisë kërkimore. Stafi akademik i angazhuar në programin e ciklit të dytë <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i> përbëhet nga pedagogë me përgatitje të lartë akademike, të cilët zotërojnë minimalisht gradën shkencore "Doktor" (Dr.), në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet institucionale të arsimit të lartë. Ky personel përfshin si staf me kohë të plotë ashtu edhe me kohë të pjesshme, dhe është i përbërë nga anëtarë të Departamentit të Fizikës dhe nga pedagogë të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, njësi kërkimore-akademike e integruar në Universitetin e Tiranës. Stafi përbëhet kryesisht nga titullarë të kualifikuar me titujt akademikë "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar", si dhe nga pedagogë

të rinj të pajisur me gradën “Doktor”. Për pozicionin e “Asistent Lektorë”, punësimi realizohet me kontratë me kohë të caktuar, në përputhje me dispozitat përkatëse të kuadrit ligjor dhe rregullator të Universitetit të Tiranës dhe legjislacionit kombëtar për arsimin e lartë. Ngarkesa dhe veprimtaria mësimore e stafit akademik përcaktohet dhe administrohet sipas Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe udhëzimeve pasuese nr. 36, datë 23.11.2018, dhe nr. 37, datë 04.12.2018, të cilat përfshijnë ndryshime dhe përditësime në përmbajtjen e udhëzimit fillestar. Personeli akademik respekton plotësisht normat dhe parashikimet e përcaktuara në këto udhëzime, duke garantuar standarde të larta në mësimdhënie dhe formim shkencor. Përveç angazhimit të tyre në procesin mësimor, anëtarët e stafit akademik janë aktivë në fushën e kërkimit shkencor, duke udhëhequr rregullisht studentë të nivelit Master dhe të ciklit të tretë (doktoraturë), si dhe duke marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Rezultatet e këtyre angazhimeve reflektohen në publikime shkencore në revista të indeksuara dhe në pjesëmarrje me kumtesa në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, çka kontribuon në zhvillimin profesional të stafit dhe rritjen e profilit akademik të programit të studimit.

Evidenca

- *Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 66, faqe 41,*
- *Rregullore e Departamentit të Fizikës, neni 10, faqe 4*
- *Ligji Nr 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni 59, pika 3,4,5 dhe Neni 64, pika 2*
- *Udhëzimi i MASR Nr.29, datë 10.09.2018: Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, kapitulli 1 dhe 2.*
- *Udhëzimet nr. 36, date 23.11.2018 dhe nr.37, datë 04.12.2018 për “Një ndryshim në udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.*
- *Udhëzim nr 37 datë 04.12.2018 për “Një ndryshim në udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.*
- *CV-të e stafit akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë*



Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Departamenti i Fizikës, në kuadër të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë”, ka vendosur një sërë mekanizmesh për të inkurajuar dhe përfshirë studentët në veprimtari kërkimore-shkencore, duke synuar forcimin e kompetencave të tyre akademike dhe profesionale. Kjo politikë mbështetet në promovimin aktiv të kulturës së kërkimit shkencor dhe në krijimin e hapësirave të përshtatshme për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të studentëve në projekte të ndryshme hulumtuese. Një nga format më të zakonshme të përfshirjes së studentëve është bashkëpunimi me stafin akademik në kuadër të projekteve kërkimore ekzistuese. Pedagogët me përvojë, të angazhuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, ftojnë rregullisht studentët të kontribuojnë në këto iniciativa, duke u ofruar mundësi të personalizuar që lidhen me fushat e tyre të interesit dhe objektivat e tyre afatgjata akademike. Për më tepër, studentët inkurajohen të paraqesin edhe temat e tyre të pavarura, të cilat, me mbështetjen e pedagogëve, mund të shndërrohen në projekte kërkimore të mirëstrukturuara. Në funksion të nxitjes së iniciativës kërkimore, Departamenti organizon periodikisht aktivitete dedikuar shkëmbimit shkencor, si seminare, tryeza diskutimi, ditë kërkimi, si dhe sesione prezantimi të rezultateve paraprake të projekteve të studentëve. Këto forume shërbejnë si platformë për reflektim kritik, ndarjen e ideve dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor ndërmjet studentëve dhe stafit akademik. Për të lehtësuar përfshirjen e studentëve në kërkim, një pjesë e projekteve janë të mbështetura financiarisht nga fonde institucionale, grante konkurruese ose programe bashkëpunimi me partnerë të jashtëm. Kjo mbështetje shfaqet në forma të ndryshme, si bursa kërkimore, pagesa për angazhimin në projekt, ose shpërblime për performancën dhe kontributin e dhënë. Në këtë mënyrë, studentëve u mundësohet të angazhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar në veprimtari kërkimore cilësore. Përmes këtij angazhimi në kërkim, studentët përfitojnë një përvojë të çmuar që përfshin thellimin e njohurive teorike, zhvillimin e aftësive praktike dhe hulumtuese, si dhe përvetësimin e kompetencave të rëndësishme për punën në grup, menaxhimin e projekteve dhe komunikimin shkencor. Të gjitha këto elementë janë thelbësore për zhvillimin profesional të studentëve, si në vazhdimësinë akademike (në nivelin e doktoratës), ashtu edhe në integrimin në tregun e punës dhe në fushat e kërkimit të aplikuar. Evidenca: - Vizita në institucion
--	---

Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.

Departamenti i Fizikës, në përputhje me misionin e tij për të nxitur kërkimin shkencor cilësor dhe të qëndrueshëm, siguron mbështetje financiare nga një sërë burimesh të ndryshme, me theks të veçantë te fondet publike kombëtare dhe ndërkombëtare, por gjithashtu edhe nga partneritete me sektorin privat. Këto fonde luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe përparimin e kapaciteteve kërkimore të departamentit, duke mundësuar realizimin e projekteve shkencore me ndikim të gjerë akademik dhe shoqëror.

Mbështetja financiare shfrytëzohet për:

- Zhvillimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore të avancuara në fusha prioritarë të fizikës;
- Realizimin e eksperimentimeve laboratorike dhe modelimeve teorike me standarde bashkëkohore;
- Përmirësimin dhe përditësimin e infrastrukturës kërkimore, përfshirë laboratorët, pajisjet dhe softuerët shkencorë;
- Nxitjen e bashkëpunimeve ndër-institucionale, ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare me universitete, institute kërkimore dhe industri të specializuara;
- Pjesëmarrjen e studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë në projekte kërkimore, duke forcuar lidhjen midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Përmes përdorimit të qëndrueshëm dhe efikas të këtyre fondeve, departamenti siguron një mjedis kërkimor aktiv dhe të hapur ndaj inovacionit, duke kontribuar në formimin e një kulture akademike moderne dhe konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, përfshirja e studentëve në aktivitetet kërkimore, e lehtësuar nga këto investime, rrit ndjeshëm kompetencat e tyre praktike dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve, duke i përgatitur për sfidat e tregut global të punës dhe për avancimin në studimet doktorale.

Përmbledhje të dhënash mbështetëse (referencë ndaj anekseve):

Aneksi Përmbajtja

Përshkrimi institucional

Aneks Tabela 18
Të ardhurat dhe financimet ndryshme në vitet e fundit

Tabela ofron një panoramë të burimeve financiare të siguruara nga Departamenti i Fizikës nëpërmjet projekteve të fituara, e bashkëpunimeve me institucionet publike si AKKSHI dhe QKAK, si dhe donacioneve apo partneriteteve me sektorin privat. Të dhënat reflektojnë trendin rritës të kapaciteteve financuese

	dhe ndikimin pozitiv në përmirësimin e infrastrukturës kërkimore. Tabela paraqet angazhimin e stafit akademik në botime shkencore të indeksuara, pjesëmarrje në konferenca Aneks Të dhëna për ndërkombëtare, projekte të financuara Tabela kërkimin shkencor nga programe si Horizon Europe dhe 19 të stafit akademik Erasmus+, si dhe drejtimin e studentëve në punime kërkimore. Këto të dhëna dëshmojnë një veprimtari kërkimore aktive dhe me ndikim të matshëm. Tabela pasqyron marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit dhe Departamentit të Fizikës me institucione akademike dhe kërkimore brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë partneritete me universitete europiane, institute shkencore dhe entitete industriale. Këto bashkëpunime janë thelbësore për shkëmbimin e njohurive, mobilitetin akademik dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit edhe për kërkimin shkencor gjithashtu. Evidenca: - Aneks Tabela 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit - Aneks Tabela 19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit - Aneks Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit
Konkluzione	GVJ konstaton se brenda Departamentit të Fizikës orientohet drejt bashkëpunimi midis njësive kryesore dhe brenda UT ekziston një bashkëpunim i mirë në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe kërkimit shkencor.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë" mbështetet në një infrastrukturë të specializuar laboratorike, e cila është e vendosur pranë Departamentit të Fizikës dhe shërben si një komponent thelbësor për realizimin e formimit praktik të studentëve. Përdorimi i laboratorëve mësimorë dhe kërkimorë është i integruar ngushtësisht në planin mësimor të programit, duke u përshtatur me lëndët përkatëse dhe duke siguruar një përvojë të drejtpërdrejtë eksperimentale në fushat përkatëse të fizikës së aplikuar. Gjatë zhvillimit të orëve laboratorike, veç pedagogëve të specializuar që drejtojnë lëndët, asistojnë edhe anëtarë të stafit ndihmës akademik, të cilët janë përgjegjës për organizimin, mbarëvajtjen dhe sigurinë teknike të punës laboratorike. Në funksion të zbatimit të programit Master, janë të angazhuar katër (4) punonjës ndihmës akademik, të cilët mbështesin drejtpërdrejt pedagogët në përgatitjen dhe zhvillimin e seancave praktike, duke kontribuar në ruajtjen e standardeve të cilësisë në mësimdhënie. Aktivitetet laboratorike zhvillohen në kuadër të shtatë laboratorëve tematikë të cilët mbulojnë fushat kryesore të programit, si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emërtimi i Laboratorit</th><th>Funksioni në program</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Laboratori i Fizikës së Mjedisit</td><td>Ofron njohuri praktike mbi analizën dhe matjet e faktorëve fizikë mjedisorë</td></tr> <tr> <td>Laboratori i Biofizikës</td><td>Aplikon konceptet e fizikës në sistemet biologjike dhe mjekësore</td></tr> <tr> <td>Laboratori i Trupit të Ngurtë</td><td>Fokus në karakteristikat mekanike dhe strukturore të materialeve të ngurta</td></tr> <tr> <td>Laboratori i Fizikës së Materialeve 1</td><td>Hulumton strukturën, përbërjen dhe vetitë e materialeve</td></tr> </tbody> </table>	Emërtimi i Laboratorit	Funksioni në program	Laboratori i Fizikës së Mjedisit	Ofron njohuri praktike mbi analizën dhe matjet e faktorëve fizikë mjedisorë	Laboratori i Biofizikës	Aplikon konceptet e fizikës në sistemet biologjike dhe mjekësore	Laboratori i Trupit të Ngurtë	Fokus në karakteristikat mekanike dhe strukturore të materialeve të ngurta	Laboratori i Fizikës së Materialeve 1	Hulumton strukturën, përbërjen dhe vetitë e materialeve
Emërtimi i Laboratorit	Funksioni në program										
Laboratori i Fizikës së Mjedisit	Ofron njohuri praktike mbi analizën dhe matjet e faktorëve fizikë mjedisorë										
Laboratori i Biofizikës	Aplikon konceptet e fizikës në sistemet biologjike dhe mjekësore										
Laboratori i Trupit të Ngurtë	Fokus në karakteristikat mekanike dhe strukturore të materialeve të ngurta										
Laboratori i Fizikës së Materialeve 1	Hulumton strukturën, përbërjen dhe vetitë e materialeve										

	Laboratori i Fizikës së Materialeve 2	Zhvillon metoda të avancuara të analizës së materialeve
	Laboratori i Karakterizimit të Materialeve	Përdor teknika spektroskopike dhe difraksioni për analizë strukturore
	Laboratori i Fizikës Llogaritëse	Trajton modelime numerike dhe simulime kompjuterike në fizikë
Evidenca: - Rregullore e Departamentit të Fizikës, neni 11, faqe 5 - Model Syllabus në programin Master i Shkencave - CV-të e stafit akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë (dosja e programit të studimit)		
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë (PAE) të angazhuar në procesin e mësimdhënies dhe në veprimtarinë kërkimore pranë Departamentit të Fizikës përmbushin të gjitha kriteret profesionale dhe shkencore të kërkuara për zhvillimin me cilësi të lartë të programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë". Ky personel përbëhet nga pedagogë të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë, të cilët gëzojnë përvojë të konsiderueshme akademike, kërkimore dhe pedagogjike, si dhe janë aktivë në publikime dhe projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në përputhje me objektivat e programit të studimit, ekspertiza shkencore dhe fushat e interesit të anëtarëve të stafit akademik janë të dokumentuara në mënyrë të qartë në dosjet profesionale dhe curriculum vitae përkatëse. Këto përfshijnë, ndër të tjera: • pjesëmarrje në projekte të financuara nga programe si Horizon Europe, Erasmus+ apo AKKSHI; • publikime në revista shkencore të indeksuara ndërkombëtarisht (Scopus, Web of Science, etj.); • prezantime në konferenca shkencore me komitet ndërkombëtar; • përfshirje në udhëheqjen e studimeve të nivelit Master dhe Doktoratë. Analiza e CV-ve të stafit dëshmon përputhshmëri të plotë ndërmjet fushave të kërkimit të tyre shkencor dhe lëndëve/modulëve që ata mbulojnë në program. Kjo koherencë siguron jo vetëm një mësimdhënie të përditësuar dhe të bazuar	

	në zbulimet më të fundit shkencore, por edhe integrimin organik të kërkimit në mësimdhënie, në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë. Gjithashtu, përputhshmëria ndërmjet ekspertizës së stafit dhe drejtimeve strategjike të kërkimit të Departamentit të Fizikës garanton kohezionin dhe orientimin e qëndrueshëm të zhvillimit akademik. Fushat prioritare të kërkimit ku kontribuon personeli akademik përfshijnë: fizikën e materialeve dhe nanoteknologjinë, fizikën teorike dhe kompjuterike, biofizikën dhe aplikimet mjekësore të fizikës, fizikën e mjedisit, spektroskopinë, dhe fizikën e grimcave elementare – fusha të cilat janë të përfaqësuara si në përmbajtjen e planit mësimor, ashtu edhe në projektet kërkimore të zhvilluara nga departamenti. Në këtë mënyrë, kapacitetet akademike dhe shkencore të personelit kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë dhe relevancës së programit të studimit, duke ndërtuar një mjedis të përshtatshëm për formimin e qëndrueshëm akademik dhe profesional të studentëve. Evidenca: - CV-të e stafit akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë (dosja e programit të studimit) - Aneks Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Fizikë në një vit akademik
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët janë inkurajuar të marrin pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga UT. Departamenti i Fizikës, në përputhje me strategjinë institucionale për ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe formuese, angazhohet rregullisht në organizimin e aktiviteteve akademike me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto aktivitete synojnë të nxisin shkëmbimin shkencor, të përforcojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe të kontribuojnë në përgatitjen e avancuar të studentëve dhe stafit akademik në fusha bashkëkohore të fizikës dhe shkencave të ndërlidhura. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të organizuara nga Departamenti, veçanërisht spikat Konferenca Ndërkombëtare mbi Meteorologjinë dhe Shkencat e Klimës, e organizuar në bashkëpunim me aktorë të tjerë akademikë dhe shkencorë. Kjo konferencë përfaqëson një platformë të rëndësishme për diskutimin e çështjeve emergjente që lidhen me

	ndryshimet klimatike, modelimin atmosferik, ndikimet mjedisore dhe zhvillimet teknologjike në meteorologji. Në edicionet e saj kanë marrë pjesë studiues dhe profesionistë të fushës nga Shqipëria dhe vende të tjera europiane, duke mundësuar një shkëmbim të vlefshëm ekspertizash dhe nxitjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare në kërkimin shkencor. Në të njëjtën linjë, Departamenti organizon edhe shkolla verore dhe dimërore në fushën e Shkencës së të Dhënave, me fokus në aplikimin e metodave moderne të analizës numerike, inteligjencës artificiale dhe machine learning në problematika të fizikës eksperimentale, kompjuterike dhe teorike. Këto shkolla përfshijnë trajnime intensive, leksione të specializuara dhe sesione praktike të zhvilluara nga lektorë vendas dhe të huaj me përvojë ndërkombëtare, duke garantuar një përvojë formuese cilësore dhe shumëdimensionale për pjesëmarrësit. Shembuj konkretë përfshijnë aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me CERN, siç janë: • <u>Data Science School on Scientific Software and Machine Learning</u> • <u>Hands-on School on Data Science and Machine Learning for Physics</u> Këto iniciativa kontribuojnë në zgjerimin e njohurive të pjesëmarrësve në një prej fushave më dinamike të zhvillimit shkencor bashkëkohor dhe përforcojnë lidhjet midis kërkimit akademik dhe zhvillimeve teknologjike të nivelit të lartë. Përmes organizimit të këtyre aktiviteteve, Departamenti i Fizikës synon të luajë një rol aktiv në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe mësimore, si dhe në fuqizimin e pozicionit të tij si një qendër e rëndësishme akademike dhe shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca: - <i>Vizita ne institucion</i> - https://ecses2024.mobirisesite.com/ - https://indico.cern.ch/event/1471004/ - https://indico.cern.ch/event/1308067/
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Departamenti i Fizikës, në kuadër të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë”, garanton një komponent të rëndësishëm praktik dhe eksperimental përmes strukturës së integruar të lëndëve që përmbajnë seanca laboratorike. Aktualisht, në kuadër të këtij programi, zhvillohen gjithsej

gjashtë (6) lëndë me përmbajtje laboratorike, prej të cilave katër (4) përfshijnë komponent laboratorik si pjesë përbërëse të orëve të mësimi dhe dy (2) janë lëndë tërësisht laboratorike, të dedikuara për përvojën praktike të studentëve. Të gjitha këto lëndë janë të strukturuar brenda grup-lëndëve të Fizikës së Materialeve dhe Fizikës Bio-Mjekësore, që përfaqësojnë fusha me interes të lartë kërkimor dhe me aplikim të drejtpërdrejtë në teknologji, industri dhe shërbime shëndetësore. Seancat laboratorike zhvillohen të paktën një herë gjatë secilit semestër, me përjashtim të semestrit të katërt që është i dedikuar punës së diplomës. Përqindja e këtyre seancave laboratorike përbën një raport të mirëpërcaktuar në strukturën e orëve të mësimi në auditor, përkatësisht në raportin 1/25 : 7/25 : 8/25, çka përkthehet në 21.3% të totalit të orëve të programit. Ky angazhim tregon qartë për rëndësinë që Departamenti i kushton zhvillimit të aftësive praktike dhe eksperimentale të studentëve, duke ndihmuar në formimin e një profili të aftë për të përballuar kërkesat e tregut të punës dhe për të kontribuar në kërkimin shkencor bashkëkohor. Veçanërisht e rëndësishme është përfshirja e një praktike profesionale të strukturuar në kuadër të lëndës *Fizika Mjekësore*, e cila parashikon një aktivizim njëjavor të studentëve pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë. Kjo përvojë i pajis studentët me njohuri të drejtpërdrejta mbi zbatimin e fizikës në mjekësi, duke ndërthurur aspektet teorike me praktikën klinike të matjes dhe kontrollit të parametrave fizikë në diagnostikim dhe terapi. Gjithashtu, puna e diplomës, e cila realizohet gjatë semestrit të katërt, përfaqëson kulmin e formimit akademik dhe profesional të studentit. Kjo përfshin një angazhim të drejtpërdrejtë kërkimor, që zhvillohet pranë një laboratorit kërkimor ose institucioni profesional, në Shqipëri ose jashtë vendit. Në shumë raste, studentët që realizojnë punën e diplomës pranë institucioneve bashkëpunuese, përfitojnë mundësi punësimi menjëherë pas përfundimit të studimeve, duke shndërruar këtë përvojë në një internship të strukturuar dhe të vlefshëm profesionalisht. Departamenti i Fizikës, si njësi përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, gëzon një rrjet të gjerë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë (IAL), institute kërkimore, qendra spitalore, operatorë ekonomikë dhe agjenci publike e private. Këto marrëveshje ofrojnë fleksibilitet dhe mundësi të gjera për studentët që të

	realizojnë projektet e tyre të diplomës në mjedise profesionale, duke ndërlidhur formimin akademik me kërkesat konkrete të tregut dhe zhvillimeve të fundit teknologjike dhe shkencore. Ky integrim i praktikës laboratorike dhe kërkimit në strukturën e programit Master i Shkencave në Fizikë dëshmon për një qasje bashkëkohore dhe të harmonizuar me standardet evropiane të arsimit të lartë, duke ofruar studentëve një formim të plotë, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt karrierës. Evidenca: - <i>Aneks Tabela 5 "Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë"</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Fizikës, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe të standardeve akademike bashkëkohore, zbatojnë në mënyrë periodike dhe sistematike procesin e analizës dhe vlerësimit të programeve të studimit, në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse të institucionit dhe në përputhje me udhëzimet ligjore dhe rekomandimet profesionale në fuqi. Ky proces përbën një komponent thelbësor të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes dhe strukturës së programeve akademike. Gjatë procesit të rishikimit dhe vlerësimit të programeve në nivel departamenti dhe fakulteti, mbledhen dhe analizohen të dhëna të rëndësishme nga palët e interesuara, përfshirë opinionet dhe vlerësimet e lektorëve, si dhe reagimet e studentëve të mbledhura përmes instrumenteve të posaçme të vlerësimit, kryesisht pyetësorëve të strukturësuar. Këto të dhëna përbëjnë bazën për identifikimin e nevojave për përmirësim dhe për përcaktimin e ndërhyrjeve konkrete në planin mësimor, si rishikimi i syllabuseve, përditësimi i përmbajtjes tematike të lëndëve, riorganizimi i strukturës së moduleve apo shtimi i komponentëve praktikë dhe kërkimorë. Përditësimi i programeve të studimit realizohet në përputhje të plotë me aktet nënligjore dhe kuadrin ligjor përkatës, ku veçanërisht mbështetja në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, pika 2.8, është një ndër referencat kryesore që orientojnë procesin e rishikimit periodik të përmbajtjes akademike.




	Struktura e syllabuseve të lëndëve është standardizuar dhe përfshin elementët kryesorë që garantojnë transparencë, objektiva të qarta të të nxënit dhe koherencë me programin e studimit. Çdo syllabus përfshin: • Pasqyrën informative të lëndës; • Rezultatet e pritura të të nxënit sipas niveleve të kompetencave; • Konceptet themelore dhe temat e detajuara të trajtuara në leksione dhe seminare; • Metodatat dhe format e vlerësimit (pjesëmarrja aktive, vlerësimi i vazhdueshëm, provimet përfundimtare); • Format e kontrollit të dijes; • Literatura bazë dhe ndihmëse, e përzgjedhur sipas tipologjisë së lëndës (me theks te tekstet klasike për lëndët teorike dhe burimet më të fundit për lëndët praktike); • Vërejtjet përfundimtare të pedagogut për strukturimin dhe ritmin e zhvillimit të kursit. Ky mekanizëm rishikimi garanton që programet e studimit të jenë në përputhje me zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë, duke reflektuar kërkesat e tregut të punës, zhvillimet ndërkombëtare në fushën e fizikës dhe nevojat e vazhdueshme për përmirësim të kompetencave akademike dhe profesionale. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit, ky proces ndikon pozitivisht edhe në zhvillimin e kërkimit shkencor brenda departamentit. Evidenca: - VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë": Pika 2.8 dhe Shtojca Nr.2 - Model Syllabus në programin Master i Shkencave - Aneks Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional	NA

<i>Qualifications Directive, 2005/36/EU).</i>				
Konkluzione	<i>Departamenti i Fizikës nxit dhe mbështet projektet kërkimore dhe ka bërë një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme kërkimore për bashkëpunim në punë kërkimore shkencore duke i dhënë përparësi ndërkombëtarizimit të universitetit. GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët janë inkurajuar të marrin pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga FSHN dhe UT në bashkëpunim me partnerë të tjerë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë” në Fakultetin e Shkencave Natyrore zbatohet përmes një game të larmishme formatesh të mësimdhënies që synojnë zhvillimin gjithëpërfshirës të njohurive teorike dhe aftësive praktike të studentëve. Këto forma përfshijnë: - Leksione teorike, të mbajtura nga staf akademik me përvojë dhe të angazhuar në kërkimin shkencor, që ofrojnë njohuritë themelore dhe të avancuara mbi temat përkatëse; - Seminare dhe ushtrime, që kontribuojnë në përvetësimin praktik të koncepteve të trajtuara në leksione, përmes diskutimeve, zgjidhjeve të ushtrimeve dhe rasteve studimore;


	• Punë laboratorike dhe praktika, të cilat sigurojnë aplikimin eksperimental të njohurive të fituara dhe përforcojnë aftësitë kërkimore dhe teknike të studentëve; • Detyra kursi dhe projekte, që synojnë të stimulojnë punën e pavarur të studentit, zhvillimin e mendimit kritik dhe zbatimin e metodave shkencore për trajtimin e problemeve specifike në fushën e fizikës. Në përputhje me sistemin evropian të transferimit dhe akumulimit të krediteve (ECTS), një kredit përfaqëson një ngarkesë prej 25 orësh pune totale, duke përfshirë jo vetëm orët në auditor (leksione, seminare dhe laboratorë), por edhe orët e punës së pavarur të studentit (studim individual, përgatitje detyrash, projekte, përgatitje për provime etj.). Gjatë zhvillimit të programit dyvjeçar, ngarkesa mesatare javore në auditor është rreth 25 orë, e shpërndarë në mënyrë të balancuar mes komponentëve teorikë dhe praktikë të programit. Në përfundim të ciklit, studenti duhet të ketë përmbushur 120 kredite ECTS, nga të cilat 30 kredite i përkasin punimit të diplomës/masterit, si kërkesë për përfundimin e programit dhe fitimin e diplomës përkatëse. Për të lehtësuar procesin e të mësuarit dhe për të përmbushur nevojat e fleksibilitetit akademik, Fakulteti i Shkencave Natyrore ofron gjithashtu mundësinë e zhvillimit të mësimit në formë online, në përputhje me rregulloret në fuqi dhe në raste të veçanta si: angazhimi i stafit ndërkombëtar, situata të papritura shëndetësore ose për të mundësuar komunikimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit, materialeve dhe detyrave midis studentëve dhe stafit akademik. Ky model i integruar i mësimdhënies siguron një përgatitje të plotë akademike dhe praktike për studentët, në përputhje me standardet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe në hapësirën evropiane të arsimit. Evidenca: - Statuti i UT, neni 92 - Rregullore e UT, neni 31 fq 21, neni 33 dhe neni 40 - Rregullore e programit të studimit MSc Fizikë neni 18. - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit - Udhëzues i UT për mësimin në distance - Tabela 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe	Personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në "Fizikë" pranë Departamentit të Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës, ushtron aktivitetin mësimor dhe

nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	pedagogjik në përputhje të plotë me standardet akademike, duke respektuar parimet e përfshirjes, barazisë dhe përshtatjes ndaj nevojave të ndryshme të studentëve. Në këtë kuadër, stafi: • U përgjigjet në mënyrë të qëndrueshme dhe profesionale kërkesave të ndryshme të studentëve, duke ofruar forma dhe metoda alternative të mësimdhënies dhe të të nxënit, • Zbaton një qasje të individualizuar, e cila merr në konsideratë larmishmërinë e aftësive, sfidave dhe prirjeve të studentëve, në funksion të përmirësimit të cilësisë së procesit të të nxënit. Liria Akademike dhe Përdorimi i Metodave Bashkëkohore të Mësimdhënies Pedagogët e programit gëzojnë “liri akademike” në përzgjedhjen dhe zbatimin e metodologjive të mësimdhënies, duke respektuar në mënyrë të detajuar kornizën e planit mësimor të miratuar. Në këtë kuadër: • Aplikohen metoda bashkëkohore dhe strategji të ndryshme të të nxënit aktiv (active learning), të cilat rishikohen dhe përmirësohen periodikisht për të rritur efektivitetin didaktik, • Studentët inkurajohen të zhvillojnë mendimin kritik dhe të angazhohen në mënyrë të pavarur në procesin akademik, • Promovohet një qasje fleksibël dhe e orientuar drejt studentit, në përputhje me objektivat e të nxënit dhe kompetencat e kërkuara. Në varësi të natyrës së lëndës dhe profileve të studentëve, personeli akademik aplikon forma të ndryshme të zhvillimit të mësimin, si: • Mësimi në auditorë dhe laboratorë – si formë klasike dhe e domosdoshme për integrimin e njohurive teorike dhe eksperimentale, • Mësimi në distancë – i mundësuar në raste të veçanta (situata emergjente, bashkëpunime ndërkombëtare, etj.); • Përdorimi i platformave digjitale (si <i>Microsoft Teams</i>, <i>Google Classroom</i>, etj.), të cilat shërbejnë si mjete efikase për: shpërndarjen e materialeve, zhvillimin e diskutimeve interaktive, dorëzimin e detyrave, projektit apo laboratorëve, si dhe për komunikim të vazhdueshëm midis pedagogëve dhe studentëve. Personeli akademik është i angazhuar në garantimin e një ambienti mësimor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, në të cilin:
--	--




	• Nuk bëhen dallime në trajtimin e studentëve për arsye sociale, personale, etnike apo të tjera, • Sigurohet mbështetje e veçantë për studentët që hasin vështirësi akademike ose kanë nevoja të veçanta përfshirjeje, • Nuk tolerohen asnjë formë diskriminimi apo trajtimi preferencial, në përputhje me rregulloret institucionale dhe etiket akademike. Departamenti i Fizikës përfiton në mënyrë të vazhdueshme nga bashkëpunimet me institucione të njohura akademike dhe kërkimore ndërkombëtare. Në këtë kontekst, gjatë zhvillimit të programit: • Organizohen leksione dhe seminare të veçanta nga lektorë të huaj të ftuar, në kuadër të marrëveshjeve ndëruniversitare dhe bashkëpunimeve me institute kërkimore, • Këto leksione, të cilat mbulojnë tema të avancuara dhe aktuale të fizikës moderne, shërbejnë si burim vlerash shtesë si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët, duke kontribuar në ndërkombëtarizimin e programit të studimit, • Në kuadër të konferencave, workshop-eve dhe shkollave verore të organizuara nga Departamenti në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe Akademinë e Shkencave, kanë referuar shkencëtarë dhe fizikantë. Evidenca: <i>Kodi i etikës</i> <i>Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë.</i> <i>Tabela 5 (Bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fizikës dhe Fakultetit)</i> <i>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës, përmes strukturave të tij akademike dhe administrative, garanton mbështetje të vazhdueshme dhe të strukturuar për personelin akademik, me qëllim rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe zhvillimin profesional të stafit. Kjo mbështetje realizohet përmes një sërë mekanizmash të përcaktuar në politikat institucionale për sigurimin e cilësisë, përfshirë: 1. Zbatimi i politikave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie

	• Institucioni zbaton një sistem të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi të rregullt të cilësisë së mësimdhënies, i cili shërben si bazë për ndërhyrje të qëndrueshme dhe përmirësime të vazhdueshme në procesin didaktik. • Këto mekanizma vlerësimi përfshijnë: analizën e feedback-ut nga studentët përmes pyetësorëve institucionalë, vlerësimin e performancës pedagogjike, si dhe raportimin periodik nga njësitë bazë të fakultetit. 2. Nxitja dhe integrimi i metodave bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies • Personeli akademik inkurajohet të përdorë metoda aktive dhe inovative të mësimdhënies, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe angazhimin e studentëve. • Praktikat më të mira përfshijnë përdorimin e mjeteve digjitale, mësimin e integruar me kërkimin shkencor, projektet ndërdisiplinore dhe punën në grup. 3. Mbështetja për zhvillimin profesional të vazhdueshëm të stafit akademik Institucioni ofron një gamë të gjerë aktiviteteve për zhvillimin profesional të stafit, të cilat përfshijnë: • Organizimin e trajnimeve të rregullta për përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies, përdorimin e platformave digjitale dhe integrimin e teknologjisë në procesin didaktik; • Pjesëmarrjen në workshope, konferenca dhe aktivitete akademike, brenda dhe jashtë institucionit, që synojnë shkëmbimin e përvojave dhe përvetësimin e praktikave ndërkombëtare; • Procesin e vetëvlerësimit të stafit akademik, i cili është një komponent i rëndësishëm për identifikimin e nevojave për përmirësim individual dhe institucional në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. 4. Furnizimi me infrastrukturë dhe mbështetje teknike për mësimdhënie cilësore • Çdo departament, në fillim të vitit kalendarik, përgatit dhe dorëzon projektbuxhetin vjetor që përfshin kërkesat për përmirësimin dhe zgjerimin e bazës materiale që mbështet procesin mësimor, përfshirë:
--	--



	- o Pajisje laboratorike të domosdoshme për realizimin e eksperimenteve dhe praktikave mësimore - o Infrastrukturë kompjuterike dhe IT (kompjuterat, komponentë përkatës, pajisje periferike); - o Pajisje audiovizive si projektorë dhe mjete të tjera që mundësojnë mësimdhënie efektive në mjediset fizike dhe virtuale. 5. Përfshirja në programet ndërkombëtare të mobilitetit dhe shkëmbimit të stafit akademik • Personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet ndërkombëtare të shkëmbimit të stafit (si p.sh. Erasmus+ KA1), nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe që Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore kanë me universitete partnere në vendet e BE-së dhe më gjerë. • Këto programe ndihmojnë në rritjen e ndërkombëtarizimit të stafit akademik, në përvetësimin e përvojave ndërkombëtare të mësimdhënies dhe në forcimin e bashkëpunimeve kërkimore ndërinstitucionale. Ky angazhim i vazhdueshëm institucional për krijimin e një mjedisi të mbështetur dhe motivues për personelin akademik kontribuon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përgatitjen e studentëve në përputhje me standardet bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve akademike të vetë institucionit. Evidenca: - Raport mësimor shkencor i Departamentit të Fizikës 2022-2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2021-2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2022-2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2023-2024 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT - Manuali i Cilësisë i UT - Buxhetet e Departamentit të Fizikës për vitin 2021, 2022, 2023. - Vizita ne Institucion
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në	GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë", pranë Departamentit të Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore në Universitetin e Tiranës,

shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	ushtron funksionet e tij në përputhje me standardet më të larta të mësimdhënies dhe etikës akademike. Ky staf përbëhet nga pedagogë të kualifikuar, me përvojë të konsiderueshme kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilët kontribuojnë në zhvillimin profesional dhe akademik të studentëve përmes një qasjeje bashkëkohore, interaktive dhe të personalizuar të mësimdhënies. 1. Kompetenca profesionale dhe metodologjia e mësimdhënies • Personeli akademik zhvillon procesin mësimor me kompetencë të lartë akademike, duke shfrytëzuar teknika moderne të transmetimit të njohurive dhe duke nxitur përfshirjen aktive të studentëve në mjedisin e të nxënit. • Mësimdhënia mbështetet në praktika të mira akademike, që përfshijnë përdorimin e metodave interaktive si: diskutime të strukturuar në klasë, punë në grupe, zhvillim projektsh praktike, analizë kritikë të literaturës shkencore, organizim debatesh mbi çështje specifike të fizikës bashkëkohore, etj. • Përdoret një qasje konstruktive dhe dialoguese, duke nxitur zhvillimin e mendimit kritik, analitik dhe krijues tek studentët. 2. Kombinimi i eksperiencës vendase me përvojën ndërkombëtare • Pedagogët e programit, përveç trashëgimisë akademike të Fakultetit të Shkencave Natyrore, sjellin eksperiencën didaktike të përfituara nga universitetet dhe institutet kërkimore ndërkombëtare, ku ata kanë kryer vizita studimore, trajnime apo angazhime akademike. • Ky kontekst ndërkombëtar i përvojës pedagogjike reflektohet në përmbajtjen moderne të leksioneve, në metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies dhe në hapjen e perspektivave të reja për studentët. 3. Materialet didaktike dhe dokumentimi i procesit mësimor • Pjesa më e madhe e lëndëve të programit shoqërohet me tekste bazë dhe ndihmëse, materiale mësimore digjitale, si dhe leksione të përgatitura dhe përditësuara nga vetë pedagogët, të cilat arkivohen dhe ruhen në Departamentin e Fizikës për përdorim të vazhdueshëm. • Metodat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit të dijes janë të detajuara në Syllabuset zyrtare të lëndëve, të hartuar në përputhje me objektivat e të nxënit, kompetencat që synohen të fitohen dhe standardet e kurrikulës së miratuar.
--	---





	4. Përbërja dhe kualifikimet e stafit akademik Stafi akademik titullar i përfshirë në realizimin e programit Master i Shkencave në “Fizikë” përbëhet nga ekspertë të profilit të lartë akademik dhe shkencor. Ky përbërje siguron një mbulim të plotë të fushave tematike të programit, njëkohësisht duke garantuar cilësinë dhe thellësinë shkencore të përmbajtjes së lëndëve. 5. Bashkëpunimi ndërinstitucional në lëndët e profilit të Fizikës Mjekësore - Në zhvillimin e lëndëve të Fizikës Mjekësore, një komponent i rëndësishëm i programit, angazhohet edhe stafi akademik dhe profesional i Spitalit Universitar “Nënë Tereza”, duke kontribuar ndjeshëm në konkretizimin e përmbajtjes dhe në rritjen e vlerës së mësimdhënies për këtë fushë të aplikueshme të fizikës. - Ky bashkëpunim ndërinstitucional e ka bërë programin më funksional dhe të orientuar drejt praktikës klinike, duke udhënë studentëve mundësi të prekshme për të përfituar nga njohuritë e përfshira në aktivitetet spitalore dhe kërkimore. Ky model i integruar i mësimdhënies dhe struktura akademike e stafit garantojnë një proces studimi të orientuar drejt cilësisë, ndërveprimit shkencor dhe përgatitjes së studentëve për sfida profesionale dhe kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca: - Kodi i etikës i UT - Paketa e Instrumenteve të Cilësisë - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT - Manualët e Sigurimit të Cilësisë. - Tabelat 6.1, 6.2, 6.3 “Stafi akademik për programin e studimit MSc Fizikë” - Syllabusët e lëndëve të programit të studimit
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar	Në kuadër të politikave institucionale për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, Departamenti i Fizikës, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Universitetit të Tiranës, zbaton një mekanizëm të mirëstrukturuar dhe të vazhdueshëm për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies në programin e studimeve Master i Shkencave në “Fizikë”. Ky proces bazohet në parimet e transparencës, përfshirjes së studentëve dhe zhvillimit të vazhdueshëm akademik, dhe realizohet përmes mjeteve dhe procedurave të mëposhtme:

mendimet e sugjerimet e tyre.	• Në përfundim të çdo semestri, studentët e programit ftohen të plotësojnë pyetësorë vlerësues institucionalë, të hartuar sipas udhëzimeve të Universitetit të Tiranës dhe bazuar në praktikën e mira europiane për sigurimin e cilësisë. • Këto pyetësorë synojnë të evidentojnë pikat e forta dhe dobësitë në mësimdhënie, organizimin e lëndëve, përmbajtjen mësimore, qasjen pedagogjike të stafit akademik dhe ndikimin e përgjithshëm të procesit të të nxënies. • Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë sistematike nga strukturat përkatëse të fakultetit dhe departamentit, për të nxjerrë indikatorë të cilësisë së procesit mësimor. • Rezultatet e analizave përdoren për të identifikuar problematikat specifike, për të reflektuar mbi sukseset, si dhe për të formuluar propozime konkrete për përmirësim të programit akademik dhe metodologjisë së mësimdhënies. • Studentët janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e përmirësimit akademik, përmes vlerësimeve të tyre individuale dhe përfaqësimeve në organet kolegjiale të fakultetit dhe universitetit. • Në bazë të të dhënave të mbledhura, konstatohet se më shumë se 80% e studentëve shprehin vlerësime pozitive (“të kënaqur” ose “shumë të kënaqur”) për elementë të tillë si: cilësia e mësimdhënies, kompetencat e pedagogëve, struktura e lëndëve dhe organizimi i përgjithshëm i programit të studimit. Ky mekanizëm i integruar për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë mësimore jo vetëm që garanton një përputhje të vazhdueshme me nevojat e studentëve dhe standardet e tregut të punës, por gjithashtu ndihmon në rritjen e cilësisë institucionale dhe përmbushjen e objektivave strategjike të arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe europian. Evidenca: - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2021-2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2022-2023
--------------------------------------	--

	- Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2023-2024 - Manuali i Cilësisë UT - Paketa e instrumentave të cilësisë
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në përputhje me kornizën ligjore dhe strategjinë institucionale për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, Universiteti i Tiranës (UT) ka ngritur dhe funksionalizuar një sërë strukturash përgjegjëse, të cilat mbikëqyrin, koordinojnë dhe nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në të gjitha njësitë përbërëse të tij, përfshirë Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Departamentin e Fizikës. 1. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) - Kjo njësi funksionon si strukturë përgjegjëse në nivel fakulteti dhe ka për detyrë monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe të performancës akademike në tërësi. - DSBCK në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN) bashkëpunon ngushtë me departamentet për zbatimin e praktikave të standardizuara të vlerësimit dhe për hartimin e rekomandimeve për përmirësim të vazhdueshëm të përmbajtjes, metodave dhe rezultateve të mësimdhënies. 2. Këshilli i Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Tiranës - Ky këshill përfaqëson organin koordinues në nivel universiteti, i cili bashkërendon politikat e sigurimit të cilësisë me njësitë akademike. - Këshilli ka rol strategjik në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, përmes përcaktimit të prioritetëve, analizës së të dhënave vlerësuese dhe harmonizimit të standardeve të cilësisë me praktikën ndërkombëtare të arsimit të lartë. 3. Zhvillimi i metodave të mësimdhënies dhe trajnimi i stafit akademik - Strukturat përgjegjëse ofrojnë mbështetje konkrete për përmirësimin dhe modernizimin e metodologjive të mësimdhënies, duke nxitur integrimin e teknikave bashkëkohore dhe teknologjive digjitale në procesin didaktik. - Në këtë kontekst, organizohen në mënyrë periodike trajnime, workshop-e dhe sesione formimi për stafin

	akademik, me fokus në teknikat më të reja të mësimdhënies, vlerësimit dhe ndërtimit të mjediseve interaktive të të nxënit. - Trajnimet synojnë rritjen e kapaciteteve pedagogjike të stafit akademik, përfshirë përdorimin e platformave online, menaxhimin e klasave hibride, dhe përfshirjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor. 4. Ndërkombëtarizimi dhe përvetësimi i praktikave inovative - Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës janë të angazhuar në marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institute kërkimore ndërkombëtare, të cilat përfshijnë shkëmbime akademike, projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillim të kapaciteteve institucionale. - Në këtë kuadër, personeli akademik i programit Master i Shkencave në "Fizikë" inkurajohet dhe mbështetet për të marrë pjesë në programe mobiliteti dhe projekte ndërkombëtare, me synimin për të përvetësuar praktika inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe për të rritur nivelin e ndërkombëtarizimit të programit të studimit. - Përfshirja në këto iniciativa ndihmon në transfertën e njohurive, përmirësimin e përmbajtjes mësimore, si dhe në rritjen e cilësisë së përgjithshme të procesit akademik. Këto struktura dhe mekanizma kontribuojnë në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Tiranës, duke synuar arritjen e standardeve evropiane të arsimit të lartë dhe mbështetjen e zhvillimit profesional të stafit akademik në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të përvojës studentore. Evidenca: <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2021-2022</i> <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2022-2023</i> <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 2023-2024</i> <i>Paketa e instrumentave të cilësisë</i> <i>Vendim Anëtarët e grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) 2025 FSHN</i>
--	---



	<i>- Tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese.</i>			
Konkluzione	<i>Univeristeti i Tiranës kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Departamenti i Fizikës nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në kuadër të zbatimit të standardeve akademike dhe rregulloreve të Universitetit të Tiranës, procesi i vlerësimit të studentëve në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë”, i zhvilluar pranë Departamentit të Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, organizohet në përputhje me dispozitat e Rregullores së Studimeve dhe udhëzimeve të brendshme të programit përkatës të studimit. Vlerësimi i studentëve në secilën lëndë bazohet në tre shtylla kryesore: a) Pjesëmarrja aktive në veprimtaritë mësimore, përfshirë ndjekjen e rregullt të leksioneve, seminareve, ushtrimeve dhe laboratorëve; b) Vlerësimi i vazhduar, i cili përfshin performancën e studentit gjatë zhvillimit të seminareve, praktikave laboratorike, zgjidhjes së detyrave të kursit dhe realizimit të projekteve individuale ose në grup; c) Vlerësimi përfundimtar, i cili rezulton nga kombinimi i pikëve të mbledhura gjatë vlerësimit të vazhduar dhe notës së marrë në provimin final, në përputhje me raportet e përcaktuara në syllabus-in e çdo lënde. Procesi i vlerësimit zbatohet mbi bazën e një sistemi notash të standardizuara, që përfshin: o Nota numerike nga 4 deri në 10, ku nota 5 është nota minimale kaluese;

	○ Sistem alternativ me pikë ose përqindje, ku 40 pikë (40%) përfaqësojnë pragu minimal të kalueshmërisë. Vlerësimi përfundimtar është i detyrueshëm dhe duhet të shprehet gjithmonë me notë, e cila pasqyrohet në regjistrat zyrtarë dhe në sistemin informatik të fakultetit. Studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në provimin përfundimtar vetëm pasi të kenë shlyer të gjitha detyrimet mësimore të lëndës përkatëse, në përputhje me përcaktimet e syllabus-it: ○ 100% realizim i laboratorëve; ○ Të paktën 75% pjesëmarrje në seminare/ushtime; ○ Dorëzim i plotë i detyrave të kursit dhe projekteve (100%). Provimet zhvillohen sipas kalendarit akademik të miratuar nga Dekanati dhe Departamenti i Fizikës, dhe çdo ndryshim në oraret ose format e provimeve duhet të njoftohet të paktën një muaj para fillimit të sezonit të provimeve. Tezat e provimeve hartohen nga përgjegjësi i lëndës sipas një strukture të unifikuar, dhe rezultatet: ○ Hidhen në sistemin informatik të fakultetit (online); ○ Protokolohen nëpërmjet procesverbaleve zyrtare, të cilat dorëzohen të printuara në sekretarinë mësimore të FSHN. Studentët informohen në mënyrë të rregullt mbi kriteret e vlerësimit dhe modalitetet e testimit që në fillim të lëndës përmes prezantimit të syllabus-it dhe udhëzimeve të pedagogut përgjegjës. Për më tepër, informacione të detajuara mbi sezonet e provimeve, datat, regjistrimet, notat përfundimtare dhe çdo zhvillim tjetër i rëndësishëm publikohen në sistemin informatik të FSHN, ku studentët kanë akses të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm. Ky sistem transparent, i strukturuar dhe i mbështetur në standarde akademike garanton integritetin e procesit të vlerësimit, nxit përgatitjen serioze të studentëve dhe kontribuon në arritjen e objektivave të të nxëniet në përputhje me kuadrin kombëtar dhe europian të kualifikimeve. Evidenca: - Statuti i UT, nenet 8,14 - Rregullore e UT, Neni 5
--	--

	- Rregullore e programit te studimit "Master i Shkencave ne Fizikë", neni 22 - Supplement diplome pdf - Rregullore për funksionimin e sistemit informatic - Model teze provimi master - Proces-verbal provimi master - Manual përdorimi e-student - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSH në Fizikë
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në përputhje me standardet e transparencës akademike dhe objektivat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, Departamenti i Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, garanton informimin në kohë dhe të plotë të studentëve për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në secilën njësi mësimore të programit Master i Shkencave në "Fizikë". • Që në sesionin e parë të çdo lënde, personeli akademik prezanton për studentët metodologjinë e mësimdhënies dhe vlerësimit, duke sqaruar në mënyrë të qartë format, kriteret dhe komponentët që do të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të performancës akademike. • Studentët udhëzohen mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e vlerësimit dhe njoftohen për format e ankimimit në përputhje me rregulloret e Universitetit të Tiranës. • Për secilën lëndë, syllabusi përgatitet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit të Fizikës, si një dokument zyrtar që orienton procesin mësimor dhe vlerësues. • Syllabusi publikohet dhe u vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit, duke shërbyer si një mjet i rëndësishëm për informimin, planifikimin dhe ndjekjen e progresit akademik. Çdo syllabus përmban në mënyrë të strukturuar informacionin e detajuar mbi: • Format e kontrollit të dijeve, të cilat mund të përfshijnë provime me shkrim, me gojë, teste ndërmjetëse, detyra kursi, projekte, prezantime dhe vlerësime laboratorike • Rregullat e frekuentimit dhe kriteret për përfshirjen në vlerësimin e vazhdueshëm, duke përcaktuar normën

	minimale të pjesëmarrjes së kërkuar për aktivitete praktike dhe seminare • Metodologjia e testimit dhe teknikat e vlerësimit, të përzgjedhura në funksion të natyrës së lëndës dhe objektivave të të nxënit • Pesha specifike e çdo komponenti në kuadër të vlerësimit përfundimtar (p.sh. përqindja e provimit përfundimtar, detyrave të kursit, projektit apo pjesëmarrjes aktive) • Kriteret e kalueshmërisë, që përfshijnë notën minimale, pragjet e pikëve ose përqindjen e kërkuar për të konsideruar vlerësimin si të suksesshëm • Procedurat e ankimimit, në përputhje me rregulloret e UT, për të garantuar të drejtën e studentit për të kërkuar rishqyrtim të vlerësimit, nëse ka baza për këtë. • Kjo praktikë e konsoliduar e informimit dhe dokumentimit kontribuon ndjeshëm në rritjen e transparencës institucionale, ndihmon studentët të kuptojnë qartë pritshmëritë akademike, si dhe u mundëson atyre të planifikojnë më mirë procesin e të nxënit dhe angazhimin individual. • Në të njëjtën kohë, kjo qasje përforcon besimin reciprok mes stafit akademik dhe studentëve, si dhe ndihmon në ndërtimin e një kulture akademike të bazuar në përgjegjësi, llogaridhënie dhe objektivitet në vlerësim. Zbatimi i këtyre standardeve përbën një aspekt thelbësor të politikave të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Tiranës dhe ndihmon në përmbushjen e objektivave të programit të studimit në përputhje me kuadrin kombëtar të kualifikimeve dhe praktikat më të mira të hapësirës europiane të arsimit të lartë. Evidenca: - Statuti i UT, neni 8 - Rregullore e përditësuar UT 2016 - Rregullore e programit MSc Fizikë, nenet 22, 25 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë	Departamenti i Fizikës, në përputhje me standardet e Universitetit të Tiranës dhe praktikat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, zbaton një sistem të larmishëm dhe fleksibël të testimit dhe vlerësimit të studentëve në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë”. Ky sistem është i ndërtuar mbi parimet e transparencës, objektivitetit dhe

mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	përmirësimit të vazhdueshëm, duke synuar vlerësimin gjithëpërfshirës të njohurive teorike, aftësive praktike dhe kompetencave kërkimore të studentëve. • Për secilën njësi mësimore, komponentët e vlerësimit dhe peshat përkatëse në notën përfundimtare përcaktohen qartë në syllabusin e lëndës, i cili aprovohet nga strukturat përkatëse të Departamentit dhe u vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit. • Studentët informohen gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë nga personeli akademik përgjegjës për lëndën, si dhe u ofrohet mundësia për të dhënë sugjerime dhe komente konstruktive mbi mënyrën e organizimit të vlerësimit. Departamenti zbaton një qasje të kombinuar të vlerësimit, ku përfshihen forma të ndryshme në varësi të natyrës së lëndës dhe kompetencave që synohen: • Provime me shkrim dhe me gojë – përdoren për të vlerësuar nivelin e përvetësimit të njohurive teorike, të koncepteve themelore dhe aftësinë për të argumentuar logjikisht. • Detyra kursi dhe projekte individuale/grupore – synojnë vlerësimin e aftësive analitike, të zbatimit të njohurive në kontekste të reja, si dhe të kapaciteteve kërkimore dhe zgjidhjes së problemeve. • Prezantime dhe diskutime në klasë – përdoren për të vlerësuar aftësitë e komunikimit akademik, saktësinë e përmbajtjes shkencore dhe argumentimin kritik. • Aktivitete laboratorike dhe praktika eksperimentale – fokusohen në vlerësimin e aftësive profesionale, zbatimin e protokolleve laboratorike dhe përpunimin e të dhënave. • Vlerësimi i vazhduar – përfshin testime periodike, ushtrime të mbikëqyrura dhe feedback gjatë semestrit, me synim monitorimin progresiv të performancës akademike dhe nxitjen e angazhimit të qëndrueshëm të studentëve. • Mbrojtja e tezës së masterit – përfaqëson fazën përfundimtare të programit ku studentët demonstrojnë pavarësi akademike, kompetenca kërkimore të avancuara dhe aftësi për të strukturuar dhe komunikuar rezultatet shkencore përmes një prezantimi publik dhe mbrojtjeje para komisionit të vlerësimit.
--	--




	Në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në arsimin universitar dhe në funksion të digjitalizimit të proceseve akademike, Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës mbështesin përdorimin e metodave inovative në vlerësim, përfshirë: • Testimet online dhe përdorimi i platformave digjitale (si Microsoft Teams, Moodle, Google Classroom, etj.) për menaxhimin dhe zhvillimin e provimeve, dorëzimin e detyrave dhe sigurimin e interaktivitetit në vlerësim. • Projekte ndërdisiplinore, të cilat nxisin bashkëpunimin mes studentëve nga fusha të ndryshme të shkencave natyrore dhe inkurajojnë zbatimin e njohurive në kontekste reale dhe të ndërthurura ndërdisiplinarisht. Përdorimi i këtyre formateve të ndryshme dhe të përshtatura të vlerësimit garanton një qasje gjithëpërfshirëse, transparente dhe efektive në matjen e përparimit akademik të studentëve dhe përgatitjen e tyre për sfida të avancuara kërkimore dhe profesionale në fushën e fizikës. Evidenca: - Statuti i UT - Rregullore e UT - Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë, neni 25) - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit - Udhëzues i UT për sistemin e mësimin në distancë			
Konkluzione	Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar zbatimin e tyre si dhe aftësimin e studentëve në përputhje me objektivat e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit Ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë” dhe konstaton se procesi i vlerësimit të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Fizikë” pranë Departamentit të Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, i cili garanton një matje të gjithanshme dhe progresive të njohurive, aftësive praktike dhe kompetencave të fituara nga studentët gjatë procesit mësimor. Nota përfundimtare në çdo njësi mësimore përbëhet nga kombinimi i disa komponentëve, të cilët janë të përcaktuar në mënyrë të qartë në syllabus-in e lëndës përkatëse dhe variojnë në varësi të specifikës së lëndës. Përgjithësisht, struktura vlerësuese përfshin: • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në auditor dhe aktivitete praktike: 0–10% • Përbushja e detyrimeve akademike (detyra kursi, projekte, laboratorë): 10–20% • Provimi përfundimtar (me shkrim dhe/ose me gojë): 50–80% Në tërësi, të gjithë komponentët përbëjnë 100% të vlerësimit përfundimtar, duke mundësuar një analizë të balancuar të performancës së studentit si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Për ato njësi mësimore që, për nga natyra e tyre, kërkojnë një vlerësim të vazhduar dhe të integruar në procesin mësimor (si p.sh. laboratorë, seminare, projektet praktike, punë kërkimore, etj.), vlerësimi realizohet 100% gjatë semestrit, pa zhvillim të një provimi përfundimtar të ndarë. • Vlerësimi i vazhduar zbatohet në mënyrë të strukturuar gjatë gjithë vitit akademik dhe përfshin testime të ndërmjetme, detyra të rregullta, ushtrime të mbikëqyrura dhe aktivitete të tjera të përcaktuara në syllabus. • Rezultatet e këtyre vlerësimeve integrohen në notën përfundimtare, duke pasqyruar progresin individual të studentit dhe përmirësimin e tij gjatë gjithë periudhës mësimore. • Të gjitha rezultatet e vlerësimeve, përfshirë ato të testimeve gjatë semestrit dhe të provimit përfundimtar, bëhen të

	aksesueshme për studentët në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme, përmes sistemit informatik të FSHN ose nëpërmjet njoftimit të drejtpërdrejtë nga pedagogu. • Studentët kanë të drejtën të apelojnë vlerësimin në rastet kur ekzistojnë paqartësi mbi kriteret, metodologjinë ose objektivitetin e procesit të testimit, në përputhje me procedurat e ankimimit të përcaktuara në rregulloret e Universitetit të Tiranës. Zbatimi i kësaj qasje të strukturuar ndaj vlerësimit siguron barazi, transparencë dhe gjithëpërfshirje në procesin akademik, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë për të gjithë aktorët e përfshirë në programin e studimit. Evidenca: <i>Statuti i UT</i> <i>Rregullore e UT</i> <i>Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë, neni 22, 25</i> <i>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Departamenti i Fizikës, si njësi bazë akademike pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, disponon infrastrukturën teknologjike dhe kapacitetet institucionale të nevojshme për të mbështetur zbatimin e formave bashkëkohore të testimit dhe vlerësimit elektronik, në përputhje me standardet moderne të arsimit të lartë. Departamenti është i pajisur me mjedise të dedikuara dhe teknologji të avancuar që mundësojnë zhvillimin e testimeve digjitale dhe vlerësimeve të automatizuara në kushte optimale: • Salla e informatikës, e pajisur me kompjutera të përditësuar, akses të vazhdueshëm në rrjet dhe mundësi konfigurimi për zhvillimin e provimeve online ose të mbikëqyrura elektronikisht • Laboratori i modelimeve dhe simulimeve, i cili përmban kapacitete të avancuara llogaritëse (cluster computing) dhe përdoret për aplikime që kërkojnë përpunim intensiv të të dhënave, analiza numerike, dhe mbështetje të testimeve që përfshijnë simulime shkencore dhe teknike. Këto struktura teknologjike shërbejnë jo vetëm për vlerësim, por edhe për zhvillim profesional të studentëve në drejtim të përdorimit të mjeteve të avancuara të informatikës shkencore.




	• Tezat dhe instrumentet e vlerësimit hartohen nga pedagogët përkatës dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit, duke garantuar integritetin akademik, kontrollin cilësor dhe përputhjen me objektivat e të nxëniet të përcaktuara në syllabus. • Ky proces siguron transparencë dhe unifikim të kriterëve të vlerësimit, dhe njëkohësisht ndihmon në shmangien e çdo forme subjektivizmi ose abuzimi. Departamenti aplikon një qasje të shumëfishtë të vlerësimit, duke kombinuar forma të ndryshme testimi me qëllim të garantimit të objektivitetit dhe gjithëpërfshirjes së kompetencave të studentëve. Zbatimi i këtyre formave ndihmon në minimizimin e mundësive për abuzim dhe nxit një qasje të ndershme dhe profesionale ndaj vlerësimit. Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 dhe në vazhdimësi, Departamenti i Fizikës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës kanë demonstruar aftësi të larta adaptimi ndaj mësimdhënies dhe vlerësimit në kushte të veçanta, duke përdorur platforma të sigurta dhe të verifikuara për komunikim dhe vlerësim në distancë, të tilla si: • Google Classroom, Google Meet dhe Zoom, të përdorura për organizimin e provimeve dhe prezantimeve online, mbledhjen e detyrave dhe komunikimin pedagog–student • Portali studentor i Universitetit të Tiranës, për menaxhimin e regjistrimeve, publikimin e notave, shpërndarjen e materialeve dhe aksesin në informacion akademik në kohë reale. Kjo infrastrukturë dhe organizimi institucional e vendos Departamentin e Fizikës në pozita të favorshme për të garantuar një proces vlerësimi të besueshëm, të monitorueshëm dhe të përputhshëm me standardet evropiane, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së arsimit dhe përgatitjes akademike të studentëve në nivel të avancuar. Evidenca: - Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë neni 4, 26 - Rregullore e posaçme e UT mbi zhvillimet e provimeve online
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me	GVJ vlerëson se procesi i vlerësimit përfundimtar në kuadër të programit Master i Shkencave në “Fizikë”, i zhvilluar pranë Departamentit të Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, zbatohet në përputhje të plotë me përmbajtjen e syllabus-it të çdo

syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	lënde, si dhe me rregulloret akademike të Universitetit të Tiranës dhe legjislacionin kombëtar në fuqi për arsimin e lartë. • Vlerësimi përfundimtar përfaqëson komponentin kryesor në strukturën e përgjithshme të vlerësimit të një lënde, duke përbërë zakonisht pjesën më të madhe në përqindje, siç është përcaktuar qartësisht në syllabus. • Ky vlerësim pasqyron jo vetëm përvetësimin teorik të njohurive nga ana e studentit, por gjithashtu aftësinë për t'i aplikuar ato në mënyrë analitike dhe kritike. • Titullari i lëndës mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatimin korrekt të metodologjisë së vlerësimit, në përputhje me përshkrimin e bërë në syllabus-in përkatës. • Çdo devijim nga forma e miratuar e vlerësimit duhet të justifikohet dhe miratohet nëpërmjet strukturave përkatëse të departamentit apo fakultetit. • Studentët gëzojnë të drejtën legjitime për të ankimuar rezultatet e vlerësimit, në rastet kur konstatojnë se mënyra e vlerësimit nuk është në përputhje me kriteret e syllabus-it apo me rregulloret akademike në fuqi. • Ankimet trajtohen sipas një procedure zyrtare dhe të dokumentuar, që garanton shqyrtim objektiv dhe të drejtë të çdo rasti nga strukturat përkatëse. • Provimet dhe rezultatet e vlerësimit regjistrohen dhe dokumentohen zyrtarisht, si në format të printuar (procesverbale të firmosura) ashtu edhe në sistemin informatik të Universitetit, duke garantuar transparencë, gjurmueshmëri dhe llogaridhënie në çdo hallkë të procesit akademik. • Kjo praktikë është në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton standardet minimale dhe të detyrueshme për mënyrën e vlerësimit të studentëve, përfshirë të drejtën për ankim dhe kërkesën për dokumentim të procesit. Kjo qasje siguron një sistem vlerësimi transparent, të standardizuar dhe të drejtë, në funksion të garantimit të cilësisë akademike, mbrojtjes së të drejtave të studentëve dhe rritjes së besueshmërisë institucionale.
--	---



	Evidenca: - Ligji Nr 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në kuadër të zbatimit të standardeve të transparencës akademike dhe garantimit të së drejtës së informimit për studentët, Departamenti i Fizikës, në kuadër të programit Master i Shkencave në "Fizikë", zbaton një praktikë të qartë dhe të dokumentuar për sqarimin e rezultateve të vlerësimit dhe për qasjen ndaj provimeve të korrigjuara. • Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të studentëve zhvillohet në formë me shkrim dhe/ose me gojë, në përputhje me përshkrimet e syllabus-it dhe natyrën e lëndës. • Kjo formë vlerësimi u mundëson pedagogëve të shpjegojnë rezultatet dhe mënyrën e vlerësimit në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke garantuar që studentët të kenë akses në testin e korrigjuar dhe të marrin shpjegime të hollësishme mbi notën e dhënë. • Komisioni i provimit ka detyrimin të shpallë rezultatet përfundimtare brenda një afati maksimal prej 5 ditësh pune nga data e zhvillimit të provimit, pas ballafaqimit të studentëve me vlerësimin e marrë. • Në rastet e provimeve me shkrim, studentëve u ofrohet mundësia të shohin testin e tyre të korrigjuar në prani të pedagogut përkatës, për të marrë sqarime mbi mënyrën e përlllogaritjes së notës dhe për përmbajtjen e përgjigjeve të tyre. • Në rast se studentët kanë paqartësi ose vërejtje lidhur me mënyrën e vlerësimit, ata kanë të drejtën të kërkojnë takim personal me pedagogun për të diskutuar testin e vlerësuar. • Për sqarime të mëtejshme ose nëse vlerësojnë se nuk janë trajtuar në përputhje me kriteret e syllabus-it apo rregulloret përkatëse, studentët mund t'i drejtohen me kërkesë zyrtare me shkrim Përgjegjësit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse, i cili shqyrton rastin dhe merr masat e nevojshme në përputhje me kuadrin institucional dhe rregulloret e Universitetit të Tiranës. Kjo procedurë garanton transparencë, barazi dhe llogaridhënie në procesin e vlerësimit, duke siguruar që çdo student të ketë mundësinë të kuptojë dhe të verifikojë mënyrën e vlerësimit të tij/saj, si dhe të ushtrojë të drejtat e veta në përputhje me normat

	akademike të përcaktuara në legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore të Universitetit të Tiranës. Evidenca: - Rregullore e programit MSc Fizikë, neni 27, pika 6,7 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në kuadër të garantimit të një mjedisi akademik të drejtë dhe të bazuar në parimet e ndershmërisë, integritetit dhe përgjegjshmërisë, Departamenti i Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, zbaton masa të strukturuar për parandalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës në procesin e vlerësimit të studentëve në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë”. Në pjesën më të madhe të lëndëve, provimet zhvillohen në mënyrë të kombinuar – me shkrim dhe me gojë, çka mundëson vlerësim të gjithanshëm dhe njëkohësisht ndihmon në minimizimin e mundësisë për kopje apo manipulim të rezultateve. Mbikëqyrja gjatë provimeve me shkrim kryhet në mënyrë rigoroze nga personeli akademik i lëndës apo anëtarët e komisionit të provimit, të cilët sigurojnë respektimin e rregullave dhe qetësinë në ambientet e zhvillimit të testimit. Pas provimit me shkrim, zhvillohet provimi me gojë, i cili përforcon kontrollin ndaj autenticitetit të performancës së studentëve dhe ndihmon në verifikimin e përvetësimit të njohurive në mënyrë individuale. Para çdo provimi, anëtarët e komisionit informojnë dhe sensibilizojnë studentët se provimi është një veprimtari individuale e bazuar në meritë, ku secili vlerësohet në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë personale. Studentët udhëzohen të respektojnë standardet etike dhe të tregojnë sjellje të denjë e qytetare gjatë gjithë procesit të provimit, në përputhje me Kodin e Etikës së Universitetit të Tiranës. Paralajmërohen se çdo përpjekje për kopje apo komunikim i paautorizuar gjatë provimit përbën shkelje të rëndë, që sjell masa ndëshkimore administrative dhe akademike, sipas rregulloreve në fuqi. Në përgatitjen e detyrave të kursit, projekteve dhe eseve, studentët udhëzohen qartë nga pedagogët për të shmangur çdo formë plagjiature, si dhe për të respektuar parimet e citimit korrekt dhe të autorësisë origjinale. Pedagogët përgjegjës kryejnë kontrollin individual të punimeve të studentëve, duke përdorur mjete digjitale dhe softuerë të specializuar për zbulimin e plagjiaturës. Zbatimi i këtyre masave kontribuon në ndërtimin dhe forcimin e një kulture akademike të bazuar në meritokraci, transparencë dhe integritet, duke siguruar që procesi i vlerësimit në programin Master i




	Shkencave në “Fizikë” të zhvillohet në përputhje të plotë me standardet e arsimit të lartë dhe me legjislacionin kombëtar për etikën në arsimin universitar. Evidenca: - Raporti vjetor FSHN UT 2023-24. - Rregullore e programit të studimit, neni 41 - Kodi i Etikës i UT, neni 5 pika f
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Procesi i dokumentimit të rezultateve të vlerësimit të studentëve në programin Master i Shkencave në “Fizikë” zhvillohet në përputhje të plotë me rregulloret akademike të Universitetit të Tiranës dhe standardet institucionale për transparencë, integritet dhe llogaridhënie në administrimin e të dhënave akademike. Rezultatet e vlerësimeve pasqyrohen në mënyrë të detajuar në Procesverbalin zyrtar të notave, i cili përpilohet nga pedagogu përgjegjës në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore në një nga format e mëposhtme: - o Në formë të shkruar dhe të firmosur manualisht, kur vlerësimi nuk është regjistruar në mënyrë digjitale - o Në formë elektronike përmes sistemit informatik të Universitetit, pas së cilës një kopje e printuar dhe firmosur e procesverbalit i dorëzohet zyrtarisht sekretarisë për arkivim. Procesverbalet e hartuar në formë manuale nuk duhet të përmbajnë korrigjime dhe ndalohej shtimi i emrave të studentëve pas finalizimit të dokumentit, për të ruajtur integritetin dhe vlefshmërinë formale të vlerësimeve. Studentët kanë akses në rezultatet e tyre përmes sistemit informatik të Universitetit, si dhe përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me pedagogun pas përfundimit të vlerësimit. Në rastin e provimeve me gojë, komisioni i vlerësimit bën publikimin e menjëhershëm të notës në përfundim të provimit. Për provimet me shkrim, rezultatet shpallen brenda një afati maksimal prej 15 ditësh pune nga data e zhvillimit të provimit dhe afishohen në stendat zyrtare të Departamentit të Fizikës, në përputhje me kërkesat për transparencë dhe mbrojtje të të dhënave personale. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, procesverbalet zyrtare duhet të dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve pune nga data e publikimit të notave, në mënyrë që të garantohej ruajtja e të dhënave zyrtare dhe përfshirja e tyre në regjistrin akademik të studentit. Vlerësimi i studentëve bazohet në meritë, përgatitje

	individuale dhe përputhje me objektivat e të nxënit, siç përcaktohen në syllabus-in e lëndës. Pedagogu respekton parimin e barazisë në vlerësim, duke ruajtur të njëjtin standard profesional dhe etik për të gjithë studentët. Gjatë korrigjimit të provimit me shkrim, çdo pyetje vlerësohet me pikë individuale, dhe pikët totale duhet të përputhen me strukturën e vlerësimit të miratuar në syllabus. Zbatimi rigoroz i këtyre procedurave siguron besueshmëri, transparencë dhe efektivitet në administrimin e procesit të vlerësimit, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së menaxhimit akademik dhe përmbushjen e standardeve të larta të arsimit të lartë në Universitetin e Tiranës. Evidenca: - Rregullore e programit të studimit, neni 22, faqe 7 - Rregullore e UT, neni 49, faqe 28 - Model teze provimi master - Model proces verbal provimi master
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në përputhje me parimet e transparencës dhe të drejtës për informim dhe mbrojtje të studentit, pas shpalljes së rezultateve të provimit, çdo student në programin Master i Shkencave në "Fizikë" ka të drejtën të kërkojë sqarim nga komisioni i vlerësimit në lidhje me notën e përftuar dhe mënyrën e vlerësimit. Studentit i garantohet e drejta të njoftohet jo vetëm për rezultatin përfundimtar, por edhe për shpërndarjen e pikëve në secilin komponent të tezës së provimit, duke përfshirë çdo pyetje apo pjesë të vlerësuar veçmas. Sqarimet jepen nga pedagogu përgjegjës dhe/ose komisioni i provimit, në mënyrë që studenti të kuptojë në mënyrë të plotë dhe objektive bazën e vlerësimit të tij. Studenti ka të drejtë të ankimojë si vlerësimin përfundimtar të marrë, ashtu edhe procedurat e ndjekura gjatë zhvillimit të provimit, në rastet kur ai/ajo vlerëson se nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara në syllabus apo rregulloret në fuqi. Ankesa mund të parashtrohet me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse, brenda afateve të përcaktuara nga Universiteti i Tiranës dhe në përputhje me Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë. Për lëndët që zhvillohen me vlerësim të vazhduar, studentët kanë të drejtë të paraqesin ankesë për ndonjë aspekt të vlerësimit gjatë semestrit ose për vlerësimin final të këtij procesi. Procedura e ankimit në këto raste ndjek të njëjtat rregulla si për lëndët me provim përfundimtar, por me kushtin që çdo ankesë dhe shqyrtimi i saj të përfundojë brenda javës së fundit të semestrit përkatës, për të mundësuar përmbylljen

	në kohë të procesit akademik. Kjo qasje institucionale garanton të drejtën e studentit për mbrojtje akademike, për transparencë dhe për barazi në trajtim, duke forcuar njëkohësisht besimin në procesin e vlerësimit dhe cilësinë e administrimit akademik në përputhje me parimet e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe rregulloret e Universitetit të Tiranës. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizike, neni 29 - Rregullore e UT, neni 50, 51 - Rregullore e Departamentit të Fizikës, neni 20
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në funksion të garantimit të integritetit akademik dhe respektimit të të drejtave të studentit, Universiteti i Tiranës, përmes strukturave të tij përkatëse, zbaton një procedurë të standardizuar dhe të dokumentuar për shqyrtimin e ankesave lidhur me vlerësimet përfundimtare në kuadër të programit Master i Shkencave në “Fizikë”, të zhvilluar në Departamentin e Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. • Studenti ka të drejtë të paraqesë ankesën për vlerësimin përfundimtar të provimit, nëse vlerëson se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje me kriteret e syllabus-it apo rregulloret në fuqi. • Ankesa duhet të paraqitet me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse, brenda një afati maksimal prej 48 orësh nga momenti i marrjes dijeni për rezultatin e provimit. • Përgjegjësi i Departamentit kryen verifikimet e nevojshme administrative dhe akademike lidhur me përmbajtjen e ankesës dhe dokumentacionin përkatës. • Nëse pas verifikimit paraprak vlerësohet se zgjidhja e çështjes nuk mund të realizohet në nivel departamenti, ai informon menjëherë Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për të ndërmarrë veprimet e mëtejshme institucionale. • Brenda 48 orëve nga momenti i njoftimit nga Përgjegjësi i Departamentit, Dekani vendos ngritjen e një komisioni Ad-hoc, i përbërë nga staf akademik me kompetencë në fushën përkatëse dhe pa konflikt interesi me lëndën ose studentin në fjalë.

	- Komisioni shqyrton dokumentacionin, analizat dhe pretendimet e studentit, si dhe merr në konsideratë çdo material plotësues që ndihmon në vlerësimin objektiv të çështjes. - Pas verifikimit të plotë të çështjes, komisioni Ad-hoc, me miratim të Dekanit, përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit, duke reflektuar çdo ndryshim të justifikuar në notë, nëse është e nevojshme. - Vendimi përfundimtar i komisionit i komunikohet zyrtarisht studentit, dhe një kopje e tij ruhet në dokumentacionin e dosjes akademike përkatëse. Kjo procedurë garanton një trajtë institucionale të drejtë, të dokumentuar dhe transparente të shqyrtimit të ankesave, duke përmbushur standardet e cilësisë, të drejtësisë dhe të barazisë në vlerësim, në përputhje me rregulloret e brendshme të Universitetit të Tiranës dhe parimet e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizike, neni 29 - Rregullore e Departamentit të Fizikës, neni 20			
Konkluzione	Departamenti i Fizikës ka të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë e tij. Studenti ka mundësi të ankimohet për vlerësimin e marrë gjatë procesit mësimor, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit. Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë	Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizikë”, i ofruar nga Departamenti i Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës

thelimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.

në Universitetin e Tiranës, është projektuar për të ofruar një formim akademik të thelluar, të gjerë dhe të integruar, në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë dhe nevojat aktuale të tregut të punës dhe të kërkimit shkencor. Programi është ndërtuar mbi baza të forta teorike dhe eksperimentale, dhe mbështetet në modulet themelore dhe të specializuara, të cilat trajtojnë tematika të avancuara në fushat e fizikës moderne. Lëndët përfshijnë ndër të tjera:

- o Fizikë kuantike dhe teorike të avancuar;
- o Fizikë e materialeve dhe fizikë e gjendjes së ngurtë;
- o Modelim numerik dhe analizë kompjuterike;
- o Fizikë e mjedisit dhe metrologji;
- o Eksperimentim i avancuar në laborator dhe teknika instrumentale.

Mësimdhënia zhvillohet përmes formave klasike akademike si:

- o Leksione teorike;
- o Seminare dhe ushtrime;
- o Laboratorë të avancuar dhe module praktike.

Këto komponentë integrohen me projekte kërkimore individuale dhe në grup, si dhe me angazhimin në aktivitete bashkëpunuese ndërkombëtare, duke i ekspozuar studentët ndaj praktikave më të mira në nivel global. Një pjesë e rëndësishme e programit i kushtohet formimit praktik, përmes përdorimit të laboratorëve të specializuar dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë që përfshijnë:

- o Spektroskopi (absorbancë, fluoreshencë)
- o Instrumente të matjeve metrologjike
- o Pajisje për fizikën e mjedisit dhe të materialeve

Studentët trajnohen për të aplikuar teknika të avancuara eksperimentale, duke u përgatitur për një integrim efektiv në fushat profesionale apo kërkimore që kërkojnë ekspertizë të thelluar tekniko-shkencore. Programi përfshin përdorimin e softuerëve të specializuar shkencorë dhe mjediseve të programimit si MATLAB dhe Python, për:

- o Simulime të fenomeneve fizike;
- o Analiza numerike të të dhënave;
- o Zgjidhjen e modeleve matematikore të avancuara.

Kjo përgatitje u jep studentëve aftësi të aplikueshme në fusha të ndryshme teknologjike dhe kërkimore, duke i bërë ata të aftë të adresojnë problematika komplekse që burojnë nga zhvillimet



	bashkëkohore në shkencë dhe industri. Përmes përmbajtjes akademike dhe praktike të balancuar, si dhe përfshirjes në aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime ndërinstytucionale, programi formon profesionistë të aftë të integrohen menjëherë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky program përmbush objektivat strategjike të zhvillimit akademik të Universitetit të Tiranës dhe është i strukturuar në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në Arsimin e Lartë dhe me standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Ai synon të formojë specialistë të profilit të lartë, të pajisur me kompetenca teorike, praktike dhe kërkimore, të gatshëm për të kontribuar në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të vendit dhe më gjerë. Evidenca: - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë - Marrëveshje me drejtorinë e metrologjisë - Marrëveshje Antea Cement - Tabela 10 Plani mësimor
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në përmbajtjen akademike të Programit të Studimit Master i Shkencave në “Fizikë” dhe në Rregulloren e organizimit të ciklit të dytë të studimeve, ky program synon jo vetëm përvetësimin e njohurive të avancuara në fushën e fizikës teorike dhe eksperimentale, por edhe zhvillimin e aftësive të ndërdisiplinuara që përfshijnë kompetenca në teknologjinë e informacionit, aftësi humane dhe sociale, si dhe kapacitete për komunikim dhe ndërveprim në mjedise akademike dhe profesionale. Programi ofron akses të plotë në infrastrukturë të specializuar për zhvillimin e aftësive teknike dhe kompjuterike: • Laboratori i modelimeve dhe simulimeve është i pajisur me kapacitet të lartë llogaritës (cluster computing), i cili përdoret në zhvillimin e projekteve të avancuara numerike dhe në realizimin e simulimeve fizike. • Salla e informatikës ofron pajisje moderne dhe kompjutera të përditësuar, të përshtatshëm për punë individuale dhe në grup mbi analiza shkencore dhe programim aplikativ. • Studentët përdorin gjerësisht softuerë shkencorë dhe mjedise programimi si:

	- o MATLAB – për modelime matematikore, përpunim të të dhënave dhe simulime dinamike; - o Python – për zgjidhje algoritmike dhe modelim të proceseve fizike komplekse; - o COMSOL Multiphysics – për simulime të avancuara në mekanikë, termodinamikë, elektromagnetizëm dhe fushat ndërdisiplinore. Brenda programit funksionojnë grupe kërkimore dhe njësi mësimore-kërkimore, të cilat krijojnë një mjedis bashkëpunues dhe stimulojnë studentët të ndërtojnë dhe zhvillojnë aftësitë për punë në grup, ndarjen e roleve dhe zgjidhjen kolektive të problemeve kërkimore. Përmes projekteve të orientuara, eksperimenteve laboratorike, diskutimeve shkencore dhe prezantimeve periodike, studentët ndërveprojnë në mënyrë të strukturuar me pedagogët dhe kolegët, duke përfutur një formim të qëndrueshëm në metodologji akademike, etikë dhe reflektim kritik. Studentët e regjistruar në këtë program zotërojnë një nivel minimal të gjuhës angleze B1, sipas Kërkesave për Pranim të Rregullores së UT (shih Evidencën 3.18), ndërsa shumica e studentëve kanë njohuri nga niveli B1 deri në C1. Programi garanton kështu një formim të gjithanshëm dhe të balancuar, ku përveç kompetencave të fushës së fizikës, studentët zhvillojnë edhe aftësi funksionale dhe ndërvepruese që janë thelbësore për karrierën akademike dhe integrimin e tyre në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë “MSc në Fizikë” - Përcaktimet institucionale mbi nivelin e gjuhëve të huaja dhe testet ndërkombëtare për pranimin në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e	GVJ konstaton se Departamenti i Fizikës, në kuadër të zbatimit të standardeve akademike të transparencës, të drejtës së informimit dhe të përfshirjes aktive të studentëve në procesin mësimor, siguron që informacioni mbi përmbajtjen, objektivat dhe mënyrën e vlerësimit të secilës lëndë t’u komunikohet studentëve në mënyrë të plotë dhe të qartë që në fillim të semestrit. Syllabuset e lëndëve, të cilat prezantohen studentëve që në orën e parë të leksionit, përmbajnë informacion të strukturuar në lidhje me:

tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	○ Kompetencat dhe aftësitë që synohet të zhvillohen gjatë ndjekjes së lëndës përkatëse, ○ Përmbajtjen tematike të kursit, rezultatet e të nxënit, format e vlerësimit, peshën e çdo komponenti dhe kriteret e kalueshmërisë, ○ Burimet bibliografike, si dhe format e angazhimit të studentit në seminare, laboratorë apo detyra praktike. Të gjitha syllabus-et janë publike dhe të aksesueshme në faqen zyrtare të Departamentit të Fizikës, duke mundësuar orientimin e studentëve dhe transparencë institucionale. Në javën e fundit të semestrit, çdo pedagog realizon një sesion përmbledhës dhe reflektues, ku rishqyrtohen kompetencat e synuara në fillim të kursit dhe bëhet një vlerësim i përbashkët me studentët mbi arritjen e objektivave të përcaktuara. Kjo qasje promovon pjesëmarrjen aktive të studentëve në vlerësimin e procesit mësimor, duke u dhënë atyre mundësinë të reflektojnë mbi progresin individual dhe mbi përputhshmërinë e përmbajtjes me pritshmëritë e tyre akademike. Po ashtu, studentëve u komunikohet bilanci i pikëve të akumuluar deri në atë moment në komponentët e tjerë të vlerësimit të vazhduar, si: ○ Projekte, detyra kursi, prezantime, teste ndërmjetëse dhe laboratorë, ○ Në mënyrë që ata të kenë një pasqyrë të qartë dhe objektive mbi pozicionimin e tyre akademik përpara hyrjes në provimin përfundimtar. Kjo praktikë e mirëinformimit dhe reflektimit mbi ecurinë e procesit mësimor përforcon përgjegjësinë akademike të studentëve dhe pedagogëve, rrit transparencën dhe efektivitetin e vlerësimit, si dhe siguron respektimin e standardeve të arsimit të lartë në përputhje me kuadrin rregullator të Universitetit të Tiranës dhe ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizike, neni 25, 9 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra	GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer punë laboratorike. Programi i studimit Master i Shkencave në "Fizikë", i zhvilluar pranë Departamentit të Fizikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, është

në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.

konceptuar në mënyrë të tillë që të garantojë jo vetëm përvetësimin e njohurive të thelluara teorike, por edhe zhvillimin e aftësive praktike, kompetencave bashkëpunuese dhe përgatitjen për angazhim të avancuar kërkimor dhe profesional. Programi vendos theks të veçantë në zhvillimin e aftësive praktike dhe punën në grup, duke i orientuar studentët drejt metodave të zgjidhjes së problemeve konkrete dhe ndërdisiplinore. Zhvillimi i njohurive praktike dhe kërkimore mbështetet nga:

- Infrastruktura moderne laboratorike e Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
- Laboratori i modelimeve dhe simulimeve, me kapacitete të larta llogaritëse (cluster computing);
- Laboratorët kërkimorë të specializuar të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, ku studentët marrin pjesë në punë kërkimore të nivelit të avancuar, të orientuara drejt fushave të aplikimit të fizikës.

Studentët inkurajohen të marrin pjesë në grupe pune dhe diskutime akademike, të cilat shërbejnë si bazë për ndërtimin dhe zhvillimin e temave të diplomës në përputhje me fushat kërkimore prioritare të departamentit. Personeli akademik nxit zhvillimin e ideve novatore dhe përfshirjen e studentëve në projekte të mirëstrukturuara kërkimore. Sipas rregullores së programit dhe në përputhje me politikat e ndërkombëtarizimit të Universitetit të Tiranës, studentët kanë të drejtë të përfitojnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe programet e shkëmbimit akademik me universitete dhe institute kërkimore partnere jashtë vendit. Departamenti i Fizikës mbështet dhe lehtëson procesin e mobilitetit studentor dhe akademik, duke synuar përgatitjen e studentëve për një angazhim efektiv në një mjedis ndërkombëtar të shkencës dhe teknologjisë. Këto komponentë e bëjnë programin Master i Shkencave në "Fizikë" një platformë të avancuar formimi akademik dhe kërkimor, duke përgatitur profesionistë të aftë për t'u përfshirë në tregun ndërkombëtar të punës dhe në komunitetin shkencor global, në përputhje me standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Evidenca:

- Marrëveshje në favor të programit të studimit
- Inventar laboratorë Master. (Biofizika, Materiale, Trup i ngurtë)

	- <i>Inventar Laborator i Programimit</i> - <i>Tabela 5 Institucinet dhe organizatat bashkëpunuese</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti i Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës zotëron një eksperiencë të konsoliduar shumëvjeçare në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat përfshijnë: • Seminare shkencore tematikë; • Konferenca dhe workshop-e ndërdisiplinare; • Webinare virtuale me pjesëmarrjen e ekspertëve nga institucione prestigjioze; • Shkolla verore të specializuara në fushat më të avancuara të fizikës dhe teknologjisë. Këto aktivitete fokusohen në trajtim të çështjeve aktuale dhe zhvillimeve më të fundit në fushën e fizikës teorike, eksperimentale dhe të aplikuar, duke krijuar hapësira për diskutim, shkëmbim idesh dhe rritje të kapaciteteve kërkimore. Studentët e programit Master i Shkencave në “Fizikë” inkurajohen dhe mbështeten për të marrë pjesë aktive në këto aktivitete, si pjesëmarrës, prezantues apo bashkëorganizatorë, në varësi të natyrës së ngjarjes dhe profilit të tyre studimor. Përmes këtyre nismave, Departamenti i Fizikës krijon një mjedis të hapur dhe dinamik akademik, duke e orientuar procesin e formimit të studentëve drejt përfshirjes aktive në komunitetin shkencor dhe ndërtimit të një kulture të qëndrueshme kërkimore dhe bashkëpunimi ndërinstitutional. Evidenca: - <i>Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022</i> - <i>Vizita ne Institucion</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Departamenti i Fizikës, në kuadër të misionit të tij për të nxitur formimin shkencor të studentëve dhe për të përgatitur profesionistë të aftë për t’u përfshirë në veprimtari kërkimore të nivelit të avancuar, ofron mbështetje të strukturuar akademike dhe materiale për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Fizikë”. Personeli akademik angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në mentorimin e studentëve, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e ideve novatore në fushën e fizikës, si dhe në aftësimin e tyre për të ndërmarrë studime kërkimore të strukturuar në përputhje me standardet akademike dhe

shkencore bashkëkohore. Një fokus i veçantë i mbështetjes i kushtohet procesit të përgatitjes dhe realizimit të temave të diplomës, ku pedagogët ofrojnë asistencë metodologjike dhe shkencore për të orientuar studentët drejt zgjidhjes së problematikave konkrete në fushën përkatëse. Temat e diplomës së studentëve të ciklit të dytë realizohen kryesisht me mbështetjen logjistike, teknike dhe financiare të Departamentit të Fizikës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të cilët vënë në dispozicion:

- o Infrastrukturën laboratorike dhe pajisjet e nevojshme për eksperimentim;
- o Qasjen në literaturë shkencore dhe burime të përditësuara akademike;
- o Mbështetje materiale për zhvillimin e komponentëve praktikë të punimit.

Në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale të bashkëpunimit, veçanërisht atyre në kuadër të programit Erasmus+, studentët e programit kanë përfutur mundësi për mobilitet në universitete partnere europiane, ku janë angazhuar në:

- o Zhvillimin e moduleve të avancuara kërkimore;
- o Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe punë laboratorike me karakter ndërdisiplinor;
- o Ndërtimin e një rrjeti profesional në mjediset akademike ndërkombëtare.

Departamenti i Fizikës inkurajon dhe mbështet aktivisht pjesëmarrjen e studentëve në këto programe, duke u ofruar orientim dhe ndihmë administrative për aplikimin dhe integrimin në institucionet pritëse. Këto mekanizma mbështetës kontribuojnë në formimin e një kulture kërkimore dhe inovative, duke përgatitur studentët për angazhim të suksesshëm në projekte shkencore, studime doktorale dhe tregun ndërkombëtar të punës, në përputhje me objektivat strategjike të Universitetit të Tiranës dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Evidenca:

- Tabela 19, Aktivitete individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit
- Tabela me disa diploma studentesh Msc fizike

Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Fizikë" garanton rritjen e aftësive krijuese të studentëve nëpërmjet kurikulës së saj. Syllabuset e programit të studimit garantojnë përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në disiplina kryesore të Fizikës edhe të komunikimit në gjuhë të huaj. Personeli akademik është angazhuar edhe në veprimtari të tjera si konferenca apo seminare të ndryshme në bashkëpunim edhe me studentët e programit të studimit duke ndihmuar në zhvillimin e kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Departamenti i Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës zbaton një procedurë të standardizuar, të dokumentuar dhe transparente për menaxhimin e detyrimeve përmbyllëse në kuadër të programit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Fizikë". Kjo procedurë është publike, e miratuar nga strukturat përgjegjëse akademike dhe e aksesueshme nga të gjithë studentët, nëpërmjet faqeve zyrtare të departamentit dhe fakultetit. Për të përfunduar programin dhe për t'u pajisur me diplomën përkatëse, studenti duhet të përmbushë këto detyrime akademike dhe administrative: • Shlyerjen e të gjitha provimeve dhe krediteve të parashikuara në planin mësimor të programit; • Likuidimin e çdo detyrimi administrativ ndaj Fakultetit të Shkencave të Natyrës (tarifa, dokumentacion etj.); • Përfundimin e punimit të diplomës, në përputhje me udhëzimet e mentorit dhe kërkesat e përcaktuara në rregulloren e programit; • Pjesëmarrjen në sesionet e mbrojtjes së diplomës, të organizuara nga Dekanati, në datat dhe afatet zyrtare të shpallura në fillim të vitit akademik. Mbrojtja publike e punimit të diplomës mund të realizohet vetëm nëse studenti ka:

	• Siguruar të gjitha kreditet e programit (120 ECTS për ciklin e dytë); • Përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kurrikulës, pa asnjë provim të mbetur; • Regjistruar dhe dorëzuar temën e diplomës në përputhje me kërkesat formale të departamentit dhe afatet e përcaktuara nga fakulteti; • Afatet për dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës shpallen zyrtarisht nga Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe publikohen në faqen zyrtare të fakultetit në fillim të çdo viti akademik; • Studentët duhet të respektojnë këto afate për të përfituar të drejtën e diplomimit në sezonin përkatës; • Mbrojtja e diplomës realizohet para një komisioni akademik të ngritur me urdhër të Dekanit, në përputhje me Statutin dhe aktet nënligjore të Universitetit të Tiranës. Pas përmbushjes së të gjitha kërkesave akademike dhe mbrojtjes me sukses të punimit të diplomës, studenti: • Pajiset me Diplomën Master i Shkencave në “Fizikë”, si dhe • Suplementin e Diplomës (Diploma Supplement), i cili dokumenton në mënyrë të standardizuar përmbajtjen dhe rezultatet e programit të ndjekur, në përputhje me kuadrin evropian të kualifikimeve. Kjo procedurë garanton transparencë, standardizim dhe barazi në trajtimin e studentëve, duke kontribuar në ruajtjen e cilësisë akademike dhe përputhjen e programit me kërkesat e sistemit të Bolonjës dhe të legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Evidenca: - Statuti i UT, neni 110 - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizikë, neni 17, 34 - Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e	Departamenti i Fizikës dhe strukturat përkatëse të Fakultetit të Shkencave të Natyrës ofrojnë një mbështetje të gjithanshme dhe të koordinuar për studentët e programit Master i Shkencave në “Fizikë” gjatë procesit të përfundimit të studimeve, me qëllim lehtësimin e realizimit të punimit të diplomës dhe përmbushjen e

nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	të gjitha detyrimeve akademike. Në kuadër të mbështetjes institucionale, studentëve u garantohej e drejta për të: • Përdorur të gjitha laboratorët mësimorë, didaktikë, kërkimorë-specialë dhe llogaritës të Departamentit të Fizikës, për qëllime akademike dhe kërkimore të lidhura me temën e diplomës; • Konsultuar materiale të shkruara, dokumentacion teknik dhe të dhëna shkencore, të arkivuara dhe të disponueshme në ambientet dhe arkivat e Departamentit të Fizikës; • Përfutur nga përvoja e stafit akademik, përmes takimeve individuale apo grupe me udhëheqësit shkencorë dhe anëtarë të grupeve kërkimore. Procesi i shkrimit dhe mbrojtjes së punimit të diplomës organizohet në përputhje me: • Statutin e Universitetit të Tiranës, i cili përcakton standardet institucionale për përfundimin e ciklit të dytë të studimeve; • Rregulloren e përgjithshme të Universitetit të Tiranës për diplomimet, që specifikon detyrimet administrative dhe procedurat e mbrojtjes publike; • Rregulloren specifike të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë”, e cila detajon afatet, kriteret e vlerësimit, formatin dhe mënyrën e dorëzimit të diplomës. Kjo qasje e strukturuar garanton një proces diplomimi efikas, të mbështetur dhe në përputhje me standardet akademike dhe ligjore, duke synuar formimin e plotë të studentëve si profesionistë të aftë për të kontribuar në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Evidenca: - <i>Rregullore e programit të Ciklit të dytë të studimit MSc Fizike, neni 8, 35, 37</i> - <i>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të	Në përputhje me standardet akademike të Universitetit të Tiranës dhe aktet nënligjore në fuqi, procesi i vlerësimit përmes provimeve në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë” administrohet në mënyrë të strukturuar dhe të kontrolluar, duke garantuar objektivitet, transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë. Çdo provim organizohet dhe administrohet nga një komision i posaçëm, i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, të cilët:




rëndësisë dhe peshës specifike.	○ Janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zhvillimit të provimit; ○ Garantojnë respektimin e rregullave dhe integritetin e procesit të testimit; ○ Kryejnë vlerësimin e materialeve të dorëzuara nga studentët, në përputhje me kriteret e përcaktuara në syllabus. Testimi i studentëve bazohet në: ○ Programin mësimor të lëndës; ○ Objektivat e të nxënit të përcaktuara në syllabusin përkatës; ○ Kompetencat që pritet të jenë fituar gjatë gjithë viteve akademike. Forma e provimit përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të jetë: ○ Me shkrim, për vlerësimin e aftësive analitike dhe përvetësimit të përmbajtjes teorike; ○ Me gojë, për testimin e argumentimit verbal dhe zotërimit të koncepteve bazë; ○ E kombinuar, sipas natyrës së lëndës dhe përcaktimeve në syllabus. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës, duke u bazuar në përmbajtjen dhe objektivat e planit mësimor. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, materialet e provimit (teza, fletëpërgjigjet dhe procesverbalet përkatëse) arkivohen në mënyrë të rregullt në ambientet e Departamentit të Fizikës. Arkivimi i materialeve realizohet në përputhje me udhëzimet institucionale për sigurimin e gjurmueshmërisë, ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe mbrojtjen e transparencës në vlerësim. Kjo procedurë e standardizuar kontribuon në ruajtjen e cilësisë akademike, objektivitetit të vlerësimit dhe besueshmërisë së rezultateve, duke përmbushur kriteret e sigurimit të cilësisë sipas kuadrit institucional të Universitetit të Tiranës dhe kornizës evropiane të arsimit të lartë. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizikë, neni 26,27,33 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MSc në Fizikë
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i	Departamenti i Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës ka të përcaktuar një procedurë të

diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	standardizuar për procesin e përzgjedhjes, përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës, e cila zbatohet në përputhje me rregulloret përkatëse institucionale dhe me Statutin e UT. Personeli akademik dhe udhëheqësi i punimit të diplomës kanë rol të drejtpërdrejtë në asistimin e studentëve gjatë përzgjedhjes së temës dhe gjatë gjithë fazave të realizimit të punimit. Studentët udhëhiqen për të zgjedhur tema që përputhen me fushat kërkimore të departamentit dhe përbëjnë kontribut shkencor dhe aplikativ, duke respektuar parimet e origjinalitetit, etikës dhe realizueshmërisë së punës. Grupet mësimore-kërkimore, të ngritura brenda Departamentit të Fizikës, kanë detyrën të: ○ Koordinojnë procesin e përzgjedhjes së temave të diplomës sipas fushave specifike të kërkimit shkencor; ○ Sigurojnë mbikëqyrje akademike dhe teknike për studentët gjatë gjithë procesit të zhvillimit të diplomës; ○ Regjistrojnë dhe depozitojnë temat e përzgjedhura pranë sekretarisë së departamentit brenda muajit shkurt të vitit akademik përkatës. Tema e diplomës përzgjidhet në koordinim të drejtpërdrejtë ndërmjet studentit dhe udhëheqësit akademik. Tema duhet të jetë në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe të miratohet zyrtarisht nga Departamenti i Fizikës, përpara se të fillojë puna aktive mbi të. Studentët udhëzohen nga stafi akademik për respektimin e standardeve të shkrimit akademik dhe të strukturimit të punimit të diplomës, në përputhje me: ○ Formatin zyrtar të miratuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës; ○ Kërkesat për citimin korrekt, integritetin shkencor dhe paraqitjen grafike e gjuhësore të dokumentit. Pedagogët ofrojnë ndihmë në redaktimin teknik dhe përmbajtësor të punimit, duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat e rregullores. Udhëheqësi akademik i diplomës është përgjegjës për: ○ Vlerësimin e përmbajtjes shkencore të punimit; ○ Verifikimin e cilësisë së rezultateve, analizës dhe përfundimeve të arritura; ○ Shqyrtimin përfundimtar të dokumentit përpara dorëzimit zyrtar për mbrojtje. Pas përfundimit të këtij procesi, udhëheqësi:
--	--




	○ Konfirmon nëse punimi është i plotë dhe i gatshëm për mbrojtje publike; ○ Vendos vlerësimin paraprak në pikë, i cili konsiderohet nga komisioni i mbrojtjes së diplomës gjatë vlerësimit përfundimtar. Mbrojtja e punimit të diplomës realizohet në sezonet zyrtare të përcaktuara nga Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në përputhje me kalendarin akademik vjetor. Komisioni i mbrojtjes merr në konsideratë vlerësimin e udhëheqësit, performancën e studentit gjatë prezantimit dhe përgjigjet ndaj pyetjeve të anëtarëve të komisionit, për të përcaktuar notën përfundimtare të diplomës. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizikë, neni 9,35,37 - Rregullore e shkrimit të diplomave për MSc Fizikë
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë periudhës së dedikuar për hartimin dhe finalizimin e punimit të diplomës, që sipas kalendarit akademik shtrihet përgjithësisht nga muaji Mars deri në Qershor, udhëheqësi akademik i diplomës garanton mbështetje të vazhdueshme për studentët në kuadër të realizimit me cilësi të lartë të temës së përzgjedhur. Studentëve u sigurohet akses i plotë në laboratorët mësimorë dhe kërkimorë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, përfshirë laboratorët e modelimeve numerike, laboratorët eksperimentalë dhe hapësirat e dedikuara për analizë të të dhënave apo simulime shkencore. Udhëheqësi i diplomës, në bashkëpunim me strukturat akademike të FSHN dhe Universitetit të Tiranës, mundëson aksesin e studentëve në institucionet partnere, me të cilat janë në fuqi marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitutional, duke përfshirë: ○ Institute kërkimore shkencore; ○ Njësi laboratorike të specializuara jashtë UT; ○ Subjekte të tjera të fushës së shkencës dhe teknologjisë. Përveç infrastrukturës teknike, udhëheqësi ofron asistencë në identifikimin dhe përdorimin e burimeve akademike, duke përfshirë: ○ Literatura shkencore të përditësuar dhe të aksesueshme në bibliotekat e UT dhe përmes platformave digjitale; ○ Baza të dhënash shkencore dhe publikime relevante për temën e diplomës;

	○ Udhëzime metodologjike për zbatimin e teknikave kërkimore, mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin statistik. Kjo mbështetje e koordinuar siguron që studentët e programit Master i Shkencave në “Fizikë” të kenë kushtet optimale për realizimin e një punimi diplome cilësor dhe të mbështetur në praktika bashkëkohore kërkimore, duke ndihmuar në përgatitjen e tyre për fazat e mëtejshme të karrierës akademike apo profesionale. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizikë, neni 4,37 - Tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ konstaton se bazuar në rregulloren e Departamentit, e hartuar në përputhje me rregulloren e Universitetit të Tiranës, studentit, në fund të mbrojtjes, pasi i ka plotësuar të gjithë kriteret, i komunikohet nota. Evidenca: - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizikë, neni 28 - Rregullore e vlerësimit të diplomave për MSc fizikë
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Fizikë” dhe Statutin e Universitetit të Tiranës, studentëve që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet akademike dhe administrative të parashikuara në ciklin e dytë të studimeve u lëshohet Diploma e Studimeve të Ciklit të Dytë, e shoqëruar me Suplementin e Diplomës dhe listën përmbledhëse të notave. Diploma lëshohet vetëm pas përmbushjes së plotë të të gjitha detyrimeve akademike të përcaktuara në planin mësimor dhe programin përkatës të studimeve (120 ECTS për programin MSc). Programi i studimit është i strukturuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS), duke garantuar transparencë dhe mundësi për njohjen ndërkombëtare të diplomës. Numri total i krediteve, përmbajtja e planit mësimor dhe nota përfundimtare e diplomimit pasqyrohen në dokumentacionin përfundimtar të lëshuar për çdo student. Të gjitha informacionet e lidhura me diplomimin dhe dokumentacionin përkatës janë të aksesueshme në mënyrë transparente përmes Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Departamentit të Fizikës.

	Kjo procedurë standarde siguron besueshmëri, transparencë dhe përputhshmëri ndërkombëtare të diplomave të lëshuara nga Universiteti i Tiranës, duke mbështetur integrimin e të diplomuarve në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës dhe në ciklet e mëtejshme të studimeve. Evidenca: - Statuti i UT, neni 111 - Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit MSc Fizikë, neni 17, 36 - Suplementi i diplomës (dosja e programit të studimit) - Model diplome
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Departamenti i Fizikës administron dhe ruan dokumentacionin lidhur me aktivitetin akademik të studentëve, duke përfshirë provimet e zhvilluara, detyrat e kursit, projektet, vlerësimet laboratorike dhe materiale të tjera përkatëse. Provimet e studentëve ruhen deri në përfundim të semestrit pasardhës, pas së cilës ato asgjësohen. Për detyrat e kursit, projektet dhe dokumentacionin laboratorik, afati i ruajtjes është një vit. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave Natyrore (FSHN) mban dhe administron regjistrin themeltar të studentëve. Ky regjistër përfshin të dhëna personale të studentëve, informacion mbi arritjet e tyre akademike, vlerësimet gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhënat mbi lëshimin e diplomave dhe suplementëve përkatës, si dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme të formatuar sipas standardeve shtetërore. Regjistri i studentëve mbahet në të dy formatet: të shkruar dhe elektronik, dhe ruhet në mënyrë të përhershme. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për përpilimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e këtij regjistri, duke përfshirë variantin e tij të shkruar me dorë. Ky regjistër plotësohet në mënyrë të pandryshueshme, pa korrigjime dhe nuk lejohet të modifikohet në asnjë rrethanë. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve kryhet nga sekretaria mësimore në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës - Ligjin Nr 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Konkluzione	Në programin e studimit Master i Shkencave në "Fizikë" testimi final bëhet nëpërmjet punimit të diplomës dhe mbrohet përpara një komisioni të posaçëm. Në programin e studimit përcaktohet procedura e plotë për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Në përfundim studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe	NA

dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e	Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Fizikës realizon organizimin e punës në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ndarja e lëndëve dhe ngarkesës mësimore bëhet duke respektuar përvojën pedagogjike dhe kërkimore të personelit në fushën përkatëse, si dhe duke marrë parasysh gradën shkencore apo titullin akademik të secilit anëtar të stafit. Personeli ndihmësakademik me funksione mësimore-shkencore (laborantët) luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e procesit mësimor, përmes mirëmbajtjes dhe funksionimit të vazhdueshëm të laboratorëve mësimorë dhe kërkimorë. Çdo fillim viti akademik përcaktohet përbërja e stafit akademik që do të angazhohet në programin e studimeve Master i Shkencave në “Fizikë”, si dhe ngarkesa individuale semestrale dhe vjetore për secilin anëtar të stafit. Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në funksion të veprimtarive përbërëse formalizohet ndërmjet Përgjegjësit të Departamentit dhe personelit akademik, në përputhje me Udhëzimin e MASR Nr. 29, datë

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

10.09.2018, i ndryshuar. Stafi akademik është përgjegjës për hartimin e programeve të lëndëve, realizimin efektiv të orëve mësimore, kontrollin e dijeve, zhvillimin e veprimtarive kërkimore-shkencore, si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Për të garantuar cilësi në mësimdhënie dhe për të përforcuar lidhjen kërkim-mësimdhënie, në këtë program janë përfshirë edhe punonjës kërkimorë të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ). Gjatë katër viteve të fundit, Departamenti ka realizuar mbi 100 botime shkencore dhe ka marrë pjesë në një sërë konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e të cilave është mbështetur financiarisht nga Fakulteti i Shkencave Natyrore (FSHN). Angazhimi profesional dhe niveli i lartë i kualifikimit të stafit akademik pasqyrohet në titujt akademikë dhe gradat shkencore të mbajtura prej tyre.

Evidenca:

- *Statuti i Universitetit të Tiranës*

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	3	-	3	-
Prof.As.Dr	5	-	5	-
Dr	7	-	7	-
MSc	-	1	-	1
Total	15	1	15	1

- *Rregullore e UT, nenet 27, 28*
- *Raport mësimor shkencor i Departamentit të Fizikës 2022-2023.*
- *Raport vjetor FSHN, UT, 2021-2022*
- *Raport vjetor FSHN, UT, 2022-2023*
- *Udhëzimi i MASR Nr.29, datë 10-09-2018: Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.*
- *Aneks Tabela 12. Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës*
- *Aneks Tabela 19. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik përgjegjës për programin e studimit.*



Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor në kuadër të programit të studimit mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me përmbajtjen e programeve të lëndëve dhe me kornizën ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sipas evidencave të dhëna 94% e personelit akademik është me tituj dhe grada shkencore. Vetëm një staf akademik është me gradën MSc. Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në funksion të veprimtarive përbërëse të punës akademike realizohet në mënyrë të formalizuar ndërmjet Përgjegjësit të Departamentit dhe secilit anëtar të personelit akademik. Ky proces zhvillohet në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar. Personeli akademik është përgjegjës për: • hartimin dhe përditësimin e programeve të lëndëve; • realizimin efektiv të orëve të mësimdhënies; • kontrollin e njohurive të studentëve nëpërmjet metodave të vlerësimit të parashikuara; • zhvillimin e veprimtarive kërkimore-shkencore, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 74, fq 4 - Rregullore e UT, nenet 27, 28 - Udhëzimi i MASR Nr.29, datë 10-09-2018: Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. - Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Fizikë, viti akademik 2021 – 2022, 2022-2023, 2023-2024. Aneks Tabela 4 - Aneks Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke	Në Universitetin e Tiranës, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arshivës, si njësi përbërëse të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, janë strukturat përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit. Në nivel fakulteti, konkretisht në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, përgjegjësia për administrimin e të dhënave të personelit i takon Degës së Burimeve Njerëzore dhe Degës së Protokoll-Arshivës. Këto struktura mbajnë dhe përditësojnë dokumentacionin për të gjithë anëtarët e stafit akademik të brendshëm, ndihmës akademik dhe administrativ. Dega e Burimeve Njerëzore disponon një dosje individuale për çdo punonjës, e cila përfshin dokumentacionin përkatës të punësimit, si:

përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	curriculum vitae, diploma, lista e notave, librezë e punës, kontrata e punës, dokumentacion mbi titujt akademikë dhe çdo material tjetër mbështetës që lidhet me statusin dhe kualifikimet e personelit. Për të garantuar përditësimin dhe saktësinë e të dhënave, çdo anëtar i stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ka detyrimin të përditësojë periodikisht curriculum vitae-në e tij në përputhje me zhvillimet profesionale dhe akademike. Evidenca: - <i>Struktura organizative e UT</i> - <i>Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës</i> - <i>Raport vjetor i FSHN 2021 – 2022</i> - <i>Raport vjetor i FSHN, UT, 2022-2023</i> - <i>CV-të e stafit akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë (dosja e programit të studimit)</i> - <i>Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Fizikë, viti akademik 2021 - 2022, 2022-2023, 2023-2024. Aneks Tabela 4</i> - <i>Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës Aneks Tabela 12</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedurat dhe kriteret e përgjithshme për punësim në Universitetin e Tiranës, përfshirë Fakultetin e Shkencave të Natyrës, përcaktohen në: • Statutin e Universitetit të Tiranës (UT); • Rregulloren e UT; • Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë; • Statusin e Personelit Akademik. Departamenti i Fizikës, në fillim të çdo viti akademik, analizon: nevojat dhe kërkesat për staf akademik për mbulimin e lëndëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizikë". Harton dokumentin e planit të ngarkesave mësimore për stafin aktual. Në bazë të këtij dokumenti, departamenti parashikon nevojat për: • Staf akademik me kontratë (PAK) • Staf akademik ekzistues (PAE) Nevojat për staf i përcillen Dekanit ose Rektorit, në zbatim të Statutit të UT. së bashku me kriteret e përgjithshme të bazuara në legjislacionin në fuqi: Kriteret specifike publikohen në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN). Ato shpallen gjithashtu në Buletinin e Prokurimit Publik Të gjitha afatet dhe hapat e procedurës bëhen publike dhe respektohen në mënyrë të rreptë për të përfunduar procesin e rekrutimit. Ngrihet një Komision Ad-hoc për vlerësimin e aplikimeve.



	Komisioni kryen një verifikim paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta. Faza e Vlerësimit: • Vlerësimi i dosjes • Intervista Vetëm kandidatët që kualifikohen në fazën e parë (vlerësimi i dosjes) kalojnë në intervistë. Komisioni, brenda afateve të përcaktuara, shpall kandidatin/kandidatët fitues. Konkurrimi zhvillohet në mjediset e njësisë kryesore dhe rezultatet publikohen në faqen zyrtare të saj. Dega e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës (njësia bazë), është përgjegjëse për: Shpalljen e vendeve të lira të punës; Hartimin e ofertave të punës; Përcaktimin e kritereve të pranimit; Ngritjen e komisioneve të vlerësimit; Zhvillimin e procesit të konkurrimit; Vlerësimin e dosjeve; Informimin për rezultatet përfundimtare; Shpalljen e vendimit përfundimtar. Kjo degë ka për detyrë të sigurojë përmbushjen e nevojave të programit të studimit për staf akademik dhe të menaxhojë procesin e përzgjedhjes së stafit me kontratë (PAK). Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 14, fq. 9-10, nenet 67, 68, 69, fq. 42-44</i> - <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës, nenet 25, 26, fq. 16-18</i> - <i>Vendim i Keshillit të Ministrave Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik"</i> - <i>Raport vjetor i FSHN 2021 – 2022</i> - <i>Raport vjetor i FSHN 2022 – 2023</i> - <i>Procedurë punësimi</i> - <i>Vendim i Rektoratit, Universiteti Tiranës. nr2. Datë 24.01.2022. për miratimin e manualit "Mbi punësimin e personelit në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Struktura organizative e UT</i> - <i>Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN)</i> - <i>Vendim i dekanatit nr 117 dt 21.09.2022 për fituesit e vendeve vakante në Departamentin e Fizikës</i> - <i>Njoftim vend vakant Departamenti i Fizikës (faqja online e FSHN)</i> - <i>Njoftim nga Agjencia e Prokurimit Publik për vend vakant Departamenti i Fizikës</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron	Departamenti i Fizikës, në çdo fillim viti akademik realizon organizimin e punës në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky

dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	department ka staf akademik me tituj dhe grada që mbulojnë mësimin në masterin shkencor në Fizikë. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor-shkencor (laborantët) ndihmon në realizimin e mësimdhënies, kryesisht në mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e laboratoreve mësimor dhe shkencor. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës - Rregullore e Universitetit të Tiranës. - VKM nr. 329, datë 12.4.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik" - Vendim rektorati nr 3. Datë 24.01.2022 Rregullore e vlerësimit të performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrativ. - Vendim i Bordit të Administrimit nr 15 dt 11.04.2023 Miratimi i shkallës së vështirësisë në punë në laboratorët e FSHN. - Rregullorja e Departamentit të Fizikës - Rregullorja e programit të studimit "Master i Shkencave në Fizikë"
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	1. Strukturat Përgjegjëse për Administrimin e të Dhënave të Personelit. në nivel universiteti, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arshivës, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, janë strukturat përgjegjëse për: • Mbledhjen, • Ruajtjen, • Përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN), këto funksione kryhen nga: • Dega e Burimeve Njerëzore, • Dega e Protokoll-Arshivës, 2. Menaxhimi i Dosjeve të Personelit. Dega e Burimeve Njerëzore administron dosje të plota për secilin prej anëtarëve të personelit akademik të brendshëm, ndihmës-akademik dhe administrativ. Këto dosje përmbajnë dokumentacionin e mëposhtëm: a) Curriculum Vitae (CV), b) Diplomë dhe listë notash, c) Librezë pune, d) Kontratë pune, e) Tituj akademik, f) Dokumentacion shtesë sipas rastit.

	Të dhënat për çdo punonjës ruhen dhe përditësohen rregullisht me informacionin më të fundit. Çdo anëtar i stafit (akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ) përditëson CV-në e tij periodikisht. 3. Ngarkesa Akademike dhe Organizimi i Punës Në fillim të çdo viti akademik, përcaktohen: • Stafi akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në “Fizikë” • Ngarkesa semestrale dhe vjetore individuale për çdo anëtar të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtaritë përkatëse formalizohet përmes një marrëveshjeje ndërmjet: • Përgjegjësit të Departamentit të Fizikës; • Anëtarëve të personelit akademik të angazhuar. Ky proces bazohet në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 29, datë 10.09.2018, të ndryshuar. Evidenca: - <i>Struktura organizative UT</i> - <i>Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN)</i> - <i>Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021 – 2022</i> - <i>Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2022 – 2023</i> - <i>Udhëzimi i MASR Nr.29, datë 10-09-2018: Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.</i> - <i>CV-të e stafit akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit</i> - <i>Master i Shkencave në Fizikë. (Dosja e programit të studimit)</i> - <i>Aneks Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës</i> - <i>Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Fizikë, viti akademik 2021 - 2022, 2022-2023, 2023-2024. Aneks Tabela 4</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi	Universiteti i Tiranës, përmes politikave të tij institucionale, promovon dhe stimulon vazhdimisht kualifikimin profesional dhe akademik të personelit të angazhuar në administrimin dhe mbulimin e programeve të studimit. Ky angazhim konkretizohet edhe përmes mbështetjes së mobilitetit ndërkombëtar, në kuadër të marrëveshjeve shumëpalëshe dhe dypalëshe të bashkëpunimit shkencor, të nënshkruara nga qeveria

e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	shqiptare me Bashkimin Evropian (nëpërmjet programit ERASMUS) dhe me institucione të tjera partnere. Një listë e marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara nga Universiteti i Tiranës mund të konsultohet në faqen zyrtare: https://unitir.edu.al/marreveshjetbilaterale-2/ Ndërsa marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të programit Erasmus+ KA1 gjenden në: https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universitetiitiranes Në vlerësim të përkushtimit të tij për cilësi në kërkimin shkencor, Universiteti i Tiranës është vlerësuar nga Komisioni Evropian në janar 2022 me logon prestigjioze "HR Excellence in Research": https://unitir.edu.al/universiteti-i-tiranes-mbajtes-i-logos-hr-excellence-inresearch Në kuadër të mbështetjes për zhvillimin profesional të studentëve të programit Master i Shkencave në "Fizikë", Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron mundësi konkrete për përfshirjen e tyre në eksperiencë praktike dhe kërkimore. Këto përfshijnë: • Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, ku studentët kanë mundësi të zhvillojnë punën praktike të temës së diplomës; • Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT), ku realizohet një cikël praktikash laboratorike njëjavore në lëndën e fizikës mjekësore. Gjithashtu, janë formalizuar marrëveshje bashkëpunimi për praktika profesionale, internship-e, projekte të përbashkëta kërkimore dhe udhëheqje diplomash me institucionet e mëposhtme: a) Drejtoria e Metrologjisë; b) Kompania Antea Cement sh.a c) Fakulteti i Studimeve Profesionale, Durrës; d) Instituti i Arkeologjisë; e) Instituti i Ndërtimit f) Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Përmes këtyre bashkëpunimeve, studentët përfitojnë eksperiencë konkrete pune, aftësohen profesionalisht, thellojnë dijet e fituara gjatë studimeve akademike dhe përmirësojnë ndjeshëm perspektivën për punësim në tregun vendas dhe ndërkombëtar. Evidenca:
---	---




	- <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 14.</i> - <i>Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT</i> - <i>Marrëveshje CMS me CERN</i> - <i>Marrëveshje në favor të programit të studimit</i> - <i>Marrëveshje me drejtorinë e metrologjisë.</i> - <i>Plani strategjik i zhvillimit të UT 2018-2023, Ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, fq 10; Personeli dhe infrastruktura, strategjitë e zbatimit, fq 23</i> - <i>Marrëveshje bashkëpunimi te UT</i> - <i>Aneks Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i> - <i>Aneks Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese ne rang programi Studimi.</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Studentët që përgatisin temën e diplomës shoqërohen në institucionet pritëse, si Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), nga pedagogu përkatës udhëheqës. Ky i fundit luan një rol të rëndësishëm në orientimin dhe mbështetjen e studentëve për realizimin e detyrimeve të tyre akademike. Në rastin e zhvillimit të praktikave njëjavore në kuadër të lëndës Fizikë Mjekësore, aktiviteti realizohet nga një specialist i punësuar në QSUT, i cili, njëkohësisht, është edhe pedagog me kontratë pranë Departamentit të Fizikës. Kjo bashkëdyzim i roleve ndihmon në ruajtjen e standardit akademik dhe profesional të praktikës. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në funksion të forcimit të lidhjes midis studimeve teorike dhe përgatitjes praktike, ka formalizuar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe subjektsh të tjera, si: • Drejtoria e Metrologjisë; • Kompania Antea Cement sh.a; • Instituti i Arkeologjisë; • Instituti i Ndërtimit. Këto marrëveshje përfshijnë mundësi për praktika profesionale, internship-e, projekte të përbashkëta kërkimore, udhëheqje diplomash dhe veprimtari akademike e shkencore të përbashkëta. Në të gjitha rastet, si pedagogu udhëheqës, ashtu edhe personeli mikpritës i institucionit bashkëpunues, angazhohen aktivisht për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre akademike dhe marrin pjesë në procesin përfundimtar të vlerësimit të punës së studentit. Evidenca: - <i>Marrëveshje CMS me CERN</i>

	- Marrëveshje në favor të programit të studimit (5 marrëveshje) - Marrëveshje me drejtorinë e metrologjisë. - Aneks Tabela 1 Lista e pedagogëve PAK të angazhuar në programin cikli dytë, Departamenti Fizikës			
Konkluzione	GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor në kuadër të programit të studimit mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me përmbajtjen e programeve të lëndëve dhe me kornizën ligjore dhe nënligjore në fuqi. Departamenti i Fizikës ka staf akademik me tituj dhe grada që mbulojnë mësimin në masterin shkencor në Fizikë (15 staf me tituj dhe grada). Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor (laborantët) ndihmon në realizimin e mësimdhënies, kryesisht në mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e laboreve mësimore dhe shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) disponon katër godina mësimore – A, B, C dhe D – të pajisura me ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë teorike dhe praktike të programit të studimit Master i Shkencave në “Fizikë”. Sipërfaqja totale e këtyre godinave është 12,845.36 m², dhe përfshin: • Mjedise zyrash; • Salla leksionesh dhe seminari; • Salla laboratorike; • Sallat e leksioneve dhe seminareve zënë një sipërfaqe totale prej 2,571.5 m², të shpërndara si më poshtë: • Godina A: 11 salla me një sipërfaqe prej 731.52 m² • Godina B: 4 salla me 288.6 m² • Godina C: 6 salla me 371.8 m²

	• Godina D: 6 salla me 1,107.3 m² Këto ambiente ofrojnë një kapacitet nga 48 deri në 120 vende studentore dhe janë të pajisura me infrastrukturën përkatëse mësimore: dërrasa të zeza, tavolina, karrige dhe videoprojektorë. Sipërfaqja totale e ambienteve laboratorike është 3,475.5 m², të shpërndara në godinat A, B dhe C. Departamenti i Fizikës zotëron 16 laboratorë, të pozicionuar kryesisht në godinën B, nga të cilët 5 laboratorë janë të dedikuar për programin Master i Shkencave në "Fizikë". Kapaciteti i një laboratorit është rreth 15 poste studentore, dhe ambientet janë të pajisura me: Pajisje laboratorike specifike në funksion të lëndëve të programit; Infrastrukturë didaktike moderne dhe funksionale; Organizimi i mjediseve laboratorike është bërë në përputhje me: • Numrin e studentëve të regjistruar; • Ndarjen në grupe mësimore; • Kërkesat specifike të lëndëve praktike; Të gjitha grupet mësimore të programit janë në përputhje me kapacitetin e ambienteve ku zhvillojnë aktivitetin mësimor, duke garantuar standardin e nevojshëm për një proces cilësor të mësimdhënies. Evidenca: - <i>Infrastruktura Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN)</i> - <i>Orari mësimor, Master i Shkencave në Fizikë</i> - <i>Foto të laboratoreve që përdoren në programin Master i Shkencave në Fizikë.</i> - <i>Aneks Tabela 16. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive	Ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë funksionale dhe të pajisura me infrastrukturë moderne elektronike dhe teknologji informacioni, të cilat sigurojnë zhvillimin cilësor të procesit mësimor, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Mjetet audio-vizuale janë të instaluar në mënyrë të përhershme në një pjesë të auditoreve, kryesisht në sallat e leksioneve dhe laboratorët, duke mundësuar përdorimin efektiv të teknologjisë gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve praktike. Përveç këtyre, Departamenti i Fizikës disponon edhe një tabelë interaktive (smart board), e cila kontribuon në dinamizimin e orëve mësimore dhe në ndërveprimin me studentët.

bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Godinat e FSHN-së janë të pajisura me akses në rrjetin fiks të internetit, element kyç për zhvillimin e aktiviteteve didaktike që kërkojnë lidhje me platformat online apo përdorimin e burimeve digjitale. Edhe në sallat e seminareve, mjetet audio-vizuale që gjenden në dispozicion të departamentit mund të përdoren për prezantime, detyra praktike apo projekte kursi, duke e mbështetur mësimdhënien me mjete bashkëkohore. Evidenca: - <i>Projekt Buxheti Departamenti Fizikes 2021-2022</i> - <i>Buxheti FSHN 2021-2022.</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti Fizikes 2022-2023</i> - <i>Buxheti FSHN 2022-2023.</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti Fizikes 2023-2024</i> - <i>Buxheti FSHN 2023-2024.</i> - <i>Inventari i Laboratoreve që përdoren në programin master.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratorët që shfrytëzohen për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Fizikë” janë të pajisura me aparatura, mjete dhe instrumente të specializuara, të cilat sigurojnë realizimin e procesit mësimor në përputhje me përmbajtjen e lëndëve përkatëse. Në përputhje me mundësitë buxhetore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, janë kryer në mënyrë të vazhdueshme investime për përmirësimin dhe përditësimin e infrastrukturës laboratorike. Rinovimi i aparaturave dhe i mjeteve për punë të specializuara realizohet në mënyrë periodike, ndërkohë që janë ngritur edhe një sërë punësh të reja laboratorike. Këto zhvillime synojnë të mbështesin studentët në përvetësimin e njohurive teorike dhe në zhvillimin e aftësive praktike, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Evidenca: - <i>Inventar i laboratorit të Biofizikës, laboratorit karakterizimi i materialeve dhe laboratorit të trupit të ngurtë.</i> - <i>Laboratore mësimore program Master, Departamenti i Fizikës</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti i Fizikes 2021-2022</i>

	- <i>Projekt Buxheti Departamenti i Fizikes 2022-2023</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti I Fizikes 2023-2024</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës disponon gjithsej 12 laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisura me programe dhe softuerë profesionalë në përputhje me specifikat e programeve të studimit që ofron. Ndër to, Laboratori i Informatikës i dedikuar për programin e Fizikës, i pozicionuar në godinën B, Salla Nr. 413, përbëhet nga 20 kompjuterë (19 për studentët dhe 1 për lektorin), të pajisur me sisteme operative LINUX dhe WINDOWS. Laboratori mbështet zhvillimin e lëndëve si Programimi, Fizika Llogaritëse dhe të tjera përmes softuerëve të tillë si: C, C++, Octave/Matlab, Microsoft Office, etj. Çdo stacion pune ka akses të plotë në internet, duke mundësuar shfrytëzim optimal të burimeve dixhitale dhe konsultim të literaturës përkatëse. Ky laborator është ristrukturuar dhe rinovuar plotësisht në vitin 2024, dhe përdoret nga studentët jo vetëm gjatë orëve të mësimit, por edhe jashtë tyre për realizimin e detyrave të kursit, projekteve, ushtrimeve të pavarura apo studime të udhëhequra nga literatura e rekomanduar. Ndërkohë, laboratori i mëparshëm i programimit, i funksionalizuar në vitin 2019, është zhvendosur në Sallën Nr. 303B, dhe aktualisht shërben për nevojat e tjera mësimore të programeve të ndryshme të Departamentit të Fizikës. Në takimin me pedagogët u theksua që duhet të jetë më fleksibël mundësia për të blerë ose shtuar listën e blerjeve të reagentëve që përdoren në laboratore edhe gjatë vitit akademik, sepse nevojat për to janë të vazhdueshme dhe të paparashikueshme 100% që në fillim të vitit. Evidenca: - <i>Infrastruktura e FSHN</i> - <i>Inventar i laboratorit të programimit. (413B)</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti i Fizikes 2021</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti i Fizikes 2022</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti I Fizikes 2023</i> - <i>Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë Aneks Tabela 16</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në	Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizikë” përfshin në strukturën e tij akademike një komponent të konsiderueshëm praktik. Rreth 21.3% e totalit të orëve mësimore janë të

bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.	dedikuara për zhvillimin e seancave laboratorike, duke theksuar rëndësinë e aftësimit praktik përkrah formimit teorik. Për realizimin e këtyre veprimtarive, Departamenti i Fizikës disponon një infrastrukturë të përshtatshme me 16 laboratorë të specializuar, prej të cilëve 5 përdoren specifikisht në kuadër të këtij programi për lëndët: Biofizikë, Trupi i Ngurtë, Fizikë Llogaritëse, Fizikë Mjedisë dhe Karakterizimi i Materialeve. Përveç burimeve të brendshme, bashkëpunimet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës me institucione të arsimit të lartë dhe kompani partnere, krijojnë mundësi të zgjeruara për zhvillimin e praktikave profesionale, duke kontribuar në përgatitjen gjithëpërfshirëse të studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore bashkëkohore. Evidenca: - <i>Infrastruktura e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN)</i> - <i>Aneks Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikave profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.</i> - <i>Aneks Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës</i> - <i>Aneks Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësi Bazë</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Fizikës ka në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, sipas fushës së programit të studimit. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura e detyruar dhe ndihmëse e lëndëve të programit Master i shkencave në “Fizikë” ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip). Literatura është e përditësuar, e përshtatshme dhe e përdorur në nivel ndërkombëtar në programe të ngjashme. Kjo literaturë plotëson kriteret për përditësimin e saj dhe të gjitha kriteret për të dhënë njohuritë e nevojshme për ciklin e studimit. Literatura rishikohet çdo fillim viti akademik duke depozituar syllabuset e lëndëve përkatëse në departament. Evidenca: - Syllabuset e lëndëve (dosja programit të studimit).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Drejtuesit e departamentit dhe të grupeve mësimore raportojnë dhe konsultojnë në njësinë përkatëse përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit. Evidenca: - Revista periodike e “Buletinit të Shkencave të Natyrës”, ISSN 2305-882X - Të dhëna për platformat on line/Bibloteka. Aneks Tabela 17. - Syllabuset e lëndëve (dosja e programit të studimit)
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka ndodhet në godinën B të fakultetit dhe konsiderohet ndër më të mëdhatë dhe më të rëndësishmet në kuadër të Universitetit të Tiranës. Në kushte normale pune, biblioteka ofron shërbim në dy turne, në tre ambiente të dedikuara për studim dhe shërbim. Kjo organizim siguron akses të barabartë për të gjithë studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Fizikë”, duke mundësuar shfrytëzimin optimal të burimeve të saj akademike. Evidenca: - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021-2022. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2022-2023. - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë Aneks Tabela 16

	- <i>Rregullore e brendshme e bibliotekës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës disponon një fond të pasur dhe të larmishëm materialesh, përfshirë libra, monografi, revista dhe periodikë shkencorë, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj. Aktualisht, fondi përbëhet nga 36,520 njësi librash dhe monografish shkencore, nga të cilat 24,335 janë libra (719 në shqip dhe 23,616 në gjuhë të huaj). Gjithashtu, biblioteka ofron 24,441 njësi periodikësh dhe revistash shkencore, nga të cilat 64 janë në shqip dhe 24,377 në gjuhë të huaj. Në funksion të përmbushjes së nevojave akademike të studentëve dhe stafit pedagogjik sipas standardeve bashkëkohore, është planifikuar pasurimi i mëtejshëm i fondit me literaturë bazë dhe ndihmëse, si fjalorë, enciklopedi, manuale, tekste mësimore dhe botime të tjera shqiptare dhe të huaja. Për të mbështetur procesin mësimor në programin Master i Shkencave në “Fizikë”, pedagogët vendosin në dispozicion të studentëve materiale digjitale përmes platformës Microsoft Teams, duke garantuar akses të vazhdueshëm dhe të strukturuar në përmbajtje mësimore. Gjithashtu, Fakulteti boton dhe vë në dispozicion të komunitetit akademik revistën shkencore “Buletini i Shkencave të Natyrës”, e cila shërben si një hapësirë për publikime dhe diskutime shkencore. Evidenca: - <i>Rregullore e brendshme e bibliotekës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT</i> - <i>Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2023-2024.</i> - <i>Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021-2022.</i> - <i>Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2022-2023.</i> - <i>Revista periodike e “Buletinit të Shkencave të Natyrës”, ISSN 2305-882X</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	FSHN/UT ofron akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekën online. Studentët dhe personeli i UT kanë mundësi për akses pa pagesë në bibliotekën “online” ULIBRARY. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së kërkimit shkencor dhe mbështetjes akademike për studentët dhe stafin pedagogjik, Universiteti i Tiranës, në

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), ka finalizuar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR. Kjo platformë ofron akses në artikuj shkencorë dhe libra akademikë në 75 disiplina të ndryshme, duke përfshirë edhe fushat e shkencave natyrore. Gjithashtu, studentët e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Fizikë" kanë mundësi të përfitojnë nga aksesimi i burimeve digjitale të ofruara përmes Konsorciumit Ndërkombëtar EIFL, në të cilin Fakulteti i Shkencave Natyrore është i regjistruar. Burimet online të disponueshme janë: ASTM International – Compass Abstract; Edward Elgar – Journals; IOP Science; MPS Journals. Këto burime përfaqësojnë një mundësi të rëndësishme për zgjerimin e njohurive shkencore dhe ndihmojnë në zhvillimin e kërkimeve akademike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Evidenca: - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2023-2024. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021-2022. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2022-2023. - Rregullore e brendshme e bibliotekës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT - Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online Aneks Tabela 12
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Natyrore (FSHN) ofron për përdoruesit e saj kompjutera me akses në internet dhe në burimet online shkencore, të vendosur në dy fondet e hapura të saj. Këto pajisje janë në funksion të mbështetjes akademike dhe kërkimit shkencor për të gjithë studentët dhe stafin e fakultetit. Biblioteka e FSHN është gjithashtu anëtare e rrjetit të sistemeve bibliotekare COBISS.NET, i cili mundëson aksesin dhe kërkimin në katalogun e përbashkët të bibliotekave përmes platformës zyrtare: ☞ https://www.cobiss.net/al/ Kërkimi në katalog realizohet në adresën: https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search?q&db=cobib&mat Përveç burimeve të bibliotekës, Departamenti i Fizikës u ofron studentëve të Programit të Studimit "Master i Shkencave në Fizikë" edhe mundësinë për të përdorur kompjuterat e

	laboratorit të Programimit dhe Fizikës Llogaritëse. Këto kompjutera janë të pajisur me të gjitha programet kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e mësimi dhe kërkimit në fushën e fizikës. Këto struktura janë krijuar me synimin për të përmirësuar cilësinë e studimeve dhe për të garantuar akses të barabartë në teknologji dhe informacion për të gjithë studentët. Evidenca: - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021-2022. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2023-2024. - Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online Aneks Tabela 17
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në bibliotekë ofrohet shërbim me dy turne, në katër ambiente studimi e shërbimi. Në bibliotekë gjen akses në: Fondi i Hapur i Librit, Fondi i Hapur i Periodikut. Njekohesisht i është kushtuar rëndësi shtimit të burimeve online: 1. ASTM International, Compass abstract. 2. Edward Elgar Journals. 3. IOP Science. 4. MPS Journals. Evidenca: - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021-2022. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2022-2023. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2023-2024.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe	Në përputhje me nevojat dhe kërkesat e përdoruesve të bibliotekës – studentëve dhe stafit akademik – Fakulteti i Shkencave të Natyrës parashikon pasurimin e vazhdueshëm të fondit bibliotekar me literaturë cilësore, përfshirë tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj. Në funksion të përmirësimit të shërbimeve, është planifikuar gjithashtu pajisja e bibliotekës me kompjutera të rinj, me parametra të përmirësuar, si dhe krijimi i një ndërfaqeje elektronike në faqen zyrtare të fakultetit, për të pasqyruar fondin, infrastrukturën dhe aktivitetet e bibliotekës.

studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023, në kuadër të buxheteve vjetore të FSHN-së, në zërat financiarë të dedikuar për blerje libri, fond literature, abonime në biblioteka elektronike dhe revista periodike, janë alokuar fondet përkatëse për blerjen e literaturës bashkëkohore dhe të specializuar, në funksion të mbështetjes së programeve të studimit që ofron fakulteti. Evidenca: - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2021-2022. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2022-2023. - Raport vjetor i FSHN për vitin akademik 2023-2024. - Buxheti FSHN 2022 - Buxheti FSHN 2023 - Buxheti FSHN 2021			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies. Në përputhje me nevojat dhe kërkesat e përdoruesve të bibliotekës – studentëve dhe stafit akademik – Fakulteti i Shkencave të Natyrës parashikon pasurimin e vazhdueshëm të fondit bibliotekar me literaturë cilësore, përfshirë tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e	Fakulteti i Shkencave të Natyrës disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Nëpërmjet sistemit e- student studentët mund të logohen në sistem me anë të

tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	kredencialeve të e-albania-s. Studentët në sistem mund të realizojnë veprimet e mëposhtme: • Regjistrimin në provime • Kërkesat për përmirësim • Mundësinë për te parë të dhënat personale të tyre, listën e notave dhe historikun e regjistrimit në provime. • Realizimin e ankimimit të notave • Mundësinë për të parë të dhënat financiare dhe tarifat sipas programeve që kanë ndjekur dhe vitet akademike përkatëse. Administrimi dhe ruajtja e dokumentacionit mësimor si dhe e bazës së të dhënave të studentëve është i sanksionuar në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 dhe në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, konkretisht në nenet 42, 64 dhe 69. Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Natyrore mban dhe administron në formë të shkruar dokumentacionin si më poshtë: Regjistrat zyrtarë: • Regjistri themeltar i studentëve • Regjistri i rezultateve akademike të studentëve • Regjistri i lëshimit të diplomave Dokumentacioni i arkivuar për çdo student: • Dosjet e regjistrimit, të përgatitura sipas udhëzimeve të përvitshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MASR) • Procesverbalet e provimeve • Dosjet e transferimeve (prej dhe drejt programeve të tjera të studimit) • Dosjet e programeve/lëndëve të ekuivalentuara për studentët në transferim apo me degë të dytë studimi • Statistikat e studentëve frekuentues • Statistikat e studentëve që humbasin statusin e studentit • Statistikat e studentëve të ç'rregjistruar • Dosjet e diplomimit Kjo strukturë dokumentacioni garanton ruajtjen dhe gjurmueshmërinë e të dhënave akademike dhe administrative të
---	---

	studentëve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Të gjithë këto dokumenta mbahen në kasafortën e Sekretarisë mësimore dhe janë materiali origjinal, nga i cili lëshohen tërë vërtetimet e kërkuara nga studentët, administrata e UT dhe MASR. Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Shkencave të Natyrës i mundëson personelit akademik, personelit ndihmës-akademik dhe studentëve adresa zyrtare të email-it. Adresat zyrtare elektronike ofrohen në nivel fakulteti dhe nivel universiteti. Përkatësisht për stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët: emer.mbiemer@fshn.edu.al dhe emer.mbiemer@unitir.edu.al dhe emer.mbiemer@fshnstudent.info emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al Nëpërmjet adresave elektronike dhe platformës dixhitale, Departamenti i Fizikës u ofron studentëve informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm përmes këtyre burimeve/mënyrave: • Faqes elektronike zyrtare të institucionit për t'u informuar, përditësuar në lidhje me tarifat e studimit, vërtetim studentit, listë notash, çertifikatë notash, programi studimi shqip dhe anglisht etj. • Faqes elektronike të departamentit • Sistemit MS Teams të cilin e aksesojnë përmes llogarisë personale me të cilën pajisen në fillim të studimeve në UT dhe përmes të cilit informohen për kurrikulën e programit, rezultatet e provimeve etj. • Sekretarisë mësimore Gjithashtu, informacione të tjera shtesë që studenti mund të aksesojë përmes faqes zyrtare janë: • Njohja me fakultetin në tërësi (historikun, departamentet, programet e studimit, kriteret e pranimit, legjislacionin dhe rregulloret).
--	---

	• Projektet e përfunduara apo në zhvillim nga stafi akademik, doktoraturat e mbrojtura në secilin departament, aktivitetin shkencor të departamenteve në formën e publikimeve apo pjesëmarrjes në konferenca. • Specifika të vitit akademik (strukturën akademike, grupet mësimore, orarin mësimor, tarifat e studimit, formularin e vlerësimit të lëndës nga studenti) • Njoftime të ndryshme me tematikë administrative (afate regjistrimi në provime, bursat e studimit, etj.) apo akademike (thirrje të hapura për aplikim për bursa shkëmbimi në kuadër të programeve Erasmus+ etj.) Evidenca: - Rregullore për "Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës" - Fatura për shërbime. - Certificate notash - Liste notash - Program studimi shqip - Program studimi anglisht - Faqja web e FSHN - Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online Aneks Tabela 17 - Manual përdorimi Sistemi e – Student - Manual përdorimi e -Pedagogët
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në Universitetin e Tiranës dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit për personelin akademik dhe administrativ kryhet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arkivës në Rektorat, si dhe nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arkivës në nivel fakulteti. Dega e Burimeve Njerëzore në FSHN administron dosje të plota për çdo anëtar të personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik me kontratë, personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrativ. Këto dosje përmbajnë dokumentacionin e domosdoshëm, përfshirë diplomat dhe listat e notave të noterizuara, curriculum vitae, kontratat e punës, dokumentacionin e procedurave të punësimit, si dhe çdo

	dokument tjetër të rëndësishëm për angazhimin e tyre në Universitetin e Tiranës / Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Evidenca: - <i>Struktura organizative e UT.</i> - <i>Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN)</i> - <i>Procedure punesimi</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi elektronik i menaxhimit të informacionit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (e-Student) garanton një akses të dedikuar, të personalizuar dhe të sigurt për studentët, personelin akademik dhe ndihmës akademik, duke respektuar plotësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Akresi në sistem realizohet përmes llogarive personale të studentëve dhe stafit. Çdo anëtar i personelit akademik, ndihmës akademik dhe sekretaria mësimore disponon akses të kontrolluar në profilin përkatës në platformë. Sistemi përmban informacion të detajuar mbi: • programet dhe përmbajtjet lëndore, • kurset e regjistruara, • sezonet dhe oraret e provimeve, • listën e studentëve të regjistruar në secilën lëndë. Nëpërmjet këtij sistemi, personeli akademik ka mundësinë të aksesojë dhe plotësojë procesverbalet elektronike me rezultatet e studentëve, për çdo sezon provimesh. Për më tepër, përmes faqes zyrtare të FSHN, studentët mund të shkarkojnë në mënyrë të pavarur një sërë dokumentesh të nevojshme si: • faturat e tarifave të studimit, • vërtetimet e studentit, • listën dhe certifikatën e notave, • programet e studimit në gjuhën shqipe dhe angleze, etj. Evidenca: - <i>Rregullore për "Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Fatura për shërbime.</i> - <i>Certifikate notash</i> - <i>Liste notash</i>

	- Program studimi shqip - Program studimi anglisht - Faqja web e FSHN - Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online Aneks Tabela 17 - Manual përdorimi Sistemi e – Student - Manual përdorimi e -Pedagogët
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Përveç platformës e-Student dhe faciliteteve që ajo ofron, Universiteti i Tiranës / Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka vënë në funksionim edhe platformën Microsoft Teams. Kjo platformë digjitale shërben si një mjet efektiv për komunikimin ndërmjet studentëve dhe titullarëve të lëndëve, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit lidhur me seancat laboratorike, literaturën bazë, oraret e leksioneve, seminareve dhe provimeve, si dhe për çështje që lidhen me regjistrimet dhe notat. Përdorimi i MS Teams ofron forma të avancuara të komunikimit interaktiv dhe rrit ndjeshëm efikasitetin e bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, duke kontribuar në përmirësimin e përvojës së tyre mësimore. Evidenca: - Rregullore për “Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës” - Platforma Microsoft Teams - Manual përdorimi Sistemi e – Student - Manual përdorimi e - Pedagogët
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nëpërmjet sistemit të menaxhimit, llogarive personale emer.mbiemer@fshn.edu.al dhe emer.mbiemer@unitir.edu.al dhe emer.mbiemer@fshnstudent.info (emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al), platformës dixhitale MS Teams, faqeve zyrtare të IAL (www.unitir.edu.al dhe www.fshn.edu.al) garantohet në kohë reale aktiviteti akademik dhe administrativ i personelit akademik, ndihmës akademik, raportimet individuale, të dhënat mbi organet drejtuese etj. Evidenca: - Faqja online e UT - Faqja online e FSHN

	- <i>Rregullore për "Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Manual përdorimi Sistemi e – Student</i> - <i>Manual përdorimi e - Pedagogët</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të gjitha informacionet lidhur me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në faqet zyrtare elektronike të Universitetit të Tiranës (UT) dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), në gjuhën shqipe dhe angleze. Në faqen e fakultetit rifreskohen dhe publikohen vazhdimisht njoftimet dhe të dhënat për programet e studimit, aktivitetet akademike dhe jo-akademike, si dhe për personelin akademik. Këtu mund të gjenden planet mësimore të ofruara nga institucioni, informacion i detajuar për programin e studimit, stafin akademik, strukturën organizative të fakultetit, oraret e mësimet, datat e provimeve dhe diplomimeve, ofertat e punësimit, njoftimet për projekte të ndryshme për studentë dhe staf, aplikimet për bursa, aktivitetet shkencore akademike, si dhe udhëzues e manuale për studentët. Të gjitha këto informacione janë të disponueshme në dy gjuhë dhe respektojnë politikat institucionale të transparencës dhe të drejtës së informimit. Në faqen e Universitetit të Tiranës është krijuar një seksion i veçantë dedikuar Programit të Transparencës. Evidenca: - <i>Faqja online e UT</i> - <i>Faqja online e FSHN</i> - <i>Programi i Transparencës në UT</i>
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Të gjitha informacionet lidhur me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në faqet zyrtare elektronike të Universitetit të Tiranës (UT) dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), në gjuhën shqipe dhe angleze.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Universiteti i Tiranës (UT) publikon në mënyrë të rregullt të dhëna mbi buxhetin dhe aspekte të tjera financiare, duke synuar informimin dhe përfshirjen e palëve të interesuara. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) bën të disponueshme për publikun informacionin mbi buxhetin e Universitetit të Tiranës, përfshirë edhe detajet përkatëse që lidhen me mbështetjen e programeve të studimit, investimet në infrastrukturën laboratorike, dhe veprimtaritë akademike e shkencore. Procesi i përgatitjes së buxhetit zhvillohet nga njësitë bazë të universitetit, siç janë departamentet akademike. Në këtë kuadër, Departamenti i Fizikës harton çdo vit planin e tij buxhetor, duke mbështetur programet e studimit që ofron, si dhe nevojat për laboratorë, pajisje mësimore dhe kërkime shkencore. Tarifat për regjistrimin dhe shkollimin në programet e studimit të Universitetit të Tiranës përcaktohen çdo vit akademik nga Bordi i Administrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Evidenca: - Programi i transparencës në UT - Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2021 - Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2022 - Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2023 - Buxheti FSHN 2021 - Buxheti FSHN 2022 - Buxheti FSHN 2023 - Miratimi programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 Bordi admin UT - Bordi administrimit UT, Miratim buxheti 2023 - Bordi administrimit UT, Miratim buxheti 2024




Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Buxheti i Universitetit të Tiranës (UT) përgatitet dhe miratohet në përputhje me parimet e transparencës, planifikimit afatmesëm dhe eficiencës financiare. Në dokumentin buxhetor përcaktohen qartë komponentët kryesorë financiarë, të cilët përfshijnë: Pikat kryesore të buxhetit: • Detajimi i kuotave të buxhetit të konsoliduar, duke përfshirë: ✓ Grantin për mësimdhënie ✓ Të ardhurat e gjeneruara nga UT ✓ Detajimi i shpenzimeve operative ✓ Detajimi i fondeve të dedikuara për investime ✓ Numri i planifikuar i punonjësve (akademikë dhe ndihmësakademikë) Zërat specifikë të buxhetit përfshijnë: • Mbështetje për stafin akademik në: - Pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit - Rimbursim të publikimeve shkencore në revista me faktor ndikimi • Shpenzime operative për mirëmbajtjen e: - Mjediseve mësimore dhe administrative - Teknologjive dhe pajisjeve mbështetëse (laboratorë, kompjutera, rrjet kompjuterik etj.) • Financim për bibliotekën, përfshirë: - Pasurimin e literaturës mësimore dhe shkencore - Aksesin në bibliotekat elektronike dhe bazat e të dhënave akademike Për secilin prej zërave të mësipërm, në dokumentacionin përkatës përcaktohen gjithashtu burimet e financimit, duke identifikuar fonde të brendshme, të jashtme apo të kombinuara (grantet qeveritare, donatorë, të ardhura nga veprimtaria akademike etj.). Evidenca: - Buxheti FSHN 2021
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave janë auditueshëm gjatë viteve nga Auditi i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në kuadër të strukturës organizative të Universitetit të Tiranës funksionon Drejtoria e Auditit të Brendshëm, e cila përfshin Sektorin e Auditit të Brendshëm dhe Sektorin e Auditimit të Performancës. UT kryen auditime vjetore, duke vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efikasitetin financiar të tij. Raportet

	financiare, të paraqitura në kuadër të programit të transparencës, pasqyrojnë performancën financiare të Universitetit, përfshirë tabelat e të ardhurave, ndarjen e burimeve financiare dhe realizimin e shpenzimeve. Evidenca: - <i>Struktura organizative e UT.</i> - <i>Tabela raport monitorimi buxheti 2022</i> - <i>Raport vjetor për zbatimin e buxhetit 2022</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas kërkesave ligjore, dokumentacioni lidhur me buxhetin e Universitetit të Tiranës dhe raportet mbi aktivitetin financiar të institucionit ruhen në arkiva. Duke qenë se hartimi i buxhetit nis nga njësitë bazë, në të përfshihen edhe ndërhyrje të posaçme që synojnë mbështetjen e ecursisë dhe zhvillimit të programeve të studimit. Po ashtu, në buxhetet afatmesme parashikohen masa të veçanta për të siguruar funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve akademike. Evidenca: - <i>Vendim i Senatit Akademik të UT Nr. 50, datë 14.10.2022 "Për miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2021</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2022</i> - <i>Projekt Buxheti Departamenti I Fizikës 2023</i> - <i>Buxheti FSHN 2021</i> - <i>Buxheti FSHN 2022</i> - <i>Buxheti FSHN 2023-2024</i> - <i>Lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve të Universitetit të Tiranës.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon	Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës miraton buxhetin përfundimtar, duke u bazuar në kërkesat buxhetore të fakulteteve, të cilat reflektojnë nevojat e strukturave të ndryshme të universitetit për të arritur objektivat dhe për të realizuar misionin institucional. Universiteti i Tiranës siguron qëndrueshmëri financiare përmes burimeve të ndryshme, si: • granti i dhënë nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, • të ardhurat nga tarifat e regjistrimit dhe shkollimit, • të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni.

ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	UT disponon kapacitete financiare të mjaftueshme për të përmirësuar situatën financiare dhe për të rritur të ardhurat në të ardhmen. Evidenca: - Vendim i Bordit të administrimit të UT "Për miratimin e buxhetit 2023 dhe 2024 për Universitetin e Tiranës" - Buxheti FSHN 2021 - Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2021 - Buxheti FSHN 2022 - Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2022 - Buxheti FSHN 2023 - Projekt Buxheti Departamenti i Fizikës 2023			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë" dhe mbështetjen e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, Universiteti i Tiranës harton dhe zbaton politika dhe procedura që rregullojnë veprimtarinë institucionale dhe akademike për ciklin e dytë të studimeve, konkretisht programin Master i Shkencave në “Fizikë”, të ofruar nga Departamenti i Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. • Karakteristikat kryesore të programit: Kohëzgjatja standarde: 2 vite akademike (4 semestra) Totali i krediteve: 120 kredite europiane (ECTS) Diplomimi: Pas përfundimit me sukses të të gjitha detyrimeve akademike dhe mbrojtjes së punimit të diplomës, i cili ka një peshë prej 30 kreditesh ECTS • Pranimi në program: Kuotat, kriteret e pranimit dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve propozohen nga Departamenti i Fizikës, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë Procesi i pranimit zhvillohet mbi bazën e akteve ligjore dhe nënligjore, duke synuar përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar në aspektin akademik • Monitorimi i procesit mësimor: Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës, zbaton politika dhe procedura të dedikuara për monitorimin e ecurisë së studentëve, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe mbështetjen e suksesit akademik gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu I, neni 5, fq. 3; kreu VII, neni 88, 91 & 92, fq. 56-58; fq.55; kreu IX, neni 123-137, fq.69-7 - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023: Mësimdhënia dhe studimet, fq.6-9. - Rregullore e UT, pjesa e tretë: “Organizimi, struktura, elementët e studimeve” fq.21-43 - Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Fizikë” - Aneks Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizikë” është hartuar dhe zbatohet në përputhje me parimet e lirisë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe studentëve, bazuar në legjislacionin në fuqi. Veprimtaria e Universitetit të Tiranës dhe strukturave të tij udhëhiqet, ndër të tjera, nga parimet e kolegjalitetit, transparencës dhe meritokracisë. Ky program





studentë dhe studentët e programit të studimit.	garanton trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët që aplikojnë në Universitetin e Tiranës, si dhe për studentët e tij. Kuotat, kriteret e pranimi dhe procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për programin Master i Shkencave në “Fizikë” propozohen nga Departamenti i Fizikës në Universitetin e Tiranës. Çdo njësi bazë, në rastin konkret Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka detyrimin të publikojë këto kriteret, të cilat mbeten të pandryshuara deri në përfundim të procesit të pranimeve për vitin akademik përkatës. Evidenca: - Statuti i UT, kreu I, neni 6, fq.4; kreu VII, neni 94, fq 58-59 - Kriteret e pranimi në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2022-2023 - Kuotat e pranimi për ciklin e dytë, 2022-2023 - Kuotat e pranimi për ciklin e dytë, 2023-2024
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Përzgjedhja e kandidatëve për regjistrim në programin e studimit Master i Shkencave në “Fizikë” bëhet nëpërmjet aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Departamenti i Fizikës dhe brenda afateve të caktuara, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Për të ndjekur këtë program të ciklit të dytë të studimeve, aplikanti duhet të zotërojë një diplomë të ciklit të parë (“Bachelor”) dhe të plotësojë kriteret shtesë të pranimi, të cilat janë miratuar nga Departamenti i Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), Universiteti i Tiranës. Çdo departament i Universitetit të Tiranës, përfshirë Departamentin e Fizikës, ka për detyrë të propozojë kuotat e pranimi dhe kriteret e pranimi dhe përzgjedhjes së aplikantëve jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë. Për vitin akademik 2022–2023, kriteret e pranimi për programin Master i Shkencave në “Fizikë” janë si më poshtë: • Kandidatët duhet të jenë diplomuar në një nga programet e mëposhtme të ciklit të parë të studimeve (“Bachelor”), të ofruara nga universitete të njohura kombëtare apo ndërkombëtare: Fizikë, Fizikë-Matematikë, Matematikë

	Inxhinierike, Fizikë Inxhinierike, Kimi, Biologji, Kimi Industriale dhe Mjedisore, Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Bioteknologji. - Pranimi i kandidatëve bëhet në bazë të renditjes sipas notës mesatare, brenda kuotave të miratuara të pranimi. Për kandidatët që vijnë nga programi “Fizikë” i FSHN, nota mesatare e tre viteve të studimit “Bachelor” shumëzohet me koeficientin 1.3. Këto kritere pranimi publikohen nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës jo më vonë se data 20 dhjetor e dy viteve paraardhës kalendarikë dhe i përcillen Rektoratit të Universitetit të Tiranës, i cili i dorëzon ato Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Senati Akademik i Universitetit të Tiranës miraton brenda datës 20 dhjetor të çdo viti kuotat e pranimi për secilin fakultet. Lista përfundimtare e kandidatëve fitues për programin Master i Shkencave në “Fizikë” shpallet nga Universiteti i Tiranës, në përputhje me udhëzimet përkatëse të MAS (p.sh. Udhëzimi nr. 10), dhe kandidatët janë të detyruar të ndjekin procedurat e regjistrimit të përcaktuara. Numri i pranimeve bazohet në kapacitetet reale të njësive akademike për të garantuar zhvillimin normal të procesit mësimor, në përputhje me standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet rregullative të brendshme të Universitetit të Tiranës. Këto të dhëna publikohen në mënyrë transparente dhe janë të qarta për publikun e interesuar. Evidenca: - Statuti i UT, kreu VII, neni 94, fq.58-59 - Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 75-76, “Programet e ciklit të dytë të studimeve” dhe “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve” - Kriteret e pranimi në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2022-2023 - Kuotat e pranimi për ciklin e dytë, 2022-2023 - Kuotat e pranimi për ciklin e dytë, 2023-2024 - Urdhër i përbashkët i Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqipëtar me MAS, nr. 10, datë 10.07.2023 “Për
--	---

	<i>miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet E Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024"</i> - <i>Udhëzimi i MAS, nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë": "Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve"</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Objektivi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë" është përgatitja e thelluar akademike dhe shkencore e studentëve në disiplina të ndryshme të fizikës, përfshirë fizikën teorike, fizikën e aplikuar dhe fizikën llogaritëse. Ky formim synon të përmbushë nevojat e tregut të punës, si dhe të krijojë një bazë të fortë për vijimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve (Doktoraturë). Në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës, kriteret dhe procedurat për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për këtë program, si dhe për transferimin e studentëve që kanë përfunduar të paktën një vit akademik në programe të të njëjtit cikël, në institucione të tjera të arsimit të lartë kombëtare apo ndërkombëtare, propozohen nga Departamenti i Fizikës, njësi akademike përgjegjëse për ofrimin e programit. Po ashtu, procedurat për vlerësimin, përparimin dhe diplomimin e studentëve përcaktohen në Rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e programit të studimit. Këto dokumente janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe transparente, duke garantuar akses të plotë dhe të lehtë për publikun e interesuar. Kriteret e pranimiit, si dhe plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë", bëhen të ditura për të gjithë kandidatët potencialë përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit dhe informimit institucional, përfshirë publikimin në faqen zyrtare të internetit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe të Departamentit të Fizikës. Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu VII, neni 94, fq. 58-59 dhe neni 109, fq.64</i> - <i>Rregullore e UT, pjesa e tretë: "Organizimi, struktura, elementët e studimeve", neni 45-73 fq.26-36</i> - <i>Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave Shkencore "Fizikë", kreu III, neni 11-17, fq.7-11</i>

	- <i>Aneks Tabela 10 Plani mësimor</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti i Tiranës (UT) dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ndërmarrin veprimtari të strukturuar informuese për studentët e ciklit të parë të studimeve (Bachelor), me qëllim njohjen e tyre me programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave”. Ky informim përfshin publikimin e materialeve dhe broshurave elektronike informuese, të cilat synojnë të sqarojnë aspektet themelore të programeve të studimit, organizimin e brendshëm të institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentëve, si dhe jetën studentore në përgjithësi. Informacioni për programet e ciklit të dytë është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës https://unitir.edu.al/cikli-i-ii-master-i-shkencave/. Në mënyrë të veçantë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Fizikës zhvillojnë aktivitete specifike informuese mbi programin Master i Shkencave në “Fizikë”. Të gjitha të dhënat përkatëse janë të publikuara dhe të përditësuara në faqet zyrtare të internetit të Departamentit të Fizikës: https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-fizikes https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-fizikes/programmes/fizike-msc Gjithashtu, UT, FSHN dhe Departamenti i Fizikës sigurojnë informimin transparent të publikut mbi kriteret specifike të pranimit për kandidatët që i përkasin grupeve me aftësi të kufizuara, pakicave kombëtare apo shtresave të marginalizuara, në përputhje me politikat për barazi dhe gjithëpërfshirje. Informimi bëhet në rrugë zyrtare përmes platformave elektronike zyrtare të institucionit dhe materialeve të shpërndara në formë broshurash elektronike. Në fillim të çdo viti akademik, studentët e regjistruar në vitin e parë të programit Master i Shkencave në “Fizikë” prezantohen me përgjegjësin e Departamentit të Fizikës, pedagogun kujdestar akademik të vitit përkatës si dhe stafin pedagogjik të departamentit. Gjatë këtij takimi orientues, studentët njihen me strukturën dhe kërkesat e programit të studimit dhe udhëzohen për përdorimin e burimeve të informacionit, mjeteve të komunikimit institucional dhe procedurave akademike të brendshme. Evidenca: - <i>Statuti i UT, kreu VII, neni 106, fq.63</i> - <i>Faqja web e UT</i>




	- <i>Faqja web e Departamentit të Fizikës</i> - <i>Faqja web e Departamentit të Fizikës / Master i Shkencave në Fizikë</i> - <i>Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2022-2023</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet shtetërore të cilësisë, çdo departament i Universitetit të Tiranës propozon kuotat e pranimi, kriteret e pranimi dhe të përzgjedhjes së aplikantëve për të gjitha programet e studimit që ofron. Këto propozime duhet të dorëzohen jo më vonë se data 10 Dhjetor të vitit paraardhës kalendarik. Për programin e studimit Master i Shkencave në “Fizikë”, përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazën e notës mesatare të përfundimit të studimeve Bachelor, duke i renditur kandidatët në mënyrë zbritëse brenda kuotave të miratuara. Në rastin e aplikantëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në degën “Fizikë” në FSHN, si vlerë mesatare merret mesatarja e tre viteve të programit “Bachelor”, e shumëzuar me koeficientin 1.3, për të garantuar vlerësim të drejtë dhe të diferencuar të arritjeve akademike. Kriteret për pranimin në këtë program miratohen dhe shpallen nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës jo më vonë se data 20 Dhjetor, dy vite përpara vitit akademik përkatës, dhe i përcillen Rektoratit të UT-së, i cili ka për detyrë t’i dërgojë ato pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Brenda datës 20 Dhjetor të çdo viti, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës miraton përfundimisht kuotat e pranimi për çdo fakultet. Kuotat e miratuara përfshijnë gjithashtu një numër të përcaktuar vendesh për studentë nga vende të tjera si dhe për shtetas të huaj. Lista përfundimtare e kandidatëve fitues për programin e studimit Master i Shkencave në “Fizikë” publikohet nga Universiteti i Tiranës, në përputhje me procedurat zyrtare të regjistrimit të parashikuara në Udhëzimin Nr. 10 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat dokumentohen në evidencat përkatëse të administruara nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Fizikës. Evidenca: - <i>Statuti i UT, kreu VII, neni 94, fq.58-59</i> - <i>Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e</i>

	<i>Shqipërisë”, neni 75-76, “Programet e ciklit të dytë të studimeve” dhe “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”</i> - <i>Kriteret e pranimi në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2022-2023</i> - <i>Kuotat e pranimi për ciklin e dytë, 2022-2023</i> - <i>Kuotat e pranimi për ciklin e dytë, 2023-2024</i> - <i>Urdhër i përbashkët i Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqipëtar me MAS, nr. 10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet E Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024”</i> - <i>Udhëzimi i MAS, nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”: “Pranimet në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), ka hartuar dhe zbaton politika të qarta dhe të strukturuar të ndihmës financiare dhe dhënies së bursave për studentët që plotësojnë kriteret të caktuara sociale, ekonomike apo akademike. Përfituesit e këtyre politikave janë studentët që: • Vijnë nga familje me të ardhura të ulëta; • Kanë aftësi të veçanta; • I përkasin shtresave të marginalizuara të shoqërisë; • Shfaqin rezultate të larta akademike, konkretisht me mesatare të ponderuar në intervalin 9.00 – 10.00. Forma e mbështetjes përfshin reduktimin deri në 50% të tarifës vjetore të shkollimit apo përjashtimin e plotë nga tarifa, në varësi të kategorisë përkatëse të studentit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë strukturave përkatëse të UT-së. Për vitin akademik 2023–2024, nga Fondi i Bursave të Universitetit të Tiranës: • 197 studentë të FSHN-së kanë përfituar bursë ekonomike, nga të cilët 2 studentë janë nga Departamenti i Fizikës. Kriteret për përfitimin e bursës kanë përfshirë: përfitimi nga ndihma ekonomike shtetërore, prindër ose vetë studentë me aftësi të veçanta, si dhe studentë me prindër pensionistë ose që nuk janë në jetë. • 30 studentë të ciklit të dytë të studimeve (Master), të cilët kanë arritur një mesatare të ponderuar 9–10, kanë

	përfitur reduktim 50% të tarifës së shkollimit. Nga këta, 1 student i përket Departamentit të Fizikës. 90 studentë janë përjashtuar plotësisht nga tarifa e shkollimit për shkak të kushteve të veçanta sociale ose ekonomike. Këtu përfshihen studentë me aftësi të veçanta, në gjendje të vështirë ekonomike apo që i përkasin grupeve të marginalizuara. 1 student përfutet i kësaj kategorie është nga Departamenti i Fizikës. Qëllimi parësor i këtyre politikave është nxitja e aksesit në arsimin e lartë, rritja e barazisë dhe përfshirjes sociale, si dhe përmirësimi i cilësisë së pranimeve në programet me përparësi për institucionin dhe në përputhje me objektivat kombëtare të zhvillimit. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu IX, neni 125, fq.69-70 - Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kreu XI, neni 112 - Listat emërore të studentëve që përfitojnë bursë, përjashtim ose reduktim nga tarifa e shkollimit 2023-2024 - VKM Nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë” - VKM Nr.780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”			
Konkluzione	Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), ka hartuar dhe zbaton politika të qarta dhe të strukturuar të ndihmës financiare dhe dhënies së bursave për studentët që plotësojnë kriteret të caktuara sociale, ekonomike apo akademike. Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamentit të Fizikës, siguron informimin e vazhdueshëm të studentëve mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik, kalimin nga një vit akademik në tjetrin, detyrimet akademike dhe elementë të tjerë që lidhen me ecurinë e tyre studimore. Procedurat që rregullojnë përparimin akademik të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë, e cila publikohet në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (https://fshn.edu.al). Ky dokument dhe informacioni përkatës online i mundëson studentit të njihet në mënyrë të detajuar me: • Planin mësimor të të dy viteve të programit të studimit; • Kërkesat akademike për çdo lëndë dhe mënyrat e vlerësimit përkatës (syllabuset); • Sistemin e vlerësimit me notë, sipas pikëve të përftuara; • Kalendarin e provimeve dhe riprovimeve, së bashku me kriteret për pjesëmarrje në to; • Detyrimet akademike për përfitimin e diplomës dhe numrin e krediteve të nevojshme për të kaluar nga një vit në tjetrin; • Kushtet për diplomim dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Për të lehtësuar procesin e informimit dhe orientimit, FSHN vë në dispozicion të studentëve gjithashtu Guidën e Fakultetit, e cila përmban informacion të përmbledhur mbi organizimin e studimeve, strukturën institucionale, të drejtat dhe detyrimet e studentit, si dhe mundësitë e përfshirjes në jetën akademike dhe kërkimore. Në fillim të çdo viti akademik, gjatë "Javës së Orientimit", organizohen sesione informuese për studentët e rinj të

	regjistruar në programin Master i Shkencave në “Fizikë”. Këto sesione synojnë të prezantojnë studentët me: • Strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit; • Rregullat dhe procedurat për frekuentimin, vlerësimin dhe diplomimin; • Të drejtat dhe detyrimet akademike e administrative; • Burimet mbështetëse dhe informacionet praktike që lidhen me jetën studentore. Ky angazhim synon të garantojë transparencë, orientim të qartë dhe mbështetje të vazhdueshme për të gjithë studentët gjatë rrugëtimit të tyre akademik. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu IX, neni 123-137, fq.69-72 - Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Fizikë” - Faqja web e UT - Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2022-2023 - Aneks Tabela 10 Plani mësimor
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Departamenti i Fizikës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), garanton informimin e plotë dhe të vazhdueshëm të studentëve lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në “Fizikë”, përfshirë: • Përmbajtjen dhe organizimin akademik të programit; • Kohëzgjatjen e studimeve dhe afatin e përfundimit të tyre; • Kalendarin akademik, duke përfshirë fillimin dhe përfundimin e vitit akademik; • Sezonet e provimeve dhe periudhat përkatëse; • Kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesshme, të realizuara në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit. Procesi i njohjes së kualifikimeve apo krediteve të mëparshme akademike kryhet përmes komisioneve të specializuara të ekuivalentimit të lëndëve, bazuar në dispozitat e përcaktuara në

	Statutin e Universitetit të Tiranës, si dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë. Procedurat që lidhen me transferimin e studimeve apo ndjekjen e një programi të dytë studimi rregullohen nga nenet përkatëse të Statutit të UT dhe nga udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS). Periudhat për regjistrim dhe aplikim për këto procese përcaktohen me akt zyrtar të MAS dhe publikohen përpara fillimit të vitit akademik. Këto informacione janë të aksesueshme për studentët nëpërmjet faqes zyrtare të FSHN-së dhe Departamentit të Fizikës, si dhe nëpërmjet materialeve informuese të shpërndara në mënyrë elektronike apo fizike, sipas rasteve. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës kreu VII, neni 108 & 109, fq.64 - Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Fizikë" - Faqja web e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë" informohen në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë akademike dhe për komponentët e vlerësimit të secilës lëndë përmes: • Pedagogut përgjegjës të lëndës; • Syllabuseve zyrtare të lëndëve; • Sekretarisë mësimore dhe asaj të departamentit; • Faqes zyrtare të Departamentit të Fizikës dhe FSHN-së. Informacioni i ofruar përfshin vlerësimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, si: rezultatet e provimeve të ndërmjetme, aktivizimi në seminare, detyrat e kursit, frekuentimi i orëve mësimore dhe vlerësimi final. Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet me sistem pikësh, nëpërmjet një kombinimi të elementëve të mëposhtëm: • Frekuentimi dhe angazhimi aktiv në mësim; • Provime me shkrim; • Ese apo detyra kursi; • Testime të ndërmjetme. Të gjitha komponentët e vlerësimit zhvillohen brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik, të miratuar dhe publikuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i

	Fizikës, dhe janë të detyrueshme për zbatim si nga ana e stafit akademik ashtu edhe nga studentët. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe ç'sekretimit të provimeve, studenti ka të drejtë: • Të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit; • Të informohet për pikët e marra në çdo komponent vlerësimi, përfshirë pikët për çdo rubrikë vlerësimi në tezë; • Të ankimojë rezultatin brenda një afati 48 orësh nga momenti i njohjes zyrtare me rezultatin përfundimtar. Këto procedura synojnë transparencë të plotë, vlerësim objektiv dhe respektim të të drejtave të studentit gjatë gjithë procesit mësimor dhe vlerësues. Evidenca: - <i>Model Syllabus në programin Master i Shkencave</i> - <i>Struktura Akademike e FSHN, UT, viti aktual</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti i Fizikës siguron informimin e plotë të studentëve në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit, të cilat janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Tiranës si dhe në Rregulloren e programit të studimeve të ciklit të dytë – Master i Shkencave në Fizikë. Ky informacion u bëhet i ditur studentëve në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme përmes: • Pedagogëve kujdestarë akademikë • Sekretarisë së Departamentit të Fizikës • Sekretarisë Mësimore të Fakultetit Qëllimi i këtij komunikimi është të garantohet që çdo student të jetë i njohur me të gjitha detyrimet akademike dhe administrative që lidhen me përfundimin dhe diplomimin në këtë program studimi. Evidenca: - <i>Statuti I UT, kreu VII, neni 110-113, fq.64-66</i> - <i>Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Fizikë"</i> - <i>Lista e kujdestarëve për studentët e çdo viti të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në	Përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti i Tiranës (UT), përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe

mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Departamenti të Fizikës (DF), organizon aktivitete informuese për studentët e ciklit të parë (Bachelor) në lidhje me programet e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave". Në kuadër të këtij angazhimi, vihen në dispozicion materiale dhe broshura informuese në format elektronik me qëllim njohjen e studentëve me përmbajtjen, strukturën dhe mundësitë që ofrojnë këto programe. Pedagogët e FSHN dhe të DF zhvillojnë takime me studentët e interesuar për të vazhduar studimet në programet e ciklit të dytë, gjatë të cilave ofrojnë informacion të detajuar mbi natyrën e programeve Master, kërkesat akademike, si dhe mundësitë e zhvillimit profesional dhe punësimit pas diplomimit. Në këto takime shpërndahen gjithashtu guidat e fakultetit dhe materialet përkatëse, të cilat janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të fakultetit dhe departamentit. Një komponent i rëndësishëm në këtë proces është Dega e Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, e cila ofron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët. Kjo degë organizon takime të rregullta dhe ofron asistencë për çështje që lidhen me: • Njohjen me strukturën dhe funksionimin e fakultetit; • Leksione të hapura dhe takime me karakter orientues; • Mundësi për përfshirje në internship-e dhe trajnime shtesë; • Promovimin e kurseve mbështetëse dhe aktiviteteve profesionale. Gjithashtu, kjo zyrë luan rolin e një ure lidhëse ndërmjet studentëve, fakultetit dhe tregut të punës, duke ndihmuar në orientimin profesional të tyre dhe lehtësimin e integritimit të diplomantëve në tregun e punës pas përfundimit të studimeve. Evidenca: - Faqja web e UT - Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2022-2023 - Faqja web e Degës së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN - Faqja web "Këshillim Karriere" - Faqja web "Leksioni hapur me temë "Këshillimi i Karrierës"
Konkluzione	Fakultetit i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Fizikës (DF), organizon aktivitete informuese për studentët e ciklit të parë (Bachelor) në lidhje me programet e studimit të



	ciklit të dytë "Master i Shkencave". Ai vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizikë" në Universitetin e Tiranës (UT), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Fizikës kanë të drejtën të informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë mbi: • Strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit; • Kohëzgjatjen e programit dhe afatin e përfundimit të tij; • Lëndët dhe modulet e parashikuara në planin mësimor; • Kreditet përkatëse dhe ngarkesën mësimore; • Syllabuset e çdo lënde, përfshirë objektivat, përmbajtjen, metodat e vlerësimit dhe detyrimet semestrale apo vjetore. Këto të dhëna janë të dokumentuara në planin mësimor dhe në vendimet përkatëse të Departamentit të Fizikës, FSHN-së dhe Senatit Akademik të UT-së. Të gjitha informacionet janë të publikuara dhe të aksesueshme nga studentët përmes faqes zyrtare të FSHN dhe Departamentit të Fizikës: https://fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-fizikes/ Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik dhe semestri, pedagogët e Departamentit të Fizikës ofrojnë informacion të detajuar mbi lëndët që do të zhvillohen, përkatësisht: • Numrin e krediteve për secilën lëndë/modul; • Syllabuset përkatëse; • Orët mësimore në auditor;

	• Rregullat e frekuentimit dhe pjesëmarrjes; • Format dhe periudhat e vlerësimit. Syllabuset, të cilat janë të publikuara në faqen e departamentit, shërbejnë si udhëzues zyrtarë për studentët, duke i orientuar mbi objektivat, temat, detyrat dhe vlerësimet për secilën lëndë. Në vijim të ndikimeve të pandemisë COVID-19, gjatë viteve akademike 2019–2021, dhe për të ruajtur standardet e transparencës dhe aksesit, informacioni mbi programin dhe materialet mësimore janë shpërndarë dhe vijnë të jenë të aksesueshme përmes platformës Microsoft Teams, edhe gjatë viteve akademike 2021–2024, pavarësisht rikthimit të mësimin në auditor. Për më tepër, studentët mbështeten nga: • Sekretaria mësimore e FSHN për çështje administrative dhe akademike; • Dega e Teknologjisë së Informacionit (IT) për asistencë teknike dhe përdorimin e platformave digjitale; • Pedagogu kujdestar akademik, i cili mban kontakte të rregullta me studentët e kursit përkatës dhe u ofron mbështetje për çdo paqartësi apo nevojë orientuese gjatë gjithë ciklit të studimeve. Evidenca: - <i>Model Syllabus në programin Master i Shkencave</i> - <i>Manual përdorimi e-student</i> - <i>Manual përdorimi e-pedago</i> - <i>Faqja web e Departamentit të Fizikës</i> - <i>Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2022-2023</i> - <i>Shërbime Online Universiteti i Tiranës</i> - <i>Aneks Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</i> - <i>Aneks Tabela 10 Plani mësimor</i> - <i>Aneks Tabela 14 Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), në kuadër të Universitetit të Tiranës, mbështet veprimtarinë akademike dhe orientimin profesional të studentëve përmes strukturave të specializuara, siç është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Kjo degë ka një rol të rëndësishëm në:

	• Informimin dhe këshillimin e studentëve; • Koordinimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të ndërlidhura; • Mbështetjen institucionale në drejtim të orientimit profesional dhe integritit në tregun e punës. DSBCK publikon rregullisht informacione mbi aktivitete akademike dhe jashtëakademike, mundësi internship-i, punësimi, trajnime, workshop-e dhe evente të tjera që lidhen me zhvillimin profesional të studentëve. Ky informacion është i aksesueshëm në faqen zyrtare të DSBCK: https://fshn.edu.al/info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres Punësimi i të diplomuarve në Departamentin e Fizikës Të diplomuarit në Departamentin e Fizikës, FSHN, UT, janë integruar me sukses në tregun e punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, ata janë punësuar në: • Departamentin e Fizikës, UT; • Departamente të universiteteve të tjera publike si: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Fan Noli”, Korçë, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe në universitete jopublike; • Institucione kërkimore dhe laboratorë shkencorë si Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit; • Qendra spitalore publike dhe jopublike, përfshirë Spitalin Universitar “Nënë Tereza” (QSUT); • Arsimin parauniversitar, ku një numër i konsiderueshëm janë të punësuar si mësues të lëndës së Fizikës në shkolla të mesme. Ecuria akademike dhe përparimi në ciklet e mëtejshme të studimit Sipas studimit të tregut të vitit 2018, rreth 95% e studentëve të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve në FSHN janë studentë që vijnë nga programet e ciklit të parë të studimeve të ofruara nga vetë fakulteti. Pas përfundimit të programit Master i Shkencave në “Fizikë”, shumica e studentëve vijnë më tej në ciklin e tretë të studimeve (Doktoraturë), si në Departamentin e Fizikës të UT, ashtu edhe në universitete të huaja. Tendencat e punësimit sipas sektorëve
--	---

	Sipas të dhënave të studimit të tregut të punës për periudhën 2018–2021, studentët e diplomuar në FSHN kanë një përqindje të lartë punësimi në sektorin privat (54%), ndërkohë që 20% e tyre janë të punësuar në sektorin publik. Evidenca: - Faqja web e Departamentit të Fizikës - Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2022-2023 - Faqja web e Degës së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN - Faqja web “Këshillim Karriere” - Faqja web “Leksioni hapur me temë “Këshillimi i Karrierës” - Raporti i studimit të tregut të punës në UT, fq.61-66 & 144-162
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të çdo viti akademik, studentët e programit Master i Shkencave në “Fizikë”, pranë Departamentit të Fizikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), Universiteti i Tiranës, pajisen me informacion të detajuar në lidhje me: • Institucionin dhe programet e studimit që ofrohen; • Statusin e akreditimit të programit dhe të institucionit; • Vlefshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare të diplomës së lëshuar; • Infrastrukturen akademike dhe shërbimet mbështetëse që sigurojnë realizimin efektiv të procesit mësimor. • Ky informacion bëhet i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme përmes kanaleve zyrtare të komunikimit si: Faqja zyrtare e FSHN dhe UT Adresat zyrtare të e-mail-it institucional. • Nëpërmjet këtyre burimeve, studentët informohen rregullisht mbi: • Orarin e zhvillimit të mësimi; • Vendndodhjen e sallave të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve; • Aktivitete akademike dhe shkencore si: konferenca, workshop-e, trajnime dhe aktivitete të tjera të lidhura me programin e studimit dhe zhvillimin profesional. Gjithashtu, pedagogët e përfshirë në programin Master i Shkencave në “Fizikë”, në fillim të çdo semestri prezantojnë:

	• Përmbytjen e lëndëve dhe organizimin e tyre; • Laboratorët përkatës dhe mënyrën e zhvillimit të tyre; • Infrastrukturen në dispozicion të procesit mësimor; • Mënyrën e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet semestrale përkatëse. Këto veprime sigurojnë një proces të mirëstrukturuar informimi dhe orientimi akademik, në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe dispozitat ligjore për arsimin e lartë. Evidenca: - <i>Manual përdorimi e-student</i> - <i>Manual përdorimi e-pedagog</i> - <i>Faqja web e UT</i> - <i>Faqja web e Fakultetit të Shkencave të Natyrës</i> - <i>Akreditimi periodik i UT</i> - <i>Shërbime Online Universiteti i Tiranës</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentët e programit të studimit <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i> pranë Departamentit të Fizikës, FSHN, Universiteti i Tiranës, informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi përmbytjen, strukturën dhe organizimin e programit përmes faqes zyrtare të internetit të FSHN dhe UT, si dhe përmes adresave zyrtare të e-mail-it institucional. Edhe pse gjatë viteve akademike 2021–2022, 2022–2023 dhe 2023–2024 mësimi është zhvilluar kryesisht në auditor, stafi i IT-së në FSHN ka vijuar të garantojë akses të plotë në platformën "Microsoft Teams". Kjo platformë shërben si mjet ndihmës për të rritur efikasitetin në ndjekjen e programit të studimit, veçanërisht në funksion të: • Aksesit të lehtësuar në materialet mësimore (leksione, ushtrime, udhëzues për laboratorë, etj.); • Mundësisë për të komunikuar në kohë reale me pedagogët përkatës; • Sigurimit të një mbështetjeje shtesë për përgatitjen akademike gjatë sezoneve të provimeve dhe në situata që kërkojnë fleksibilitet logjistik. Kjo formë mbështetjeje digjitale siguron vijimësi në cilësinë e procesit mësimor, qasje të barabartë në informacion për të gjithë

	studentët dhe përputhje me standardet moderne të arsimit të lartë. Evidenca: - Manual përdorimi e-student - Manual përdorimi e-pedagog - Faqja web e UT - Faqja web e Fakultetit të Shkencave të Natyrës - Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë			
Konkluzione	GVJ konstaton se FSHN vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamentit të Fizikës, disponon dhe administron në mënyrë të rregullt statistikat vjetore në lidhje me: • Numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit <i>Master i Shkencave në Fizikë</i>, • Tërheqjet nga programi, • Transferimet në dhe nga programi, • Ecurinë akademike të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve, që nga pranimi deri në diplomim, • Numrin e të diplomuarve për çdo vit akademik. Numri i studentëve të regjistruar për programin e studimit: <i>Master Shkencor në "Fizikë"</i> për tri vite akademike është si më poshtë:
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të	

programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	V.a 2021-2022: 10 studentë V.a 2022-2023: 9 studentë V.a 2023-2024: 0 studentë
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Këto statistika ruhen në sekretarinë mësimore të FSHN, në regjistrin themeltar të studentëve, dhe përfshihen në analizat dhe raportet vjetore të departamentit dhe fakultetit. Administrimi i dokumentacionit dhe të dhënave të studentëve kryhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Sekretaria mësimore e FSHN administron dhe arkivon në formë të shkruar dokumentacionin e mëposhtëm: • Regjistri i rezultateve akademike për çdo student, • Regjistri themeltar i studentëve, • Regjistri i lëshimit të diplomave, • Dosjet e regjistrimit të studentëve sipas udhëzimeve të MAS për çdo vit akademik, • Procesverbalet e provimeve, • Dosjet e transferimeve (në dhe nga programi), • Dosjet për ndjekjen e një programi të dytë studimi, • Statistikat e studentëve frekuentues, • Statistikat e studentëve që humbasin statusin e studentit, • Statistikat e studentëve që ç’regjistrohen, etj. Të gjitha dokumentet arkivohen në kasafortën e Sekretarisë mësimore dhe përbëjnë dokumentacionin zyrtar origjinal, mbi bazën e të cilit lëshohen të gjitha vërtetimet për studentët, administratën universitare dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). Këto dokumente janë të verifikueshme vetëm nga persona të autorizuar. Të dhëna statistikore për periudhën 2021–2024: • Viti akademik 2021–2022: 10 studentë të regjistruar në programin <i>Master i Shkencave në Fizikë</i>. • Viti akademik 2022–2023: 9 studentë të regjistruar. • Viti akademik 2023–2024: Nuk pati studentë të regjistruar në këtë program. Numri total i studentëve të diplomuar (2021–2024): 15 studentë. Këto të dhëna përbëjnë një pjesë të rëndësishme të dokumentacionit të brendshëm institucional dhe ndihmojnë në

	vlerësimin e performancës dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit. Evidenca: • <i>Rregullore e UT, neni 41-42, fq.25; neni 59-64, fq.31-34; neni 67-73, fq.34-35</i> • <i>Ligj Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kreu IX, neni 97-102, fq.32-34</i> • <i>Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve</i> • <i>Aneks Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) administron dhe ruan në mënyrë të saktë dhe të sigurt të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve të programit <i>Master i Shkencave në "Fizikë"</i>. Këto të dhëna janë në përputhje të plotë me dokumentacionin mbështetës (si procesverbalet e provimeve, riprovimeve, etj.), janë të verifikueshme nga personat e autorizuar dhe sigurohen përmes platformave mbrojtëse digjitale që garantojnë integritetin dhe konfidencialitetin e tyre. Të dhënat e studentëve ruhen në bazën e të dhënave të sekretarisë mësimore, ku përfshihen: • Regjistri themeltar i studentëve, • Regjistri i rezultateve akademike të studentëve, • Regjistri i lëshimit të diplomave. Vlerësimi i studentëve dokumentohet përmes procesverbaleve zyrtare, të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion të pedagogëve gjatë sezonit të provimeve dhe që, pas përfundimit të tyre, arkivohen në sekretari si pjesë e dokumentacionit zyrtar. Të gjitha të dhënat statistikore dhe administrative mbi procesin mësimor menaxhohen nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, duke respektuar standardet për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurisë së informacionit. Administrimi i dokumentacionit mësimor dhe i bazës së të dhënave të studentëve kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në

	institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Evidenca: - Rregullore e UT, neni 41-42, fq.25; neni 59-64, fq.31-34; neni 67-73, fq.34-36 - Ligj Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kreu IX, neni 97-102, fq.32-34 - Manual përdorimi e-student - Shërbime Online Universiteti i Tiranës
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Universiteti i Tiranës (UT) harton çdo vit Raportin Vjetor Institucional, i cili përfshin të gjithë komponentët e përcaktuar nga udhëzimi dhe analizon në mënyrë të detajuar veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe zhvillimin e programeve të studimit të ofruara nga njësitet përbërëse. Raporti hartohet në bazë të evidencave zyrtare dhe analizave të përgatitura nga njësitet bazë, njësitet kryesore dhe Rektorati, dhe përmban të dhëna mbi profilin e studentëve në hyrje dhe në dalje, duke reflektuar indikatorët e cilësisë së procesit akademik dhe të rezultateve të arritura. Gjurmimi i punësimit të të diplomuarve (tracer study) realizohet si në nivel universitar, ashtu edhe në nivel departamenti, nëpërmjet Studimit të Tregut, i cili ofron informacion mbi shkallën e punësimit dhe përputhjen e studimeve me nevojat e tregut të punës. Këto analiza shoqërohen me masa dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e cilësisë së pranimeve, mbarëvajtjes së studimeve dhe punësimit të të diplomuarve. Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së mësimdhënies është nota mesatare në ciklin e dytë të studimeve (Master i Shkencave) për studentët e regjistruar, si dhe niveli i kalueshmërisë dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve. Në kuadër të analizës vjetore, Departamenti i Fizikës paraqet një pasqyrë analitike të numrit të studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin Master i Shkencave në Fizikë, si pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës akademike dhe institucionale.

	Evidenca: - Udhëzimi i MAS, nr. 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL" - Vendim i SA nr.2, datë 30.01.2023 "Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së Univesitetit të Tiranës, për vitin akademik 2021-2022" - Vendim i SA nr.62, datë 26.12.2023 "Për miratimin e raportit të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financare të Univesitetit të Tiranës, për vitin akademik 2022-2023" - Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024 - Raport vjetor për veprimtaritë e Dep. të Fizikës 2022-2023 - Raport vjetor për veprimtaritë e Dep. të Fizikës 2021-2022 - Raporti i studimit të tregut të punës në UT, fq.61-66 & 144-162			
Konkluzione	FSHN mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, të dhënat e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve	Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës (UT), si dhe me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në fuqi, studentët kanë të drejtë të përfshihen dhe të angazhohen në mënyrë aktive në strukturat vendimmarrëse dhe këshillimore të universitetit. Në UT, studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik, në Këshillat Studentore, si dhe në komisione të përhershme në

ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	nivel universiteti, sipas përcaktimeve statutores. Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik zgjidhen përmes votës nga vetë studentët.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët janë anëtarë të rregullt në komisione të rëndësishme si: • Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët (3 përfaqësues studentë), • Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë (3 përfaqësues studentë), • Komisioni i përhershëm i kurrikulës (2 përfaqësues studentë), • Këshilli i Etikës (2 përfaqësues studentë). Gjithashtu, në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të UT-së, studentët përfaqësohen përmes anëtarëve të tyre, duke kontribuar në procesin e vlerësimit të cilësisë. Përveç përfaqësimit formal, studentët marrin pjesë në procesin e sigurimit të cilësisë akademike përmes: • plotësimit të formularëve dhe pyetësorëve të vlerësimit, • përfshirjes në intervista dhe fokus grupe, • pjesëmarrjes në Sondazhin Kombëtar të Studentëve, i cili organizohet çdo tre vjet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Ky përfshirje e gjerë siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente në menaxhimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Universitetin e Tiranës. Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu III, neni 29-33, fq.18-22; neni 40-43, fq.27-29</i> - <i>Rregullore e UT, kreu IV, neni 84-91, fq.39-42</i> - <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020), neni 22, fq.14</i> - <i>Manuali i cilësisë (UT), fq.15</i> - <i>Sondazhi Kombëtar i Studentëve: Takimet informuese dhe udhëzuese më datë 4 Prill 2022</i> - <i>Sondazhi Kombëtar i Studentëve: Takimin informuese dhe udhëzuese më datë 22 Prill 2022</i> - <i>Aneks Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJBSC</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	Studentët, si anëtarë të Senatit Akademik dhe të komisioneve të përhershme institucionale (siç përcaktohet në kriterin 1-2), kanë

studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	të drejtë të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre në proceset e hartimit dhe rishikimit të kurrikulës. Përfshirja e tyre kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, duke sjellë një perspektivë të vlefshme që reflekton përvojën reale studentore. Në procesin e hartimit apo ndryshimeve të mundshme të një programi studimi, merret parasysh ngarkesa e studentit brenda dhe jashtë auditorit, duke u bërë një shpërndarje e balancuar e saj për secilën lëndë. Kjo bëhet në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Kontributi i studentëve mbledhet edhe në nivel departamenti, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të strukturuar, nëpërmjet: • pyetësorëve të vlerësimit për lëndët dhe mësimdhënien, • mbledhjeve të përbashkëta me stafin akademik, • fokus-grupeve, • si dhe përmes kërkesave dhe ankesave të paraqitura nga studentët. Të gjitha informacionet e mbledhura përdoren nga departamenti dhe stafi akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të përvojës studentore në programin konkret të studimit. Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës kreu III, neni 29-33, fq.18-22; neni 40-43, fq.27-29; kreu VII, neni 109, fq.64</i> - <i>Rregullore e UT, kreu III, neni 78-83, fq.37-39</i> - <i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar</i> - <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020), kreu V, neni 29-31, fq.17-18</i> - <i>Manuali i cilësisë (UT) - Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit: Vlerësimi i programit të lëndës dhe i mësimdhënies (paragrafi 3.6) fq.23-24, Cilësia e personelit: Vlerësimi i personelit akademik nga studentët (paragrafi 5.6) fq. 30</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe	Studentëve u jepet mundësia të japin mendimin e tyre mbi procesin mësimor përmes pyetësorëve të vlerësimit të lëndës dhe mësimdhënies, si dhe nëpërmjet kërkesave dhe ankesave të



ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	drejtpërdrejta, duke kontribuar kështu në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës, studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ankesë në rast të shkeljes së rregullave të provimit. Nëse përgjegjësi i departamentit konstaton se ankesa lidhet me një shkelje që mund të korrigjohet, ai bashkëpunon me komisionin e provimit për të bërë korrigjimet përkatëse. Në rastet kur përgjegjësi e konsideron të pamundur marrjen e një vendimi, ai i propozon dekanit shqyrtimin e rastit. Dekani merr vendim pas vlerësimit të plotë të procedurës. Gjithashtu, studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin e provimit nga pedagogu përkatës. Nëse studenti kundërshton rezultatin përfundimtar, ai paraqet ankesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit, i cili kryen verifikimet e nevojshme. Kur kjo strukturë nuk arrin të zgjidhë ankesën, dekani ngre një komision ad-hoc, i cili shqyrton pretendimet e studentit. Me miratimin e dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit, duke garantuar një proces të drejtë dhe transparent. Evidenca: - Rregullore e UT, neni 50-51, fq.28-29 - Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Fizikë", neni 26-31, fq.17-21			
Konkluzione	<i>Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës (UT), si dhe me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në fuqi, studentët kanë të drejtë të përfshihen dhe të angazhohen në mënyrë aktive në strukturat vendimmarrëse dhe këshillimore të universitetit. Në UT, studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik, në Këshillat Studentore, si dhe në komisione të përherëshme në nivel universiteti, sipas përcaktimeve statutores.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Departamenti, në bashkëpunim me njësi dhe struktura të tjera si sekretaria mësimore, pedagogët kujdestarë akademikë, dega e IT-së dhe zyra e financës (shërbimi i bursave), siguron informacion të detajuar për studentët lidhur me: • programin e studimit, • përmbajtjen dhe organizimin e tij, • kohëzgjatjen e studimeve dhe afatet e përfundimit, • akreditimin dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe përfundimin e vitit akademik, pushimet dhe festat zyrtare, • sezonet e provimeve.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës mbështet studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke u ofruar atyre informacion të vazhdueshëm, përfshirë edhe përmes faqes zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Departamentit të Fizikës. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi rregulloret, zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që mbështesin realizimin e tij. Përmes departamentit, studentët e programit Master i Shkencave në Fizikë përfitojnë këshillim dhe mbështetje gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ofron ndihmë për ata që hasin vështirësi në përvetësimin e lëndëve apo në plotësimin e detyrimeve akademike, përmes orëve të konsultimit të organizuara nga pedagogët përkatës. Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu IX, neni 127, fq.70</i> - <i>Lista e kujdestarëve për studentët e çdo viti të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë</i>

	- <i>Faqja web e Degës së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN</i> - <i>Faqja web "Këshillim Karriere"</i> - <i>Faqja web "Leksioni hapur me temë "Këshillimi i Karrierës"</i> - <i>Faqja web e Strukturës Administrative të FSHN</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës angazhohet në mbështetje të vazhdueshme të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve. Një nga fokuset kryesore të kësaj zyre është orientimi në karrierë dhe ofrimi i këshillimit të vazhdueshëm për studentët, për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara dhe strategjike në lidhje me zhvillimin e karrierës së tyre. Funksionet kryesore të Degës përfshijnë ndërveprimin e drejtpërdrejtë me studentët, me qëllim njohjen e tyre me pritshmëritë, kërkesat dhe standardet e tregut të punës. Ajo ndihmon studentët në: • përgatitjen për prezantimin e tyre të parë përballë punëdhënësve (përgatitja e CV-së, letër motivuese, intervista etj.), • orientimin për praktikën profesionale në institucione të ndryshme, • informimin dhe këshillimin për plotësimin e procesit mësimor dhe integrimin në tregun e punës. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, organizon rregullisht Panairët e Karrierës, të cilat synojnë të ndihmojnë studentët në një përgatitje më të mirë për tregun e punës, duke ofruar mundësi punësimi dhe internship-i. Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private që prezantojnë pozicionet vakante për studentët. Në datën 19 shtator 2022, nga ora 11:00 deri në 13:00, kompania Dominusoft organizoi Panairin e Këshillimit të Karrierës dhe Punësimit. Në këtë event, përfaqësues nga kompani të ndryshme mbajtën leksione informative për Këshillimin dhe Orientimin e Karrierës dhe prezantuan oferta për internship dhe punësim për studentët e Universitetit të Tiranës. Kompanitë pjesëmarrëse ishin: Albania Lab, ABP, TechPro, WebIn, Concept Marketing, FM Reklama, Alba Punësim dhe MasterIT.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	

	Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës, ndjek ecurinë e studentëve pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre, duke i vënë këto informacione në dispozicion të studentëve dhe institucioneve përkatëse. Evidenca: - Faqja web e Degës së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN - Faqja web "Këshillim Karriere" - Faqja web "Leksioni hapur me temë "Këshillimi i Karrierës" - Panairi i Këshillimit të Karrierës dhe Punësimit në Dominusoft			
Konkluzione	Departamenti i Fizikës, në bashkëpunim me njësi dhe struktura të tjera si sekretaria mësimore, pedagogët kujdestarë akademikë, dega e IT-së dhe zyra e financës (shërbimi i bursave), siguron informacion të detajuar për studentët lidhur me programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve dhe afatet e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe përfundimin e vitit akademik, pushimet dhe festat zyrtare, sezonet e provimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1


Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti i Tiranës (UT), duke garantuar lirinë akademike, siguron të drejtën për organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Procesi i mësimdhënies në programin Master i Shkencave në “Fizikë” zhvillohet në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregulloret e brendshme të UT-së, duke respektuar standardet e akreditimit të programeve. Në nivel institucional, UT ka hartuar Udhëzuesin për Programin “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”, i cili synon të mbështesë Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Rezultatet e këtyre kërkimeve përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Universiteti ka miratuar Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien 2022-2027, si dhe Planin Strategjik për Zhvillimin Profesional të Personelit 2023-2028. Ndër objektivat kryesore të strategjisë përfshihen rishikimi i programeve të studimit, hartimi i rezultateve të të nxënit, përdorimi i metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies, dhe promovimi i mësimdhënies praktike. Përveç formave tradicionale të mësimdhënies, UT ka miratuar edhe Udhëzuesin për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë, i cili u aplikua intensivisht gjatë periudhës së pandemisë. Ky udhëzues mbështetet nga rregullore e posaçme për zhvillimin e provimeve “online” dhe manuali për përdorimin e platformave digjitale. Në Departamentin e Fizikës janë ngritur facilitete moderne për mbështetjen e metodave inovative të mësimdhënies, përfshirë Laboratorin e Programimit dhe Fizikës Llogaritëse, i pajisur me kompjutera me kapacitete të avancuara dhe SmartBoard, si dhe

	salla 303B, e përshtatur si laborator kompjuterash për zhvillimin e këtyre metodave. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 7, fq. 4 - Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë - Vendim Nr. 29 i Senatit Akademik, datë 22.07.2021, Për miratimin e Udhëzuesit "Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, që financohen nga buxheti për kërkimin shkencor, në Universitetin e Tiranës, Udhëzuesi për Programin "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion" - Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve dhe kërkimit shkencor në UT - Strategjia Institucionale për mësimdhënien, Universiteti i Tiranës 2022-2027 - Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në Universitetin e Tiranës 2023-2028 si dhe programin e trajnimit për vitin 2023 - Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë - Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 81, fq. 40 - Rregullore e posaçme e Universitetit të Tiranës mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve "online" të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Universiteti i Tiranës (UT) synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe thellimin e përvetësimit të dijeve përmes zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore. Të gjitha programet e studimit në UT, përfshirë edhe programin Master i Shkencave në "Fizikë", i ofruar nga Departamenti i Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, kanë si qëllim orientimin e studentëve drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor, si dhe përgatitjen e tyre për konkurrencën në tregun e punës. Në Statutin e UT-së është përcaktuar roli i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmes Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC). Ky Komision bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë me Njësitë e Sigurimit të Cilësisë në nivel njësisht kryesore dhe bazë, duke u mbështetur në udhëzimet përkatëse të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Në këtë kuadër, stafi akademik i


	Departamentit të Fizikës është pjesë aktive e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative. Qëllimi kryesor i KPSSC-së është vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë, duke ofruar ekspertizë mbi proceset e sigurimit të cilësisë. Komisioni garanton monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësitë e tyre mësimdhënëse. Në përbërjen e tij përfshihen përfaqësues të çdo njësie kryesore të UT-së, përfaqësues të Rektoratit (Struktura e Sigurimit të Cilësisë) dhe përfaqësues të studentëve. Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet instrumenteve të ndryshme, si: pyetësorë të studentëve, kontrole të vazhdueshme nga Dekanati, vlerësim nga drejtuesi i departamentit, etj. Në nivel njësie kryesore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Këto struktura, në bashkëpunim me Zyrën e Zv. Dekanit për Kurrikulat e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve, organizojnë pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në përfundim të secilit semestër dhe para sezonit të provimeve. Pas përfundimit të këtij procesi, hartohen raportet e vlerësimeve dhe analizat përkatëse, të cilat përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në të gjitha njësitë bazë të Fakultetit. Raportet dhe analizat përmbajnë përpunime statistikore të detajuara të të dhënave nga pyetësorët. NJSBC dhe DSBCK ftojnë periodikisht studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të plotësojnë pyetësorët, me njoftimet përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të Fakultetit. Në përfundim, Dekanati përcjell raportet e vlerësimeve dhe analizat e pyetësorëve drejtuesve të departamenteve, të cilët i bëjnë të njohura ato stafit akademik, organizojnë takime dhe bashkërendojnë punën me përgjegjësitë e grupeve mësimore dhe kërkimore. Gjithashtu, hartojnë plane masash dhe analiza vjetore
--	--

	dhe monitorojnë performancën e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Senati Akademik, si organi kolegjal më i lartë drejtues i UT-së, ushtron përgjegjësitë për sigurimin e cilësisë. Me vendim të Senatit, UT ka miratuar Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, i cili përcakton metodologjinë, kriteret dhe periudhën e vlerësimit të të gjitha kategorive të stafit akademik në Universitet. Në kuadër të monitorimit dhe zhvillimit të aftësive mësimdhënëse, UT organizon trajnime për lektorët e rinj përmes Programit të Formimit Pedagogjik-Psikologjik “Bazat e Mësimdhënies në Arsimin e Lartë”. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 138, pika 1, fq. 73; neni 141, pika 1, 3, 4, fq. 74 - Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Fizikë - Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 - Plani Strategjik i zhvillimit të Departamentit të Fizikës, 2017-2027 - Komisionet UT - Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020) - Mbi kontrollin e procesit mësimor - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 “Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN” - Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në UT - Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024
--	--



	- <i>Vendim i Rektoratit Nr. 3, datë 24.01.2022 "Për miratimin në parim të rregullores" "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Për të përfutur mendimin e studentëve, çdo vit akademik organizohen pyetësorë për studentët. Vlerësimi periodik i metodave të mësimdhënies dhe i përvetësimit të dijeve nga ana e studentëve është i sanksionuar në Statutin e Universitetit të Tiranës (UT) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Fizikë. Sipas Statutit të UT-së (Neni 141, pika 3), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) organizojnë në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, pyetësorët studentorë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për secilën lëndë të programeve të studimit. Ky proces realizohet nëpërmjet Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Në përfundim të procesit, hartohen raporte të detajuara të vlerësimeve, të cilat shërbejnë si bazë për vlerësimin e jashtëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, garanton: • Pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e anketimit për secilën lëndë në përfundim të çdo semestri; • Pjesëmarrjen e studentëve në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; • Marrjen e opinionit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik; • Të drejtën e studentit për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të dijeve; • Ofrimin e Kujdestarit të studentit, i cili ka për detyrë përcjelljen e çdo shqetësimi apo problemi të studentëve tek autoritetet përkatëse. Evidenca:

	- Statuti i Universitetit të Tiranës, nenet 138-141, fq. 73-75; neni 125, pika 5, fq. 69 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024 - Komisionet UT - Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Fizikë) - Lista e kujdestarëve për studentët e çdo viti të programit të studimit Master i Shkencave në Fizikë - Aneks Tabela 24 ASCAL Të dhëna për anëtarët e NJSBC dhe DSBCK
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, në cilësinë e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies, realizojnë në mënyrë të vazhdueshme mbledhjen dhe analizimin e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së lëndëve në çdo program studimi. Rezultatet e këtyre vlerësimeve përpunohen dhe publikohen periodikisht në formën e raportit analitik, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe transparencën institucionale. Ky publikim kryhet në respektim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, duke garantuar anonimitetin dhe konfidencialitetin e informacionit të marrë nga studentët. Evidenca: - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 "Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN" - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022



	- <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023</i> - <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në Departamentin e Fizikës realizohen në mënyrë periodike analiza vjetore të punës, ku një nga aspektet kryesore është edhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies. Këto analiza evidentojnë dhe promovojnë shembuj të praktikave të mira, siç janë mobilitetet e stafit akademik në programin Erasmus+, mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore, botimi i artikujve shkencorë dhe përfshirja në projekte të ndryshme kërkimore. Përmes këtyre programeve, anëtarëve të stafit akademik u jepet mundësia e avancimit profesional dhe përkrahja e tyre vlerësohet vazhdimisht. Stafi akademik i Departamentit të Fizikës përfshihet aktivisht në programet Erasmus+ për kërkime shkencore dhe trajnime në fushën e mësimdhënies. Këto bashkëpunime lehtësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor. Në kuadër të programit Erasmus+, si dhe bashkëpunimeve me universitete partnere dhe programe të tjera, Departamenti i Fizikës ka realizuar mobilitete dhe shkëmbime sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 20. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës mbështesin vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor përmes ndihmave financiare. Një shembull konkret i kësaj mbështetjeje është rimbursimi i shpenzimeve për kërkimin shkencor, përfshirë pjesëmarrjet në konferenca dhe publikimet në revista shkencore, nga i cili ka përfituar edhe personeli akademik i Departamentit të Fizikës. Konkretisht, gjatë vitit 2021 janë mbështetur financiarisht katër punime shkencore; për vitin 2022 dhe 2023 përkatësisht nëntë dhe shtatë punime shkencore. Në total, për periudhën 2021–2024, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka mbështetur personelin akademik të Departamentit të Fizikës me financim për njëzet (20) punime shkencore. Evidenca:

	- Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022 - Raport mësimor shkencor i departamentit të fizikës 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Mbështetje financiare nga FSHN për publikime/konferenca - Aneks Tabela 20 - ASCAL - Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit			
Konkluzione	UT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti i Tiranës është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore. Statuti i Universitetit të Tiranës parashikon qartësisht strukturat përkatëse dhe parimet themelore mbi të cilat funksionon sistemi institucional i sigurimit të cilësisë. Për realizimin e këtij objekti, Senati Akademik ka miratuar një sërë dokumentesh strategjike, përfshirë Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë si dhe Paketën e Instrumenteve të Cilësisë, të cilat përbëjnë kuadrin institucional për zbatimin dhe monitorimin e standardeve të cilësisë. Po ashtu,

	janë ngritur struktura të specializuara në nivel institucioni si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës dhe të tjera. Funksionet, përgjegjësitë dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të KPSSC janë të përcaktuara në Statutin e UT-së. Në përputhje me nenin 141 të Statutit të Universitetit të Tiranës, është parashikuar gjithashtu ngritja e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) pranë çdo Njësie Kryesore. Një nga funksionet kryesore të këtyre njësive është organizimi i pyetësorëve studentorë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilët zhvillohen në përfundim të çdo semestri, përpara fillimit të sezonit të provimeve. Bazuar në të dhënat e mbledhura, NJSBC harton raportet përkatëse të vlerësimit, të cilat shërbejnë si bazë për vlerësime të jashtme dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Në zbatim të Vendimit Nr. 39, datë 04.04.2018, të Bordit të Administrimit “Për miratimin e buxhetit për vitin 2018”, pika 2 “Miratimi i strukturave për Njësitë e UT-së”, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel njësie kryesore si dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Këto struktura, në bashkëpunim me Zyrën e Zëvendësdekanit për Kurrikulat e Ciklit të Parë dhe të Dytë, organizojnë procesin e anketimit studentor për çdo lëndë të çdo programi studimi dhe përgatisin raportet përkatëse të analizës së të dhënave. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu X, nenet 138-141, neni 140, fq. 73-74 - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, fq. 4 - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 “Për Ngritjen e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN” - Vendim Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2018”, pika 2, “Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së”
--	---

	- Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) përbën strukturën përgjegjëse të ngarkuar nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës për garantimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të cilësisë në institucion dhe në programet e tij të studimit. KPSSC përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 8 janë përfaqësues të personelit akademik dhe 3 përfaqësues të studentëve. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) është i përfaqësuar në këtë komision me një anëtar nga personeli akademik. Për të mbështetur funksionimin e kësaj strukture, Universiteti i Tiranës ka ngritur edhe Sektorin e Sigurimit të Cilësisë (https://unitir.edu.al/struktura-organizative/), i cili vepron si strukturë ndihmëse-akademike për zbatimin e politikave institucionale në fushën e sigurimit të cilësisë. Ky sektor ofron mbështetje teknike dhe metodologjike për KPSSC në nivel institucional dhe për Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore të UT-së, sipas përcaktimeve të Tabelës 24 të dokumentacionit të ASCAL. Në nivelin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, një nga mekanizmat e rëndësishëm për garantimin dhe monitorimin e brendshëm të cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Në përmbushje të funksioneve të saj, DSBCK zbaton "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës", duke u mbështetur në "Manualin e Cilësisë" dhe "Paketën e Instrumenteve të Cilësisë", të cilat janë miratuar nga Senati Akademik i UT-së. Evidenca: - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 "Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN"



	- <i>Vendim Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2, "Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së"</i> - <i>Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik 23.12.2020 "Për miratimin e Paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Manuali i Cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës ka qenë subjekt i një procesi të vlerësimit të jashtëm institucional, i cili synonte të vlerësonte shkallën e përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë. Ky proces përfundoi me një vlerësim përfundimtar pozitiv, dhe UT u akreditua institucionalisht për një periudhë katërvjeçare. Në kuadër të procesit të riakreditimit, Universiteti i Tiranës ka marrë vlerësim përfundimtar pozitiv me kohëzgjatje prej gjashtë (6) vitesh, sipas vendimeve të mbledhjes së datës 27 janar 2023 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. UT është gjithashtu i përfshirë në procesin e akreditimit të programeve të studimit. Në këtë kuadër, Departamenti i Fizikës ka realizuar akreditimin e programit të studimit "Bachelor në Fizikë", për të cilin ka marrë vlerësim përfundimtar pozitiv. Vendimet përkatëse të Bordit të Akreditimit dhe raportet e vlerësimit të jashtëm e të brendshëm janë të publikuara në faqen zyrtare të UT-së dhe të ASCAL, në rubrikën "Akreditimi". Në vijim të angazhimit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, me Vendimin Nr. 26, datë 21.10.2020 të Senatit Akademik, "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës", u përcaktua: • Përgatitja e raportit vjetor mësimor-kërkimor, • Analiza e programeve të studimit dhe kurrikulave, me synim përmirësimin e tyre në masën 20%, • Përdorimi i dokumentacionit të unifikuar të instrumenteve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë.

	Në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme, UT ka hartuar edhe Planin e Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për periudhën 2021–2024. Në këtë kontekst, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) bashkëpunojnë ngushtësisht me njësitë bazë akademike, duke bashkërenduar veprimtarinë për sigurimin e cilësisë në nivel njësie kryesore. Për realizimin e vlerësimit të brendshëm, FSHN, në bazë të instrumenteve dhe pyetësorëve të standardizuar, organizon në mënyrë periodike anketimin e studentëve, me qëllim vlerësimin e lëndëve të çdo programi studimi. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 141, pika 3, fq. 74 - Vendim Nr. 84 ASCAL/Bordi i Akreditimit datë 27-10-2018 Për “Akreditimin Periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës” - Akreditimi periodik i UT, Vendim Nr. 04 ASCAL/Bordi i Akreditimit datë 27.01.2023 Për “Akreditimin Periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës” - Çertifikata e akreditimit insitucional të UT - Vendim Nr. 26 i Senatit Akademik, datë 21.10.2020 “Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës” - Vendim Nr. 08 i Rektoratit të Universitetit të Tiranës, datë 29.03.2022 “Për miratimin e planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024 në Universitetin e Tiranës” - Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020) - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin	Universiteti i Tiranës, në kuadër të angazhimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ka hartuar një politikë të qartë institucionale dhe ndjek procedura periodike me synim

gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit që ofron. Në Kreun X të Statutit të Universitetit të Tiranës, janë përcaktuar qartë procedurat specifike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve. Po ashtu, Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë përmban përcaktime të hollësishme mbi procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet që përdoren për realizimin e këtij procesi në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Përveç pyetësorëve studentorë periodikë, si një tjetër instrument i vlerësimit të brendshëm, Departamenti i Fizikës harton analiza vjetore të punës, të cilat përfshijnë edhe elemente të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Këto analiza reflektohen më tej në raportin vjetor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), duke ndihmuar në identifikimin e praktikave të mira dhe fushave me nevojë për përmirësim. Në bazë të këtyre vlerësimeve, Universiteti i Tiranës dhe FSHN ndërmarrin nisma inkurajuese, duke ofruar mbështetje financiare për punimet shkencore të personelit akademik. Konkretisht, për periudhën 2021–2024, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka mbështetur financiarisht 20 punime shkencore të realizuara nga stafi akademik i Departamentit të Fizikës. Evidenca: - Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu X, nenet 138-141 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020), nenet 31.32 - Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022 - Raport mësimor shkencor i departamentit të fizikës 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Mbështetje financiare nga FSHN për publikime/konferenca
Konkluzione	Universiteti i Tiranës është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore.

	<i>Statuti i Universitetit të Tiranës parashikon qartësisht strukturat përkatëse dhe parimet themelore mbi të cilat funksionon sistemi institucional i sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Universiteti i Tiranës ka ngritur një sërë strukturash dhe sektorësh me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit. Në nivel institucional, si struktura kryesore për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimore, funksionojnë: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. Në nivel të Njësive Kryesore, për të garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të dytë, janë ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Në kuadër të monitorimit, shqyrtimit dhe rishikimit të programeve të ciklit të dytë, drejtuesit e departamenteve bashkëpunojnë ngushtë me Zv. Dekanin për Kurrikulat e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve dhe me Zv. Dekanin për Kualifikimin Pedagogjiko-Shkencor dhe Ciklin e Tretë të Studimit, të cilët koordinojnë dhe planifikojnë raportimet për aktivitetet mësimore dhe kërkimore. Rezultatet e këtyre veprimtarive reflektohen në Raportet Vjetore të Njesisë Kryesore, të cilat hartohen në bazë të analizave vjetore të Njësive Bazë. Evidenca:

	- <i>Komisionet UT</i> - <i>Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 "Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN"</i> - <i>Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2 "Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së"</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Disa nga mekanizmat që përdoren në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dhe konkretisht në Departamentin e Fizikës, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit janë: • Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale të Universitetit të Tiranës, si dhe raportet vjetore të fakultetit dhe departamentit, të cilat përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe raportin e kërkimit shkencor. Këto raporte përmbledhin rezultatet e pritshme të vlerësimit, arritjet, praktikën më të mira, masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. • Plani vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore. • Plani i veprimtimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë. • Plotësimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies, i cili realizohet për lëndët e çdo programi studimi në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. Pas përfundimit të pyetësorit, hartohen raportet përkatëse dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore. • Raportet vjetore të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) mbi vlerësimin e cilësisë, të cilat publikohen në faqen elektronike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
	Evidenca: - <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, nenet 138-141, fq. 73-75</i> - <i>Komisionet UT</i>

	- Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 "Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN" - Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2 "Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së" - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024 - Vendim Nr. 26 i Senatit Akademik, datë 21.10.2020 "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës" - Vendim Nr. 08 i Rektoratit të Universitetit të Tiranës, datë 29.03.2022 "Për miratimin e planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024 në Universitetin e Tiranës"
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësitë Bazë të tij, në kuadër të realizimit, mbarëvajtjes dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit, përdorin metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: • Për çdo vit akademik hartohen raportet vjetore, të cilat pasqyrojnë veprimtarinë institucionale dhe përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në të gjitha komponentët dhe elementët përkatës. • Departamenti i Fizikës përgatit analizat vjetore që vlerësojnë mbarëvajtjen e programit duke përdorur elementët matës përkatës, të cilat raportohen më tej në raportet vjetore të Fakultetit. • Në raste të nevojshme, bëhen ndryshime në masën deri në 20% të planeve mësimore.

testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	• Dekanati ushtron kontrolle mbi zhvillimin e procesit mësimor. • Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) realizon pyetësorët vjetorë dhe harton analizat përkatëse. • DSBCK përgatit raportet vjetore mbi vlerësimin e cilësisë dhe i bën ato publike. • Përgjegjësit e departamenteve, në bashkëpunim me titullarët e grup-lëndëve në Njësitë Bazë, mbikëqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera. Evidenca: - Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022 - Raport mësimor shkencor i departamentit të fizikës 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024 - Vendim Nr. 29 i Senatit Akademik datë 21.10.2020 "Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimorë të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të UT-së për vitin akademik 2020-2021
Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Fizikës, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe

cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	cilësisë së programeve të studimit, përdorin metoda dhe instrumente të ndryshme të vlerësimit tërthor. Gjatë sezonit të diplomimit, në muajin korrik, studentët e diplomuar japin vlerësimin dhe mendimin e tyre kritik mbi cilësinë e programeve të studimit, përmes plotësimit të pyetësorëve “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” dhe “Raporti i Studentit”. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) organizon takime me alumnët në bashkëpunim me njësitë bazë, përfshirë Departamentin e Fizikës. Në këto takime përfshihen dhe nxiten në diskutime studentët dhe strukturat e tyre përkatëse. Nëpërmjet këtyre takimeve, DSBCK mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të marrë sugjerime dhe për të përmirësuar programin e studimit. Mendimi i studentëve të diplomuar mblidhet gjithashtu përmes statistikave të punësimit. Universiteti i Tiranës ka realizuar një studim institucional mbi tregun e punës për studentët e diplomuar, përfshirë ata të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Grupi i punës, i ngritur me vendim të Senatit Akademik Nr. 4, dt. 22.02.2018, hartoi një raport të detajuar mbi tregun e punës. Në kuadër të procesit të ri-akreditimit institucional (2023), u përgatit një raport i dytë mbi këtë studim. Gjithashtu, DSBCK ka hartuar raporte gjurmimi për studentët që diplomohen në FSHN. Bazuar në të dhënat e mbledhura, raportet ofrojnë një panoramë të specialiteteve që Fakulteti dhe Universiteti i Tiranës ofrojnë në tregun e punës, duke ndihmuar në vlerësimin e prirjeve të kërkesës dhe ofertës në këtë treg për të sapodiplomuarit. Në pyetësorin e përdorur janë analizuar aspekte të ndryshme, si vështirësitë në gjetjen e punës dhe roli i cilësisë së programeve në lehtësimin e këtij procesi. Në këtë kontekst, Departamenti i Fizikës ka realizuar gjithashtu studimin e tregut të punës duke përfshirë opinionet e studentëve të diplomuar. Në paketën e instrumentave për sigurimin e cilësisë parashikohet që në fund të çdo semestri të zhvillohet pyetësori “Raporti i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu”, ku secili anëtar i personelit akademik bën vetëvlerësim dhe analizë të lëndëve ku është titullar, bazuar në përqindjen e kalueshmërisë së studentëve
---	---

	dhe shpërndarjen e notave në përqindje. Personeli akademik jep gjithashtu mendimin kritik dhe propozon ndryshime në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL. Për më tepër, me miratimin e Rregullores “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës”, personeli ndihmës akademik dhe administrativ përfshihet në procesin e vlerësimit të programeve mësimore. Evidenca: - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024 - Raporti i studimit të tregut të punës në UT – 2022 - Raporti i gjurmimit 2021-2022 - Raporti i gjurmimit 2022-2023 - Raporti i gjurmimit 2023-2024 - Rrjetet sociale të Departamentit të Fizikës - Të dhënat “database” i pyetësorëve për gjurmimin - Takim Alumni Fizikë - Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020), fq. 20-21 - Vendim i Rektoratit Nr. 3, datë 24.01.2022 “Për miratimin në parim të rregullores” “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës”
Konkluzione	Universiteti i Tiranës ka ngritur një sërë strukturash dhe sektorësh me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit. Në nivel institucional, si struktura kryesore për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimore, funksionojnë: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. Në nivel të Njërive Kryesore, për të garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të dytë, janë ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

	<i>dhe Karrierës (DSBCK) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës përfshijnë në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe studentët si aktorë të brendshëm në procedurat e sigurimit të cilësisë. Studentët marrin pjesë aktive në këtë proces përmes plotësimit periodik të pyetësorëve. Përfshirja e aktorëve të jashtëm realizohet përmes takimeve me alumnët e Departamentit të Fizikës. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) organizon takime me alumnët e të gjitha programeve të ciklit të dytë, duke përfshirë edhe programin Master i Shkencave në “Fizikë”. Në këto takime inkurajohen diskutimet mes studentëve dhe strukturave të tyre përkatëse. Nëpërmjet këtyre kontakteve, DSBCK mban një komunikim të vazhdueshëm me studentët e diplomuar, institucionet dhe kompanitë ku ata punojnë, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Evidenca: - Komisionet UT, - Takim Alumni Fizikë - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023

	- <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në nivel universiteti, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) është struktura e ngarkuar nga Senati Akademik për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga 11 anëtarë, prej të cilëve 8 janë nga personeli akademik dhe 3 janë studentë. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) përfaqësohet në KPSSC nga një anëtar i personelit akademik. Universiteti i Tiranës ka ngritur Sektorin e Sigurimit të Cilësisë (https://unitir.edu.al/struktura-organizative/) (Tabela 24 ASCAL), një strukturë ndihmëse akademike që zbaton politikat e cilësisë dhe mbështet me aktivitetet e saj KPSSC dhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore. Për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm, FSHN ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). NJSBC ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e Njësisë Kryesore (Tabela 24 ASCAL). Në veprimtarinë e tyre, NJSBC dhe DSBCK zbatojnë “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, e cila mbështetet në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, të miratuara nga Senati Akademik i UT-së. Në kuadër të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të dytë, drejtuesit e departamenteve komunikojnë me Zv. Dekanin për Kurrikulat e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve, si dhe me Zv. Dekanin për Kualifikimin Pedagogjiko-Shkencor dhe Ciklin e Tretë të Studimeve, të cilët koordinojnë dhe planifikojnë raportimet e punës mësimore dhe kërkimore. Evidenca: - Komisionet UT - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 “Për Ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN” - Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2018”, pika 2 “Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së”

	- <i>Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik 23.12.2020 "Për miratimin e Paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Manuali i Cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024</i> - <i>Aneks Tabela 24 ASCAL - Të dhëna për anëtarët e NJSBC dhe DSBCK</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Sigurimi i cilësisë së programit të studimit garantohet nga përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit nëpërmjet: Hartimit të raporteve vjetore të Njesisë Kryesore (FSHN), ku pasqyrohet veprimtaria institucionale, duke realizuar një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij. Hartimi i analizave vjetore të Njesisë Bazë (Departamenti i Fizikës) të cilat vlerësojnë mbarëvajtjen e programit me elementët matës përkatës. Plotësimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies, i cili realizohet për lëndët e çdo programi studimi në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve. Në përfundim të tij hartohen raportet përkatëse dhe zbatohet një plan masash, për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore. Sa herë shihet e nevojshme, realizohen ndryshimet në masën 20% të planeve mësimore. DSBCK harton raportet vjetore mbi vlerësimin e cilësisë dhe i bën ato publike. Përgjegjësit e Departamenteve, në bashkëpunim me Titullarët e Grup-Lëndëve, personelin akademik dhe ndihmës akademik në Njësiti Bazë, mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera.

	Evidenca: - Statuti i UT, Statuti i UT, nenet 138-141, fq. 73-75 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022 - Raport mësimor shkencor i departamentit të fizikës 2022-2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) në proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe sigurojnë shmangien e çdo forme diskriminimi apo pabarazie ndaj personelit akademik dhe studentëve. Në veprimtaritë e tyre, KPSSC dhe DSBCK zbatojnë “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, e mbështetur në “Manualin e Cilësisë”, “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, si dhe në Kodin e Etikës. Evidenca: - Komisionet UT - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 “Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN” - Kodi i Etikës UT

	- <i>Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik 23.12.2020 "Për miratimin e Paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"</i> - <i>Manuali i Cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)</i> - <i>Aneks Tabela 24 ASCAL - Të dhëna për anëtarët e NJSBC dhe DSBC</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bashkëpunëtorët e jashtëm luajnë një rol të rëndësishëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, përfaqësues të biznesit dhe kompani, të cilët ofrojnë ekspertizë dhe vlerësime të vlefshme për cilësinë dhe përmirësimin e programeve studimore. Universiteti i Tiranës, nëpërmjet FSHN, organizon Panairin e Karrierës për të ndihmuar studentët në njohjen më të mirë të tregut të punës dhe për të ofruar mundësi punësimi dhe internship-i. Në këto panire marrin pjesë institucione publike dhe kompani private, të cilat prezantojnë pozicionet vakante për studentët. Gjatë këtyre takimeve diskutohen mundësitë për bashkëpunim dhe konsultime për përmirësimin e përmbajtjes së programeve dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, në kuadër të Panarit "Punë dhe Aftësi" ("Work and Study"), FSHN mori pjesë me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës. Në procesin e sigurimit të cilësisë për programin Master i Shkencave në "Fizikë", kontribuojnë edhe bashkëpunëtorët ndërkombëtarë, të cilët marrin pjesë në mobilitetet Erasmus+ dhe si lektorë të ftuar në aktivitete të ndryshme të Departamentit, si Java e Shkencës dhe shkollat tradicionale të organizuara nga departamenti. Evidenca: - <i>Kodi i Etikës UT</i> - <i>Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022</i>

	- Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Marrëveshje UT-UPT me CMS/CERN - Data Science, Particle and Astroparticle Physics School in Tirana 2022 - "Data Science Applications in Physics" Balkan School in Tirana 2023 - Java e Shkencës 2023, Science Week in Tirana - Java e Shkencës 2024, Science Week in Tirana, 2nd edition - Panairi i Work and Study në Universitetin e Tiranës - Aneks Tabela 20 - ASCAL Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit			
Konkluzione	FSHN përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjitë, organizimi dhe veprimtaria e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë të hapura dhe transparente për personelin akademik dhe studentët. Ato publikohen në faqen zyrtare të UT (www.unitir.edu.al) dhe të FSHN (www.fshn.edu.al). Këto dokumente pasqyrohen në Statutin dhe Rregulloren e UT, raportet vjetore të universitetit dhe Njësisë Kryesore, analizat vjetore të Njësisë Bazë, si dhe raportet periodike nga pyetësorët e studentëve, të përgatitura nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës.

	Raportet e DSBCK, të cilat janë përvitshme, kanë për qëllim promovimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Evidenca: - Statuti i UT, nenet 138-141, fq. 73-75 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 - Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024 - Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022 - Raport mësimor shkencor i departamentit të fizikës 2022-2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023 - Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, në funksion të përgjegjësi të tyre për monitorimin dhe garantimin e cilësisë në procesin mësimor, realizojnë në mënyrë të rregullt analizën e pyetësorëve të vlerësimit të mësimdhënies për çdo lëndë të ofruar në programet e studimit. Raportet analitike të këtyre vlerësimeve publikohen periodikisht, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe nxitjen e transparencës në institucion. Ky proces zhvillohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, duke respektuar anonimitetin e studentëve dhe konfidencialitetin e të dhënave të mbledhura. Evidenca: - Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 “Për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FSHN”

	- <i>Vendim Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2, "Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së"</i> - <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021 -2022</i> - <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022 -2023</i> - <i>Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023 -2024</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e DSBCCK dorëzohen në Dekanat, të cilët më pas i përcjellin Drejtuesve të Departamenteve. Drejtuesit e Departamenteve i bëjnë të ditura këto raporte personelit akademik, organizojnë takime dhe koordinojnë punën me titullarët e grupeve mësimore dhe kërkimore. Ata gjithashtu hartojnë analizat vjetore dhe planifikojnë masa për të adresuar dhe përmirësuar mangësitë dhe dobësitë e identifikuara. Evidenca: - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023</i> - <i>Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2023-2024</i> - <i>Raport vjetor për veprimtaritë e departamentit të fizikës 2021-2022</i> - <i>Raport mësimor shkencor i departamentit të fizikës 2022-2023</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të monitorimit të cilësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës kryen ndryshime në planet mësimore deri në 20%, sa herë që kjo konsiderohet e nevojshme. Këto ndryshime synojnë përmirësimin e programeve lëndore. Departamenti i Fizikës përditëson dhe përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet më të fundit në fusha të ndryshme të fizikës, duke bashkëpunuar me kompani dhe institucione të ndryshme. Bashkëpunimet me partnerë të tillë si Universiteti Politeknik i Barit, Bashkëpunimi CMS, CERN, Universiteti i Ferrarës dhe

	Akademia e Shkencave e Shqipërisë, përmes organizimit të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore—për shembull shkolla verore dhe dimërore, Java e Shkencës, si dhe mobiliteteve Erasmus dhe Short Scientific Missions në kuadër të projekteve COST—kanë rezultuar shumë efektive në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së programeve të studimit. Evidenca: - Marrëveshje UT-UPT me CMS/CERN - Data Science, Particle and Astroparticle Physics School in Tirana 2022 - "Data Science Applications in Physics" Balkan School in Tirana 2023 - Java e Shkencës 2023, Science Week in Tirana - Java e Shkencës 2024, Science Week in Tirana, 2nd edition - Panairi i Work and Study në Universitetin e Tiranës - Aneks Tabela 20 - ASCAL Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Fizikës organizon rregullisht mbledhje, ku diskutohet për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në këtë proces ndihmojnë takimet me ALUMNI, ku marrin pjesë edhe anëtarë të departamentit, si dhe shkollat, workshop-et, trajnimet dhe seminarët e hapura që organizohen në bashkëpunim me institucione të huaja prestigjioze. Pjesë e këtij procesi janë edhe bashkëpunimet dhe takimet me kompani dhe institucione të ndryshme. Këto aktivitete periodike shërbejnë për informimin mbi zhvillimet më të fundit shkencore në fushat e lidhura me fizikën, temat më bashkëkohore mësimore, mundësitë për trajnime, studime doktorale dhe punësim në institucione bashkëpunuese, qofshin ato vendase apo të huaja. Gjithashtu, këto iniciativa kontribuojnë në përmirësimin afatgjatë të programit Master i Shkencave në "Fizikë". Evidenca: - Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës - Rrjetet sociale të Departamentit të Fizikës - Takim Alumni Fizikë - Data Science, Particle and Astroparticle Physics School in Tirana 2022 - "Data Science Applications in Physics" Balkan School in Tirana 2023

	- Java e Shkencës 2023, Science Week in Tirana - Java e Shkencës 2024, Science Week in Tirana, 2nd edition - Workshop on Modeling and Simulations in Physics and interdisciplinary sciences			
Konkluzione	GVJ konstaton se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MSH në "Fizikë" janë publike, transparente dhe efektive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizikë” ofruar Universiteti i Tiranës.

Pikat e forta dhe afirmime

1. **Tradita dhe kontributi akademik:** Departamenti i Fizikës, ofrues i programit Master i Shkencave në “Fizikë”, ka një traditë të shkëlqyer disa dhjetëvjeçare, e cila vazhdon të ndikojë në procesin mësimor dhe kërkimor. Kjo reflektohet në tekstet mësimore të përdorura dhe bashkëpunimet aktive midis personelit akademik dhe ish-studentëve që sot ushtrojnë profesionin në institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. **Stafi akademik i përbërë mirë:** Departamenti ka në përbërje 21 pedagogë akademikë, ndërkohë që detyrimi ligjor është 7, duke lejuar një koordinim dhe shpërndarje të mirë të ngarkesës mësimore dhe kërkimore. Mbi 95% e ngarkesës mësimore të programit mbulohet nga pedagogët e brendshëm, duke tejkaluar minimumin ligjor prej 70%. Të gjithë anëtarët janë me tituj dhe grada shkencore të njohura, me kualifikime brenda dhe jashtë vendit.
3. **Bashkëpunimet dhe aktiviteti shkencor:** Departamenti zhvillon bashkëpunime me universitete, institute dhe kompani vendase e të huaja. Pedagogët kanë kryer mobilitete të ndryshme për trajnime dhe projekte shkencore. Kërkimi shkencor është i pasur me publikime në revista prestigjioze dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Një numër i konsiderueshëm studentësh ekselentë vazhdojnë studimet e doktoraturës në institucione prestigjioze jashtë vendit.
4. **Përmbajtja dhe përshtatja e programit:** Programi përfshin fusha të ndryshme si Fizika Teorike, Fizika e Trupit të Ngurtë, Fizika e Mjedisit, Fizika e Materialeve, Fizika Llogaritëse, Biofizika dhe Fizika Mjekësore. Në kontekstin e zhvillimit teknologjik, Departamenti i përgatit studentët me njohuri të gjera dhe të përshtatshme për tregun e punës. Përmirësimi i pjesës praktike dhe programimi do të jetë një fokus për ristrukturimin e ardhshëm të programit.
5. **Marrëdhëniet me studentët:** Personeli akademik njihet për korrektësinë dhe përkushtimin në mësimdhënie, si dhe për marrëdhëniet e mira me studentët gjatë procesit mësimor. Kjo vërehet gjatë leksioneve, seminareve dhe orëve në laborator, të cilat përbëjnë 21.3% të ngarkesës totale dhe favorizojnë punën e afërt me studentët.

Pika të dobta

1. **Ulja e numrit të studentëve:** Programi ka pësuar ulje të ndjeshme të numrit të studentëve në vitet e fundit, që rezultoi edhe në mbylljen e tij për vitin akademik 2023-2024. Kjo lidhet kryesisht me numrin e ulët të studentëve që vijnë nga programi Bachelor në Fizikë. Si zgjidhje, në vitin akademik 2024-2025 u ofrua programi i ri “Bachelor në Fizikë dhe Shkenca Kompjuterike”, i cili synon të rrisë numrin e studentëve dhe të furnizojë me kandidatë programin Master. (Standardi V.4, Kriteri 2)
2. **Orët e praktikës mësimore:** Edhe pse orët laboratorike janë në nivel të konsiderueshëm (21.3%), praktikat mësimore duhet të rriten. Aktualisht studentët zhvillojnë praktika në

kuadrin e lëndës së Fizikës Mjekësore në QSUT dhe gjatë punës për temën e diplomës. Marrëveshjet e reja me institucione dhe kompani pritet të rrisin ndjeshëm orët dhe cilësinë e praktikës.(Standardi 1.3,Kriteri 3)

3. **Përdorimi i mobiliteteve:** Edhe pse studentëve u ofrohen mundësi të ndryshme për mobilitet në kuadër të programeve si Erasmus+, shfrytëzimi i tyre nuk është në nivelin e dëshiruar.(Standardi VI.1,Kriteri 5)

Rekomandime

1. Promovimi aktiv i programit Master në shkolla të mesme dhe universitete të tjera që kanë degë të ngjashme.
2. Zhvillimi i programeve të dyfishta (double degree) me universitete të huaja për të tërhequr studentë ndërkombëtarë.
3. Përfshirja e më shumë projekteve praktike që lidhen drejtpërdrejt me industrinë.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in Physics provided by the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. **Academic tradition and contribution:** The Department of Physics, provider of the Master of Science in Physics program, has an excellent tradition of several decades, which continues to influence the teaching and research process. This is reflected in the textbooks used and the active collaborations between academic staff and former students who today practice their profession in national and international institutions.
2. **Well-composed academic staff:** The Department is composed of 21 academic lecturers, while the legal obligation is 7, allowing for a good coordination and distribution of the teaching and research load. Over 95% of the teaching load of the program is covered by internal lecturers, exceeding the legal minimum of 70%. All members hold recognized scientific titles and degrees, with qualifications both domestically and abroad.....
3. **Collaborations and scientific activity:** The Department develops collaborations with domestic and foreign universities, institutes and companies. The lecturers have carried out various mobilities for training and scientific projects. Scientific research is rich in publications in prestigious journals and participation in international conferences. A considerable number of excellent students continue their doctoral studies in prestigious institutions abroad.
4. **Content and adaptation of the program:** The program includes various fields such as Theoretical Physics, Solid State Physics, Environmental Physics, Materials Physics, Computational Physics, Biophysics and Medical Physics. In the context of technological



development, the Department prepares students with broad and relevant knowledge for the labor market. Improving the practical part and programming will be a focus for the future restructuring of the program.

5. **Student Relations:** Academic staff are known for their accuracy and dedication in teaching, as well as for their good relationships with students during the learning process. This is noticeable during lectures, seminars and laboratory classes, which constitute 21.3% of the total workload and favor close work with students.

Weaknesses

1. **Reduction in the number of students:** The program has suffered a significant decrease in the number of students in recent years, which also resulted in its closure for the 2023-2024 academic year. This is mainly related to the low number of students coming from the Bachelor in Physics program. As a solution, in the 2024-2025 academic year, the new "Bachelor in Physics and Computer Science" program was offered, which aims to increase the number of students and supply the Master program with candidates.
2. **Teaching practice hours:** Although laboratory hours are at a considerable level (21.3%), teaching practices need to be increased. Currently, students develop practices within the framework of the Medical Physics course at QSUT and while working on their diploma thesis. New agreements with institutions and companies are expected to significantly increase the hours and quality of the practice.
3. **Use of mobility:** Although students are offered various mobility opportunities within programs such as Erasmus+, their use is not at the desired level.

Recommendation

1. Actively promoting the Master's program in secondary schools and other universities that have similar branches.
2. Developing double degree programs with foreign universities to attract international students.
3. Involving more practical projects that are directly related to industry.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

